BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI EKONOMIK

Botim tremujor

Qershor 2004

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
www.bankofalbania.org

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1000 kopje

BULETINI EKONOMIK TREMUJOR
QERSHOR 2004

PËRMBAJTJA

"EKONOMIA E CASH-IT NË SHQIPËRI DHE PROGRAMI I BANKËS QENDRORE PËR TA REDUKTUAR ATË" 5
Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr. Shkëlqim Cani, me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, me datë 1 prill 2004.

"INSTRUMENTAT E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË". 17
Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Shkëlqim Cani, me studentët e Departamentit të Ekonomisë Agrare, në Universitetin Bujqësor të Kamzës, me datë 6 prill 2004.

"DOBISHMËRIA E INDEKSEVE TË BESIMIT PËR BANKËN QENDRORE". 33
Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Shkëlqim Cani, me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, me datë 14 maj 2004.

"RISTRUKTURIMI I SISTEMIT TË PAGAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË". 51
Artikulli është përgatitur nga Prof.Assoc.Dr.Roland Kajca, Përgjegjës i Zyrës së Politikave të Burimeve Njerëzore pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik në Bankën e Shqipërisë.

"GODINA E SELISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË, TIRANË". 65
Artikulli është përgatitur nga Ing.Niko Shtrepi, specialist pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës në Bankën e Shqipërisë.

LAJMET, PERIUDHA PRILL-QERSHOR 2004 71

NGJARJET JURIDIKE 85

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË 91

BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJABANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA 91

SUBJEKTE JOBANKASUBJEKTE JOBANKA 94

ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTOREZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE 97

UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT 103

“EKONOMIA E CASH-IT NË SHQIPËRI DHE PROGRAMI I BANKËS QENDRORE PËR TA REDUKTUAR ATË”.*

1. EKONOMIA JOFORMALE DHE PËRDORIMI I *CASH*-IT NË EKONOMI.

Një ndër problemet e rëndësishme të ekonomive në tranzicion dhe për më tepër të atyre në zhvillim, është prania e ekonomisë joformale apo e asaj jozyrtare. Ndërkohë që, sa më të zhvilluara të jenë strukturat shtetërore dhe ekonomike të një vendi aq më e ulët është pjesa joformale e një ekonomie.

Kjo për faktin se ekonomi të tilla, zotërojnë prej kohësh kuadrin ligjor dhe nivelin e lartë të zbatueshmërisë së tij, kontrollin shumëshkallësh në të gjitha fazat e punës, sisteme të plota dhe strikte informacioni që vihen në shërbim të metodave transparente të evidentimit të aktiviteteve ekonomike, si edhe përgjegjshmërinë dhe kulturën e nevojshme në punë.

Në fakt, çfarë përfaqëson ekonomia joformale? Ekzistojnë përkufizime të ndryshme për përcaktimin e ekonomisë joformale. Debati akademik është i thellë në këtë pikë. Megjithatë, në trajtimet që i bëhen kësaj çështjeje madhore, nënvizohet konvergjenca në idenë që, kjo lloj ekonomie ka të bëjë me aktivitete të zhvilluara nga agjentë ekonomikë që mbeten zyrtarisht të paevidentuara apo të fshehura.

Box 1: Disa përkufizime nga studiues të ndryshëm.

- *Ekonomi joformale është tërësia e të gjitha aktiviteteve ekonomike, të cilat kontribuojnë në llogaritjen e PBB-së, por që nuk regjistrohen (E. Feige).*
- *Ekonomi joformale është ekonomia që gjeneron të ardhura, të cilat nuk janë të regjistruara në statistikat zyrtare (Tanzi).*
- *Prodhimi dhe tregtimi i të mirave dhe i shërbimeve, ligjore dhe joligjore, të cilat ‘i shpëtojnë’ vlerësimit zyrtar të PBB-së, përbën pjesën joformale të ekonomisë (P. Smith).*

Tabelë 1: Aktivitetet më të ndeshura në ekonominë joformale*.

Aktiviteti	Transaksione monetare		Transaksione jomonetare	
Aktivitete të paligjshme	Tregtimi i mallrave të vjedhur, kultivimi dhe tregtimi i lëndëve narkotike, trafikimi i armëve, prostitucioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore, kumari (bixhozi) etj..		Trambë e drogës, e sendeve të vjedhura apo të fituara nëpërmjet mashtrimit. Vjedhje dhe kultivim i lëndëve narkotike për përdorim vetjak.	
Aktivitete të ligjshme	Të ardhura të padeklaruara nga vetëpunësimi = paga dhe pasuri të fituara nga puna ligjore, por e padeklaruar.	Mosdeklarimi i të ardhurave mbi kufijtë e tatueshëm, për punonjësit.	Trambë e mallrave dhe e shërbimeve të ligjshme.	Autokonsumi (konsumi vetjak) i të mirave dhe i shërbimeve të prodhuara vetë.
Rezultati / Pasoja	Evazion fiskal	Shmangie nga detyrimet e tatim – taksave	Evazion fiskal	Shmangie nga detyrimet e tatim – taksave

Shënim: *Marrë nga Lippert & Walker, The underground Economy: Global Evidence of Size and Impact. Vancouver, B.C..

*Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr. Shkëlqim Cani, me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, me datë 1 prill 2004. Përgatitur nga Prof.Dr. Shkëlqim Cani dhe Dr. Evelina Çeliku. Materialin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

Shkalla e bashkëjetesës ndërmjet ekonomisë formale dhe asaj joformale, në vende të ndryshme të tranzicionit vlerësohet të jetë në nivele të ndryshme. Studimet kanë treguar se madhësia e ekonomisë joformale nuk paraqet tendencë rënëse, përsa kohë që nuk ndërmerren veprime konkrete dhe të besueshme, të koordinuara me të gjithë pjesëmarrësit e tregut, nga ana e qeverisë. Nëse qeveritë janë serioze dhe rezultative në këtë fushë, kjo pasqyrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e evazionit fiskal dhe në rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit si pasojë e mbledhjes së detyrimeve (tatimeve dhe taksave).

E tëra kjo, realizohet nëse: (a) evidentohet aktiviteti real ekonomik i aktorëve të tregut, pra ai është i kontrollueshëm dhe nën kontroll, nga ana e organeve shtetërore (dogana & tatime); (b) mblidhen në mënyrë ligjore të ardhurat që duhet të derdhen në buxhetin e shtetit, përkundrejt aktivitetit ekonomik të evidentuar; (c) përballë ligjit të gjithë janë të barabartë, fakt që ndihmon dhe nxit zhvillimin ekonomik të vendit në kushtet e një konkurrence të ndershme.

Niveli i lartë i informalitetit vështirëson detyrën e qeverisë për të mbledhur të ardhurat për buxhetin, të nevojshme për kryerjen e shpenzimeve publike, për të cilat kanë nevojë të gjithë. Por ndër këta "të gjithë", bën pjesë '"grupi informal'', i cili gjithashtu ka nevojë për shërbime publike, madje më shumë se sa të tjerët dhe, që për fat të keq nuk kontribuon. Kemi të bëjmë këtu me një rreth vicioz i cili mund të verifikohet në ekonomitë e pazhvilluara apo dhe në ato të tranzicionit, ku përpjekjet për reduktimin e sektorit joformal të ekonomisë janë inekzistente apo të pakta. Nëse do t'i referoheshim shembujve të vendeve që janë kandidate të besueshme për të hyrë në Bashkimin Evropian, rruga për reduktimin e joformalitetit, nuk është më në formën e një rrethi vicioz, por në trajtën e një spiraleje klasike perimetri e së cilës ka ardhur duke u zvogëluar sa më shumë i afrohemi kulmit. Kjo do të thotë se përpjekjet e agjentëve ekonomikë janë koordinuar në mënyrë të drejtë nga qeveritë përkatëse, duke çuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të sektorit joformal të ekonomisë.

Megjithatë, vlerësimi i ekonomisë joformale është një proces pune i vështirë. Për një vend të caktuar, duhet të gjykohet mbi një grup shifrash dhe informacioni, në mënyrë që të arrihet në vlerësime sa më reale të madhësisë së ekonomisë joformale. Shprehje e qartë e pranisë së ekonomisë joformale është, sasia e parasë që qarkullon jashtë sistemit bankar.

Nëse përpjekjet për reduktimin e ekonomisë joformale do të jenë frytdhënëse, kjo do të pasqyrohet edhe në formalizimin e rrugëve që përshkojnë paratë, pikërisht, nëpërmjet sistemit bankar, që është krejtësisht zyrtar dhe i evidentuar nga statistikat shtetërore. Një numër jo i vogël ekonomistësh, evidentojnë faktin se janë aktorët e pjesës joformale të ekonomisë, të cilët preferojnë, më shumë se kushdo tjetër, të kryejnë veprime me para në dorë apo me *cash*. Ata preferojnë të paguajnë dhe të paguhen në mënyrë të tillë, duke krijuar atë ''mjedisin joformal'', sepse kështu mundësohet ''fshehja'' e aktivitetit real. Ata 'u shpëtojnë' në mënyrë krejt të padrejtë dhe arbitrare detyrimeve fiskale.

Le të përqëndrohemi, në vijim, në trajtimin e kësaj çështjeje, pra të ekonomisë *cash* në Shqipëri, të faktorëve kryesorë që e nxisin atë duke sjellë në vëmendjen e këtij auditori, disa rrugë që do të çonin në reduktimin e përmasave të saj, nëpërmjet programit që Banka Qendrore ka ndërmarrë tashmë prej disa muajsh për këtë qëllim dhe që e ka titulluar: "Përtej parasë".

2. RASTI I SHQIPËRISË DHE EKONOMIA *CASH*.

Nëse do t'i referoheshim rastit të ekonomisë shqiptare, do të vërenim se prania e ekonomisë joformale është në nivele shqetësuese. Vlerësimet tregojnë se, një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve ekonomike është ''e fshehtë'' apo e paregjistruar. Ato luhaten nga ai i INSTAT-it (rreth 30 për qind ndaj PBB-së), në atë të publikuar në (Financial Times, 18 dhjetor 2002, *World Report*), ku kjo e fundit vlerësohet të jetë rreth 50 për qind e PBB-së. Shqipëria, në krahasim me vendet e rajonit, madje edhe me më fqinjët si Bullgaria, Rumania, Maqedonia dhe Moldavia qëndron më poshtë

[2] Këto të drejta janë të kundërshtueshme e për rrjedhojë kjo çështje është qendër e diskutimeve të shumta.

në drejtim të reduktimit të aspektit joformal të ekonomisë. Paralelisht me ekonominë joformale ecën dhe lulëzon edhe ekonomia e *cash*-it. Të dhënat në lidhje me treguesin e parasë jashtë sistemit bankar ndaj agregatit monetar M3, tregojnë se Shqipëria, ka nivelin më të lartë të këtij treguesi ndërmjet vendeve në tranzicion. Raporti i PJB/M3 lëviz rreth nivelit 30 për qind, ndërkohë që në vendet në tranzicion të rajonit ky raport është rreth 20 për qind, në vendet në tranzicion të Evropës Qendrore është rreth 10 për qind dhe në ato të zhvilluara rreth 7 për qind.

Tabelë 2: Paraja jashtë bankave/M3 (në %).

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Evropa Qendrore (mes.)	16.5	12.6	12.7	12.9	12.4	11.3	10.6	11.7	10.4	10.4		
Republika Çeke		8.5	10.0	9.6	10.3	10.2	10.5	12.7	11.9	11.2		
Hungari	21.4	21.1	20.7	18.9	17.4	16.0	14.6	16.0	14.5	14.9		
Poloni	19.0	17.8	15.9	18.7	17.2	15.5	13.7	14.5	11.6	11.3		
Republika Sllovake		9.9	9.4	9.8	10.6	8.7	7.8	7.8	8.1	9.1		
Sllovenі	9.1	5.5	7.6	7.4	6.7	6.3	6.3	7.4	6.0	5.4		
Evropa Juglindore (mes.)	23.8	18.0	22.0	22.6	20.4	25.3	20.7	20.3	20.1	20.1		
Shqipëri	34.4	35.7	39.0	39.0	30.9	36.6	28.5	27.8	30.2	30.3	31.4	27.9
Bullgari	12.0	10.8	9.5	10.9	10.2	23.7	28.2	28.3	26.7	25.5		
Kroaci		13.7	15.0	13.5	11.9	10.5	10.0	10.6	9.1	8.0		
Maqedoni		6.3	25.9	28.9	31.3	27.1	24.4	22.0	20.8	23.4		
Rumani	25.0	23.5	20.7	20.8	17.8	28.6	12.5	13.0	13.9	13.2		
Vendet Balltike (mes.)	25.4	32.8	32.4	35.5	34.2	31.4	30.1	29.5	25.5	23.6		
Estoni	25.4	36.5	36.1	35.0	28.7	22.4	21.3	21.6	18.7	17.0		
Letoni		32.9	30.5	38.2	40.2	37.0	35.5	36.4	32.4	30.7		
Lituani		29.1	30.5	33.4	33.7	34.9	33.6	30.5	25.4	23.0		
Vendet e ish-Bashkimit Sovjetik (mes.)		30.9	29.8	45.6	50.8	49.3	44.2	45.2	42.1	39.4		
Armeni	24.2	30.2	41.0	61.1	64.0	53.5	43.1	38.9	39.2	37.8		
Azerbaxhan	29.2	50.1	26.3	45.8	56.2	53.8	50.2	51.3	35.1	42.7		
Bjellorusi			10.6	21.1	22.7	21.3	12.5	17.2	14.8	20.0		
Gjeorgji			23.6	69.1	69.0	64.3	57.6	54.9	50.6	47.3		
Kazakistan		27.7	36.6	41.6	45.0	53.6	46.3	37.8	26.8	27.4		
Republika e Kirgistanit				70.1	75.5	63.5	57.1	54.0	55.5	62.0		
Moldavi	11.7	34.2	45.9	51.5	51.0	50.6	48.5	44.8	41.1	37.8		
Rusi		26.2	26.6	29.3	29.1	28.5	29.9	27.1	26.9	27.5		
Taxhikistan				41.5	61.2	69.0	56.0	72.0	71.7	41.5		
Turkmenistan				40.9	46.7	43.1	35.9	55.4	40.9	46.7		
Ukrain		26.5	24.7	37.9	43.2	48.9	46.7	44.2	60.2	43.1		
Uzbekistan		21.5	32.5	37.8	45.4	41.9	46.9					
Mesatarja	21.1	23.4	24.5	33.3	35.0	34.8	31.1	31.1	28.8	27.4		

Tabelë 2: (vijim).

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Vendet e Zhvilluara (OECD)											
Australi	6.9	6.9	6.6	6.4	5.9	5.9	5.9	5.7	6.0	5.6	
Austri	7.7	7.9	7.9	8.0	8.2	8.1					
Belgjikë	7.4	6.7	6.6	7.1	6.9	6.7	6.4				
Kanada	6.3	6.1	6.0	5.8	5.7	5.5	5.8				
Danimarkë	5.0	4.3	5.2	5.3	5.0	5.0	5.0				
Finlandë	4.7	4.7	4.4	4.7	5.2	5.0	4.9				
Francë	5.1	5.2	5.2	5.0	5.3	5.3	5.2				
Gjermani	13.5	13.0	13.2	13.5	13.1	12.5	13.5				
Greqi	18.4	18.5	16.6	16.6	16.0	15.7	15.1				
Islandë	2.3	2.4	2.8	3.0	3.0	2.9	2.8				
Irlandë	7.7	7.4	7.2	7.0	6.6	6.2	6.1				
Itali	11.2	11.3	12.0	12.6	12.5	12.5	12.8				
Japoni	7.5	7.9	7.9	8.4	8.7	9.1	9.0	9.5	9.8	10.4	
Holandë	9.3	8.7	8.8	8.5	8.1	7.6	6.8				
Zelandë e Re	2.0	1.9	2.0	2.0	1.8	1.8	1.9	2.2	2.1	2.1	
Norvegji	6.7	7.4	7.5	7.5	7.1	7.4	6.4	6.5	5.9	5.3	
Portugali	7.8	7.8	7.5	7.4	7.1	5.8	6.4				
Spanjë	11.1	11.0	11.3	10.4	10.8	10.9	10.7				
Suedi	9.3	9.3	9.5	9.1	8.7	8.8	9.1	8.8	9.8		
Zvicër	8.1	7.5	7.4	7.2	6.9	6.4	6.3	6.2	7.1	7.7	
Britani e Madhe	3.1	3.1	3.1	2.9	2.7	2.8	2.1	2.3	2.3	1.6	
ShBA	7.5	8.2	9.1	9.0	9.0	9.1	9.0	9.9	9.0	8.6	
Mesatarja	7.7	7.6	7.6	7.6	7.5	7.3	7.2				

Burimi: IFS 2002, Buletine të ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 1. Paraja jashtë bankave ndaj M3 (në %).



Treguesi i PJB/M3, tregon nivelin e transaksioneve në *cash* në krahasim me ato që kryhen nëpërmjet sistemit bankar. Ndonëse fundi i vitit 2003, rezultoi me një tregues më të ulët, pra rreth 27.9 për qind, krahasuar me një vit më parë, ku ky tregues u faktua në masën 31,4 për qind, përsëri, Shqipëria mbetet një ekonomi *cash*-i. Shkaktarët duhen kërkuar në ata që motivojnë dhe nxisin krijimin dhe zgjerimin e sektorit joformal të ekonomisë në tërësi.

Shumica e bizneseve dhe e individëve vazhdojnë të kryejnë pjesën më të madhe të transaksioneve financiare jashtë bankave, duke shkaktuar kosto në ekonomi. Kështu, ekonomia e *cash*-it ka për pasojë, zvogëlimin e aftësive të bankave për të kanalizuar mjetet financiare (depozitat) drejt investimeve në formën e kredive. Një pasojë që tjetër, që lidhet drejtpërdrejt me Bankën e Shqipërisë, ka të bëjë me faktin se sasia e madhe e parasë në qarkullim ul ndjeshëm efektivitetin e vendimeve të politikës monetare.

Faktorët që stimulojnë një ekonomi të gjerë *cash*-i janë nënvizuar dhe janë përmendur shpesh në materiale dhe dokumente të rëndësishme të përgatitura nga stafi teknik i Bankës së Shqipërisë. Këta faktorë gjenden si brenda ashtu edhe jashtë sistemit bankar. Elemente të infrastrukturës së sistemit bankar si:

- shpërndarja josimetrike e sistemit bankar me një mbipërqëndrim në Tiranë dhe në disa qytete të tjera kryesore;

- mungesa e disa shërbimeve bankare që lehtësojnë kryerjen e transaksioneve si nga individët ashtu edhe nga bizneset;

- ngadalësia në kryerjen e pagesave si brenda ashtu dhe jashtë vendit (të paktën deri në dhjetor të vitit 2003, kur sistemi i RTGS-së (AIPS-it), nuk kishte filluar ende punë – sot për pagesat brenda vendit koha e realizimit të tyre është brenda ditës);

- prania e kërkesave të shumta pranë bankave etj.; janë përmendur shpesh nga bizneset dhe individët, si faktorë me ndikim negativ dhe që, njëkohësisht, rrisin distancat e tyre nga bankat. Kjo i shtyn ata, që të preferojnë më shumë veprimet me para në dorë apo *cash,* se sa ato me mjetet e tjera alternative të kryerjes së transaksioneve.

Por nga ana tjetër, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që stimulojnë ekonominë e *cash*-it:

- kështu, bizneset në tregun e gjerë joformal, pavarësisht nga cilësia e shërbimeve bankare, mundohen të mos i kanalizojnë veprimet e tyre financiare përmes bankave për t'iu shmangur detyrimeve ndaj shtetit. Përsa kohë që autoritetet fiskale kanë të drejtën për të marrë informacion nga bankat mbi lëvizjet financiare të klientëve të tyre, disa biznese, sidomos ato që veprojnë në ekonominë joformale, kanë nxitje për të shmangur veprimet me bankat, pavarësisht nga lehtësitë që këto të fundit mund të ofrojnë;

- edhe ato biznese që operojnë në ekonominë formale mund të përpiqen të shmangin taksat dhe për rrjedhojë veprimet me bankat, për të siguruar pozitat e tyre në treg, duke supozuar që shumica e bizneseve konkurrente i evitojnë ato;

- problemet ligjore, infrastrukturore dhe të rendit e vështirësojnë punën e bankave për të futur produkte dhe mjete të avancuara pagesash si ATM apo kartat e kreditit;

- vetë individët dhe bizneset mund të mos ndjehen shumë të sigurt për të përdorur menjëherë instrumentet e reja të pagesave, në qoftë se këto të fundit nuk kanë fituar një reputacion sigurie më parë;

- mungesa e një mentaliteti të nevojshëm në publikun e gjerë përsa i takon përdorimit të mjeteve jo*cash*, dhe përparësive që këto mënyra mbartin, nxit kryerjen e veprimeve me para në dorë;

- niveli i ulët i të ardhurave për një pjesë të popullatës shqiptare, nuk bën të domosdoshme përdorimin e *jocash*-it. Shtresa të tilla të saj, si punonjës të thjeshtë të administratës publike, arsimtarë të të gjitha niveleve të shkollës, studentë, pensionistë etj., kanë të ardhura, të cilat janë shpejt të konsumueshme;

- mungesa e infrastrukturës së nevojshme në tregti dhe në shërbime (aparate që pranojnë kartat, çeqet bankare /postare), nuk mbështet përdorimin e jo*cash*-it në blerjet e thjeshta dhe të përditshme të individëve që veprojnë në këtë realitet të ngarkuar nga prania e përdorimit të parasë në dorë.

Ne jemi dëshmitarë të shembujve të tillë që në gjirin e administratës publike, pagat e punonjësve jepen me para në dorë dhe jo nëpërmjet llogarive rrjedhëse që secili prej tyre mund të ketë, që detyrimet ndaj KESH, Albtelekom, Ujësjellësit, detyrojnë qytetarët të humbasin kohën dhe të lëvizin të ngarkuar me shuma parash, deri në sportelet përkatëse, që rimbursimet e sigurimeve shëndetësore janë kthyer në një ankth për individët, që shkojnë nga një strukturë e shtetit tek një tjetër. E gjithë kjo ec e jakë, ka një domethënie, praninë e tejskajshme të ekonomisë *cash* në Shqipëri.

Le të japim disa fakte të tjera, të cilat dëshmojnë edhe më qartë se përmasat e ekonomisë *cash* në Shqipëri janë të larta. I referohemi peshës së lartë të pagesave që kryhen në *cash* nga ana e bizneseve importuese dhe eksportuese si edhe peshës, gjithashtu, të lartë të marrjes së dërgesave të emigrantëve, në *cash.*

Nga të dhënat që Sektori i Bilancit të Pagesave (fundi i vitit 2003), thith nëpërmjet formularëve raportues të bankave për mbledhjen e transaksioneve të llogarisë korente (kategoria mallra), rezulton se vetëm 41.1 për qind e pagesave për importe kanalizohen nëpërmjet sistemit bankar, ndërsa pjesa tjetër (58.9 për qind) kryhet në *cash*. Ndërkohë, edhe për eksportet situata është pothuaj e njëjtë: pagesat për eksporte të kanalizuara nëpërmjet sistemit bankar zënë rreth 40.2 për qind, ndërsa pjesa e mbetur (59.8 për qind), kryhet me para në dorë. Këto janë fakte që qëndrojnë shumë pranë rezultateve të dala edhe nga një vrojtim që Banka e Shqipërisë ka kryer pranë bizneseve (me aktivitet në tregtinë e jashtme) për mënyrën e pagesës (2002).

Këto informacione tregojnë se bizneset që veprojnë në Shqipëri, vazhdojnë të qëndrojnë ende larg industrisë bankare. Ndonëse pretendohet se aktiviteti i tregtisë së jashtme, kryhet nëpërmjet bankave, të dhënat në përgjithësi nuk e mbështesin këtë, madje ato tregojnë se transaksionet tregtare në shumë raste nuk kalojnë nëpërmjet sistemit bankar, por jashtë tij në veprime me para dorë.

Përsa i takon mënyrës se si familjet shqiptare arrijnë të marrin dërgesat nga të afërmit emigrantë, mënyra e *cash*-it, është shumë më e ndeshur, ndër rastet e vrojtuara. Vrojtimi i organizuar nga Banka e Shqipërisë, pranë konsumatorëve shqiptarë, në muajin shtator 2003, nxori në pah se marrja e të ardhurave nga emigrantët nëpërmjet rrugëve zyrtare (banka apo Western Union), ndodh vetëm në 23 për qind të rasteve të intervistuara. Kjo do të thotë që pesha e rrugëve jozyrtare (nga vetë emigrantët apo dorazi nëpërmjet të njohurve të tyre) është në nivele të larta, e vlerësuar në rreth 76 për qind.

Komisionet e larta të aplikuara nga agjencitë e Western Union dhe nga bankat; shumat deri-diku të ulëta të dërgesave; përmbushja e shumë formaliteteve, për shumat e dërgesave që kalojnë 5000 usd (verifikime të ndryshme në kuadrin e plotësimit të kërkesave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave), janë arsye për të cilat qytetarët preferojnë rrugët jozyrtare të marrjes së dërgesave.

Përballë këtij realiteti, të ngarkuar me një përdorim të gjerë të *cash*-it në ekonomi, i cili është pasojë e pranisë gjithashtu të gjerë të sektorit informal të saj duke e mbështetur zgjerimin e kësaj të fundit, është detyrë e pjesëmarrësve dhe rregulluesve aktivë të ekonomisë, që të veprojnë pa humbur kohë.

Grafik 2: Shpërndarja e mënyrave të dërgesave nga emigrantët.



Përse themi pa humbur kohë?

Për vitet e para të tranzicionit (1991 - 2000), prania e një ekonomie *cash*, duket se mund të ''justifikohej'' më shumë për kushtet e Shqipërisë. Ky gjykim e ka bazën në disa aspekte të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit për periudhën përkatëse. ''Uria'' e agjentëve të këtij tregu të pazhvilluar, për t'u zhvilluar, çoi në një zgjerim të shpejtë të aktiviteteve ekonomike, që u reflektua në të ardhura të rritura, në kërkesë për mallra dhe shërbime në nivele të larta dhe në kërkesë në rritje për para.

Përballë kësaj ane të tregut, gjendej një sistem bankar pothuaj i papërgatitur për t'iu përgjigjur nevojave të ekonomisë reale. Infrastruktura e pazhvilluar bankare, tregu bankar i dobët, shërbimet minimale që ai ofronte, niveli i ulët i njohurive në fushën e bankave, nuk mundën të asimilonin një lëvizje efektive dhe të orientuar të parasë në sistemin bankar. Kjo, si edhe arsye të tjera që lidhen me infrastrukturën në tërësi, me mangësitë në aspektin ligjor si edhe me ekzistencën e ekonomisë joformale, konsiderohen si arsyet më të qenësishme që motivuan fitimin e një terreni të gjerë nga ana e ekonomisë *cash.*
Duket se ka disa kohë që raportet, ndërmjet zhvillimit të ekonomisë reale dhe atij në fushën bankare janë krejtësisht të ndryshuara, në krahasim me periudhën e parë të tranzicionit në Shqipëri. Sistemi bankar shqiptar, vlerësohet dhe ka dhënë prova se është në gjendje t'i përgjigjet kërkesave të ekonomisë. Infrastruktura e zgjeruar bankare dhe krijimi i bazës së nevojshme rregullative dhe ligjore që i jep hapësirat e duhura për të vepruar, ashtu si edhe sistemet bankare të vendeve që aspirojnë t'i bashkohen Evropës së zhvilluar, janë elemente shumë të rëndësishme, që mbështesin zhvillimin e ekonomisë jo*cash.*

Sot në Shqipëri numërohen 16 banka të nivelit të dytë, institucione të ndryshme financiare jobanka, shumë zyra dhe agjenci të këmbimeve valutore, të gjitha këto, të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Një pjesë e mirë e tyre kanë hapur degë edhe në rrethe të rëndësishme të vendit duke u dhënë mundësi individëve dhe bizneseve të shkojnë pranë tyre.

Në kushtet kur zhvillimit të sistemit bankar i bashkohet edhe teknologjia e përparuar (AIPS (RTGS) - janar 2004), Banka e Shqipërisë, e shtron si një nga problemet e rëndësishme ekonomike të vendit reduktimin e përdorimit të *cash*-it në ekonomi.

Njohja e sasisë së parasë që kalon nëpërmjet kanaleve formale, do të ndihmojë politikën monetare në vendimmarrje, do të ndihmojë qarkullimin aktiv të parave në ekonomi, do të ndihmojë në uljen e korrupsionit dhe të evazionit fiskal dhe padyshim që do të ndihmojë reduktimin e sektorit informal të ekonomisë shqiptare.

2.1. REDUKTIMI I *CASH*-IT DHE PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE.

Reduktimi i ekonomisë *cash*, ndihmon në luftën për parandalimin e pastrimit të parave. Kjo për faktin tashmë të shpjeguar më sipër, se përdorimi i gjerë i *cash*-it në ekonomi është pasqyrim, në një masë të konsiderueshme, i pranisë së ekonomisë joformale. Kjo e fundit nga ana e saj, duke fshehur aktivitetin real ekonomik, mbulon në një pjesë të madhe edhe origjinën e vërtetë të krijimit të parave dhe të pasurive të individëve dhe të bizneseve.

Prandaj, që të njohësh rrugën që paratë kanë ndjekur për të ardhur deri në kufijtë e sistemit bankar, do të thotë të njohësh burimin e krijimit të parave që individët, bizneset etj., kërkojnë të kanalizojnë nëpër banka.

Ligji nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", ndryshuar me ligjin nr. 9084, datë 19.06.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave"", ka për qëllim parandalimin e pastrimit të produkteve të veprave penale dhe të kryerjes se veprimtarive kriminale, në fushën ekonomike dhe atë financiare.

Kjo do të thotë që të gjitha subjektet e përcaktuara në ligj, përfshirë këtu edhe sistemin bankar, kanë detyrimin ligjor për të marrë pjesë në luftën kundër pastrimit të parave.

Do të ishte arritje që bankat të thithnin sa më shumë para që qarkullon jashtë sistemit bankar. Por do të konsiderohej arritje edhe më e madhe, nëse verifikohej që këto para nuk kanë për origjinë terrorizmin, abuzimin, korrupsionin, trafiqet, evazionin fiskal, krimin ekonomik dhe vepra të tjera penale. Në këtë pikë roli i sistemit bankar është mjaft i rëndësishëm, madje parësor.

Përpara se shuma parash nga forma e tyre *cash* ose jo*cash* (transaksione bankare) të depërtojnë ose të vijojnë rrugën në sistemin bankar, për t'u investuar në forma të ndryshme, duhet të njihet mirë origjina dhe burimi i krijimit të tyre. Rastet e dyshimta dhe transaksionet apo veprimet financiare që kalojnë kufijtë sasiorë të përcaktuar në ligj, bëhen objekt verifikimesh dhe regjistrimesh mjaft të kujdesshme.

Box 2: Disa kërkesa të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Raportohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, për rastet e veprimeve financiare, në cash *dhe/ose të transfertave të fondeve për shumat në ose mbi 20 milionë lekë apo të kundërvlerës në monedhë të huaj.*

Regjistrohen veprimet për shumat në ose mbi dy milionë lekë ose kundërvlerën e tyre në monedhë të huaj, duke kryer procesin e identifikimit të individit.

Regjistrohet, sinjalizohet dhe raportohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, edhe në rastet e veprimeve financiare nën shumat e parashikuara më sipër, kur ka dyshime të bazuara për pastrim parash.

Qarkullimi i parave 'të pastra', në sistemin bankar të ekonomisë sonë, përbën një tjetër kusht të rëndësishëm, për të vijuar rrugën drejt një integrimi më të shpejtë.

3. BANKA E SHQIPËRISË DHE PROGRAMI PËR REDUKTIMIN E *CASH*-IT NË EKONOMI.

Banka e Shqipërisë e konsideron reduktimin e përdorimit të *cash*-it në ekonomi, si një problem kompleks. Me këtë cilësim do të donim të theksonim se nuk është vetëm institucioni i Bankës Qendrore që përkujdeset për një problem të tillë, sepse nuk është sistemi bankar i vetmi aktor që do të marrë pjesë aktive në këtë drejtim.

Kuptohet që përfshirja në këtë program e të gjithë pjesëmarrësve të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit dhe realizimi i një bashkëpunimi ndërmjet të interesuarish, do të jetë kyçi suksesit të këtij programi.

Programi është sa ambicioz aq edhe i kujdesshëm.

Faza e parë e tij u mbyll në nëntor të vitit 2003, me realizimin e një tryeze të rrumbullakët, ndërinstitucionale. Gjatë kësaj faze u zhvilluan takime dhe diskutime ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë, KEShit, Albtelecom-it, Albapost-ës. Kjo fazë është konsideruar si periudha e sensibilizimit, kryesisht të institucioneve shtetërore në lidhje me problemin e pranisë së gjerë të përdorimit të *cash* –it në ekonominë tonë. Qeveria Shqiptare, është mjaft e interesuar për të reduktuar këtë fenomen, sepse ai ndikon drejtpërdrejtë në gjetjen e rrugëve efikase për rritjen ekonomike të vendit. Kjo, për faktin se paratë kanalizohen nëpërmjet rrugëve zyrtare dhe kthehen në të shfrytëzueshme nëpërmjet sistemit bankar.

Në këtë mënyrë, pjesë të aktivitetit ekonomik të vendit kthehen nga ''të paidentifikuara'' në "të identifikuara''. Ky element, bën që me të drejtë Qeveria Shqiptare (Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë) të konsiderohet bashkëpunëtorja më e afërt e Bankës së Shqipërisë në këtë program. Në këtë aspekt, studimi i Ministrisë së Ekonomisë në bashkëpunim me OECD-në, mbi ekonominë joformale, do të ndihmojë gjithashtu edhe arritjen e synimeve të programit "Përtej parasë", pra në reduktimin e ekonomisë *cash*.

Box 3: Program apo fushatë?

- Reduktimi i cash-it në ekonomi nuk mund të arrihet me një fushatë sensibilizuese, por me anë të një programi. Ai është një problem kompleks që përfshin dhe aktivizon aktorë të rëndësishëm të ekonomisë, të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare. Fushatat janë pjesëza të këtij programi.

- Programi është një bashkësi dhe bashkërendim veprimesh dhe masash në një plan të gjerë.

- Shtrirja e kohore e programit do të jetë për një periudhë relativisht të gjatë.

- Aspekti më i rëndësishëm i fushatave është lëshimi i sinjaleve intensive me efekt sensibilizues dhe edukativ. Në rastin e programeve, hapat sensibilizues dhe propagandues, hidhen pasi janë realizuar arritje konkrete që ndihmojnë, në rastin tonë, në reduktimin e cash-it. Si arritje konkrete mund të cilësojmë vendosjen e ATM-ve apo shpërndarjen e agjencive bankare në mënyrë sa më të njëtrajtshme në të gjitha zonat e vendit: pasi arrihen këto, mikrofushatat duhet të sensibilizojnë publikun, bizneset etj., për përdorimin e alternativave bankare jocash, si edhe t'i ndërgjegjësojnë ata mbi përparësitë që o ofrojnë ato për përdoruesve.

Fazat e mëtejme të programit, kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve konkrete nga të gjithë aktorët e këtij programi. Kuptohet që realizimi i disave prej tyre mund të jetë në një afat më të gjatë kohor, ndërsa disa të tjera, duhen kryer më shpejt, përsa kohë që vlerësohet se ekzistojnë parakushtet e aplikimit të masave apo ndërmarrjes së veprimeve konkrete.

Kështu, objektiva minimalë të këtij programi për vitin 2004 parashikohen të jenë:

a) 10 për qind e punonjësve të sektorit publik do të kenë llogari bankare (për marrjen e pagave, të shpërblimeve etj..);
b) liberalizimi i veprimeve në buxhetin e shtetit që pritet të realizohen brenda muajit prill '04;
c) instalimi i sa më shumë ATM-ve etj..

SI MUND TË REDUKTOHET *CASH*-I NË EKONOMINË SHQIPTARE?

Në vijim të këtij prezantimi do të trajtohen në mënyrë më të detajuar veprimet si edhe efektet që ato mund të gjenerojnë në drejtim të reduktimit të *cash*-it. Këtu, nuk mund të lemë pa përfshirë rolin e secilit aktor në këtë lëvizje të rëndësishme.

Bankat, biznesi dhe individët janë njëra anë e marrëdhënies që lind për t'i shërbyer reduktimit të *cash*-it, ndërsa qeveria me strukturat përkatëse administrative (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), kanë një rol përcaktues në rregullimin e kësaj marrëdhënieje në favor të jo*cash*-it.

Administrata shtetërore, mund të veprojë në disa drejtime të rëndësishme duke përmbushur kështu, rolin rregullativ që shteti ka në këtë marrëdhënie të gjerë. Le të listojmë disa prej drejtimeve:

a) pagesat dhe arkëtimet në favor të buxhetit të shtetit duhet të kryhen maksimalisht nëpërmjet sistemit bankar. Kjo masë synon përfshirjen e biznesit në kryerjen vetëm të transfertave bankare. Kështu kanalizohen të ardhurat dhe detyrimet e palëve përkatëse (biznes/shtet (aspekti fiskal)), në rrugë krejt zyrtare. E tëra kjo kërkon në mënyrë të domosdoshme çeljen e llogarive bankare, por edhe përdorimin real të tyre nga ana e bizneseve. Në këtë mënyrë, reduktohet rrjedhja e parasë në kanale të panjohura që shpesh bëhen bazë e korrupsionit dhe e evazionit fiskal;

b) arritja e liberalizimit të veprimeve në buxhetin e shtetit është gjithashtu, një parakusht që do të ndihmonte hapat e mëtejshëm të prgramit për reduktimin e *cash*-it;

c) detyrim për çelje llogarish dhe kryerje transfertash bankare edhe në marrëdhënie me organet fiskale, duhet të ketë jo vetëm biznesi i madh, por në tërësi biznesi shqiptar, duke mos lënë jashtë kësaj marrëdhënieje edhe biznesin e mesëm dhe të vogël;

d) rritja e përdorimit të gjerë të formave të pagesave *jocash* si për shembull përdorimi i gjerë i çekut. Shtytje e madhe i duhet dhënë edhe biznesit të vogël në këtë drejtim jo për shumën, por thjesht për numrin e madh të tyre;

e) në fillim të materialit cituam shembullin mbi marrjen e pagës nga punonjësit e administratës publike në *cash.* Gjykohet se ka ardhur koha që shlyerja e detyrimeve në formën e pagave dhe shpërblimeve të tjera të administratës shtetërore të kryhet nëpërmjet llogarive bankare. Ndonëse të ardhurat për këtë kategori të punësuarish janë ende të ulëta, përsëri gjykohet se ky është një hap i rëndësishëm, për të bërë klientë të bankave edhe punonjësit e administratës publike. Janë bankat që nëpërmjet konsolidimit të kësaj marrëdhënieje, mund t'u ofrojnë këtyre klientëve ''preferencialë'', por edhe të sigurt, shërbime bankare dhe *bonus*-e, të ndryshme në këmbim të përdorimit të mjeteve alternative të pagesës, në jo*cash.* Këtu mund të trajtohet edhe ideja e kalimit të pensioneve nëpërmjet llogarive bankare;

f) instalimi dhe fillimi nga puna i sistemit të kleringut, është një hap që ndihmon marrëdhënien: bankë – klient (biznes ose individ) – tatime dhe dogana – sistem informacioni statistikor. Kjo do të thotë që, rruga që përshkon një transaksion bankar, evidentohet në një sistem të plotë, që në fund të fundit i shërben të gjithëve: shtetit, bankës, bankës qendrore, individëve dhe bizneseve;

g) rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ që ndihmon problemin për të cilin diskutohet sot;

h) kryerja e likuidimeve të detyrimeve mujore (energji, ujë, telefon, rimbursime shëndetësore) të punonjësve të administratës publike nëpërmjet transfertës bankare. Humbja e kohës, rastet e harresës së kryerjes së këtyre detyrimeve dhe lëvizja me *cash* nga njëri sportel në tjetrin, janë aspekte që eliminohen nëpërmjet kësaj rruge (transfertë bankare). Për pjesën tjetër të popullatës, përdorimi i çekut bankar apo edhe i atij postar, është një mënyrë që realizon kalimin e këtij detyrimi nëpërmjet llogarisë bankare.

Bankat e nivelit të dytë, janë aktore që luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në marrëdhënien ekonomi – klient - *cash.* Një bankë, si ndërmjetëse financiare, e konsideron kryerjen në masë të madhe të transaksioneve në *cash*, me mjaft vështirësi dhe pengesa, sepse pranimi dhe disbursimi i *cash*-it është një shërbim me kosto të lartë për bankat. Në fakt në shumicën e rasteve, bankat këtë shërbim ua ofrojnë klientëve të tyre falas. Kjo sakrificë për të ofruar një alternativë pagese "*cash* në bankë" ndaj një pagese "*cash* në dorë" është shprehje e interesit të drejtpërdrejtë të bankave. Prandaj, ka ardhur koha që sistemi bankar të veprojë më me agresivitet, sidomos sot, kur pritet që konkurrenca në tregun bankar do të rritet me ardhjen e Raiffessenbank. Pretendohet që kjo e fundit do të ofrojë shërbime të reja bankare, që natyrshëm, synojnë thithjen e parasë brenda sistemit bankar.

Duke e përgjithësuar idenë, do të thonim se sa më pak *cash* të qarkullojë në ekonomi aq më i suksesshëm është sistemi bankar i saj, aq më i dukshëm është zhvillimi. Për këtë është e domosdoshme që të realizohen disa pika të rëndësishme të programit në drejtim të:

a) pranisë aktive të agjencive bankare pranë pikave ku arkëtohen detyrimet periodike si dhe të tjera detyrime me natyrë fiskale;

b) pranisë së agjencive bankare pranë komunave dhe bashkive të vogla. Në këto zona zyrat postare të Albapostës, duhet të jenë aktive për kryerjen e transfertave bankare;

c) ndërtimit të një sistemi elektronik që do të verifikojë *on – line* gjendjet e kartave elektronike, një hap ky që do të inkurajonte përdorimin masiv të kartave të kreditit dhe të debitit. Vendosja e ATM-ve, e kartave të debitit e të kreditit si edhe e sistemit të kleringut, janë hapa, që shërbejnë si parakushte për reduktimin e parasë *cash* në ekonomi, ndaj bankat duhet t'i paraprijnë përmbushjes së tyre;

d) rritjes së shërbimeve bankare dhe uljes së komisioneve që sistemi bankar përdor. Ka ardhur koha që sistemi bankar të shtojë numrin e instrumenteve financiare në dispozicion të individëve për shembull, çertifikatat e depozitave.

e) shtimit të marketingut të biznesit bankar. Për një pjesë të madhe të popullsisë banka ende identifikohet me një arkë kursimi, ndërkohë që shumë anë të tjera të biznesit bankar mbeten pothuaj të panjohura. Raiffeissenbank, pritet të jetë mjaft aktive edhe në këtë fushë

Biznesi, është pjesë e rëndësishme e marrëdhënies qeveri - biznes – bankë, e ndërtuar mbi bazë mirëkuptimi, rregulli dhe respektimi të rregullave nga të gjithë dhe për të gjithë njësoj.

Ekziston një grup biznesesh që kanë një histori marrëdhëniesh të rregullt me bankat dhe me administratën tatimore dhe doganore. Ky është grupi elitar i biznesit, i cili në fakt ka ardhur duke u rritur në Shqipëri. Ai thith dhe asimilon shumë shpejt të rejat në teknologjinë bankare që, në fund të fundit, kanë për qëllim përdorimin e jo*cash*-it. Ndërkohë, ekziston një grup jo i vogël biznesesh, i cili akoma nuk është familjarizuar me bankën. Marketingu bankar duhet të synojë edhe drejt këtij grupi, për të shpjeguar përfitimet dhe kostot nga shërbimet që ofrojnë bankat sot.

Publiku, është një aktor i kudondodhur i këtij programi. Së pari, ai duhet të mirëkuptojë qëllimin e programit, më pas të njohë dhe të përdorë instrumentet bashkëkohore të pagesave duke rritur vëllimin e transaksioneve që kryen nëpërmjet sistemit bankar. Në fakt, publiku shqiptar ka treguar dhe më parë se nuk ka vështirësi në thithjen e shërbimeve dhe të produkteve të reja. Këtu mund të përmendim si shembuj rastet e thithjes në masë të telefonisë celulare, të përdorimit të gjerë të internetit (përhapja dhe shkalla e lartë e frekuentimit të ambienteve të Internet Café–ve) si edhe të përdorimit të gjerë të shërbimit të bonove të thesarit. Edhe në rastin e përdorimit të jo*cash*-it apo edhe të produkteve dhe shërbimeve të reja lehtësuese të ofruara nga bankat, pritet që publiku të jetë i gatshëm t'i asimilojë shpejt ato.

E rëndësishme është që *publiku i gjerë e në mënyrë të veçantë biznesi*, i cili ndjen në mënyrë të përditshme rreziqet *cash*-it, të mbajtjes dhe të transportimit të tij, pamundësinë e administrimit të mirë të parave dhe kostot që e shoqërojnë këtë fenomen, të ndjejnë praninë e bankës si institucion besimi.

Bankat duhet të bëhen të pranishme në ekonomi, për t'i demonstruar publikut të gjerë se çfarë ato u ofrojnë, që ky i fundit t'i bëjë pjesëtare të natyrshme në jetën e përditshme. Në fund të fundit, do të ishte arritje nëse, shprehje të tilla si: "Do të doja të fiksoja një takim me bankierin tim për të konsultuar këtë apo atë përparësi që përfitoj nga ky apo ai shërbim bankar etj ..", të bëheshin sa më familjare për të gjithë ne.

4. NË VEND TË MBYLLJES POR JO MBYLLJE...

Të jetosh në një ekonomi ku paraja qarkullon në një masë të madhe në formën e *cash*-it, ky nuk është tregues i zhvillimit të vendit. Për më tepër një formë e tillë, ushqen dhe ushqehet nga një sektor informal i gjerë i ekonomisë. Me gjithë përpjekjet drejt zhvilimit dhe integrimit, fatkeqësisht, konstatojmë se jetojmë në një realitet të tillë, të cilin duhet ta ndryshojmë. Programi i cilësuar "Përtej parasë", është një hap drejt reduktimit të ekonomisë *cash*.

Realizimi i synimeve të këtij programi është i lidhur ngushtë me aspektin e qëndrueshmërisë makroekonomike, institucionale dhe zhvillimeve infrastrukturore.

Ndërsa aspekti makroekonomik mund të konsiderohet deri – diku i qëndrueshëm, ka ende shumë për të bërë në aspektin ligjor dhe institucional.

Këtu vihet theksi në zbatueshmërinë e ligjit dhe në sigurimin e rendit, që ndikojnë mbi veprimtarinë e biznesit në tërësi dhe mbi atë bankar në veçanti. Një kuadër ligjor i plotë dhe i zbatueshëm njësoj për të gjithë, ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit në kushtet e një konkurrence të ndershme duke ulur evazionin fiskal, korrupsionin dhe sasinë e parave që rrjedhin nga aktivitete të paligjshme.

Ndërkohë që përmirësimet infrastrukturore përbëjnë një tjetër parakusht që ndihmon arritjen e synimeve të programit "Përtej parasë".

LITERATURA:

Banka e Shqipërisë, Raporte Statistikore.

Banka e Shqipërisë, Bilanci i Pagesave, 2003.

Cani, (nëntor 2003), Fjala e mbajtur në workshop-in "Zëvendësimi i *cash*-it me mjete alternative pagesash: avantazhet dhe disavantazhet", 10 nëntor 2003.

Grup autorësh nga Banka e Shqipërisë (Çeliku, Luçi, Ceca, Ruçi, Duro), (maj 2003), "Probleme të ekonomisë shqiptare: disa rrugëzgjidhje të mundshme".

Luçi (nëntor 2003), "Reduktimi i ekonomisë së *cash*-it: problem i publikut, i biznesit, i bankave apo i autoriteteve?, mbajtur në workshop-in "Zëvendësimi i *cash*-it me mjete alternative pagesash: avantazhet dhe disavantazhet", 10 nëntor 2003.

Olters (2003) "The informal sector-impeding economic development?" IMF, Country Report, Nr. 03/64, punim i prezantuar dhe në Konferencën IV të Bankës së Shqipërisë, 11-12 shtator 2003, Sarandë.

“INSTRUMENTAT E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË”.*

HYRJE

Hartimi dhe zbatimi politikës monetare është detyra kryesore e Bankës së Shqipërisë dhe, pa dyshim, veprimtaria që tërheq më tepër vemendjen e publikut. Politika monetare është e orientuar drejt përmbushjes së objektivit të kontrollit të inflacionit. Por, puna konkrete e zhvilluar nga Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit është e paqartë për publikun e gjerë.

A është në gjendje banka qendrore të ndikojë realisht nivelin e çmimeve në ekonomi? Nëse është, ç’arë instrumentesh konkrete ka në dispozicion ajo për të kontrolluar inflacionin? Si lidhen këto instrumente me objektivin e inflacionit? Cilat janë detajet konkrete të funksionimit të tyre? Këto janë pyetjet kryesore të cilave ky leksion merr përsipër t’iu japë përgjigje.

Leksioni fillon me një përshkrim të shkurtër të ndikimit të inflacionit në ekonomi, për të nënvizuar rëndësinë e kontrollit të tij nga banka qendrore. Ai vazhdon me një pasqyrë të kuadrit teorik të politikës monetare dhe, në fund, ndalet gjerësisht në rolin e instrumenteve monetare në zbatimin e politikës monetare.

I. BANKA QENDRORE DHE INFLACIONI.

Literatura ekonomike e dekadave të fundit konvergon në një pikë: kontributi më i rëndësishëm që mund të japë një bankë qendrore në zhvillimin ekonomik të një vendi është arritja dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve. Kjo konsideratë, e mbështetur gjerësisht edhe nga eksperienca ekonomike e periudhave të fundit, është në bazë të fokusit të vazhdueshëm të punës së bankave qendrore në kontrollin e inflacionit. Pjesa dërrmuese e bankave qendrore në botë kanë si objektiv kryesor qëndrueshmërinë e çmimeve. Edhe Banka e Shqipërisë, si banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, ndan të njëjtin shqetësim dhe të njëjtin objektiv me bankat e tjera qendrore. Sipas ligjit nr.8269, datë 23.11.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, *“objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve[1]”.*

Përpara se të analizojmë funksionimin e instrumenteve monetare dhe rolin e tyre në përmbushjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë, fillimisht e gjej me vend të ndalem disi në sqarimin e efekteve që ka inflacioni në ekonomi.

I.1 PSE DUHET LUFTUAR INFLACIONI?

Është vërtetuar se ekonomitë kanë një ecuri më të mirë të rritjes ekonomike, të rritjes së punësimit dhe të përmirësimit të standardit të jetesës kur inflacioni është i ulët. Studimet, në të cilat është vrojtuar lidhja midis rritjes së prodhimit apo të produktivitetit dhe inflacionit, kanë treguar se sa më i lartë të jetë inflacioni aq më e ulët është rritja ekonomike në terma realë.

Pikërisht lidhja negative midis inflacionit dhe ritmeve të rritjes ekonomike ka bërë që bankat qendrore (me përjashtime të vogla) ta bëjnë inflacionin e ulët qëllimin kryesor të politikës së tyre monetare.

---

[1] Banka e Shqipërisë ka dhe objektiva të tjerë. Duke iu referuar përsëri ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” shohim se ajo ka edhe këta objektiva: “Në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit. Objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë, të kushtëzuar nga objektivi kryesor i saj, duhet të nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut”. Por, ligji është i qartë në përcaktimin e prioriteteve të objektivave: objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është kontrolli i nivelit të inflacionit. Të gjithë objektivat e tjerë, të përmendur më sipër, janë të kushtëzuar nga respektimi i objektivit kryesor.

* Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Shkëlqim Cani, me studentët e Departamentit të Ekonomisë Agrare, në Universitetin Bujqësor të Kamzës, me datë 6 prill 2004. Materialin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

‘

’Objektivi i punës sonë në Federal Reserve është të reduktojmë inflacionin deri në atë pikë sa ai të mos përbëjë më një faktor në vendimmarjen ekonomike. Në qoftë se ne do të jemi të suksesshëm, shpërndarja e burimeve do të jetë më afër optimumit, duke dhënë pasoja pozitive në rritjen ekonomike dhe në standardin e jetesës.”

Gary H. Stern
President, Federal Reserve Bank of Minneapolis

Një pyetje që natyrshëm kërkon përgjigje është: *pse inflacioni i ulët është i favorshëm për rritjen ekonomike?*

Në fund të fundit, lidhja statistikore nuk vërteton shkakësinë! Lidhja midis rritjes ekonomike dhe inflacionit mund të jetë aksidentale ose shkakësia mund të vijë nga ana e kundërt, pra mund të jetë rritja ekonomike ajo që provokon inflacion të ulët. Kjo është vërtet një pyetje e vështirë dhe, deri më sot, nuk ka teori që ta shpjegojnë qartë dhe pa ekuivoke këtë lidhje. Sidoqoftë, arsyetimi ekonomik sugjeron se ka të paktën dy kanale nëpërmjet të cilave inflacioni ndikon ecurinë e ekonomisë reale:

- ndryshe nga inflacioni i lartë, inflacioni i ulët rezulton në shpërndarje (alokim) më të mirë të burimeve pasi sinjalet e dërguara nga procesi i përcaktimit të çmimeve mund të interpretohen më lehtë dhe më saktë;

- inflacioni i ulët ndihmon stabilitetin financiar.

A. Shpërndarja e burimeve.

Çmimet relative përfaqësojnë faktorin kryesor që orienton alokimin e burimeve.

- Një ndryshim në çmimet relative, që rezulton nga një rritje/ulje në kërkesën për një produkt të caktuar, duhet të zhvendosë burimet ekonomike nga aktiviteti në të cilin çmimet kanë rënë (relativisht) për tek aktiviteti në të cilin çmimet janë rritur. Ndërkohë, rritja e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, inflacioni, nuk duhet të ndryshojë alokimin e burimeve në këtë mënyrë. Por, në një mjedis inflacionist, është e vështirë për agjentët ekonomikë që të dallojnë një ndryshim në çmimet relative nga rritja e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, pra inflacionit. Një konfuzion i tillë ndodh zakonisht në rastet kur inflacioni i lartë. Për më tepër, inflacioni i lartë do të thotë shpesh edhe një inflacion i ndryshueshëm, çka rrit edhe më tej pasigurinë. Si rezultat i saj, burimet mund të drejtohen ndaj përdorimeve të gabuara gjatë periudhave inflacioniste.

- Përveç asaj çka u përmend më lart, inflacioni mund të përbëjë problem për vlerësimin e normës reale të interesit. Norma reale e interesit (norma nominale e interesit e korrigjuar me inflacionin) është çmimi relativ i mallrave të tanishëm ndaj atyre që do të prodhohen në të ardhmen. Norma reale e interesit është ajo që udhëheq vendimet e individëve për konsum apo për kursim dhe vendimet e firmave për investime. Ajo nuk jepet në mënyrë të dukshme si çmim i tregut por llogaritet nga individët duke i zbritur apo shtuar normës nominale të interesit inflacionin e pritshëm. Kur inflacioni është i ndryshueshëm, detyra për të përcaktuar normën reale të interesit bëhet akoma më e vështirë. Alokimi apo drejtimi jo i përshatshëm i burimeve, në këto kushte do të ndikojë negativisht mbi rritjen ekonomike dhe standardet e jetesës, pasi burimet nuk vihen në përdorimin më të mirë të mundshëm.

- Pa një indeksim të përgjithshëm, inflacioni mund të rezultojë në transferime të paparashikueshme të pasurisë. Nëse sistemi tatimor nuk është i indeksuar me ndryshimin e çmimeve, inflacioni mund të zbehë nxitjen për investime dhe punë[2]. Gjithashtu, inflacioni ndikon në rishpërndarjen e burimeve nga shtresat me të ardhura fikse (nëpunësit, pensionistët) tek ata me të ardhura të indeksuara me inflacionin (prodhuesit dhe tregtarët).

[2] Dihet se forma më e përhapur e sistemit tatimor është ajo progresive, që do të thotë se shtresat e popullsisë me të ardhura më të mëdha duhet të paguajnë tatime më të larta në raport me të ardhurat e tyre. Për shembull, për të ardhura mujore deri në 10.000 lekë ju paguani 10% tatim ndërsa për të ardhura mbi 10.000 lekë ju paguani 12% tatim. Nëqoftëse do të supozojmë se për efekte të inflacionit (supozojmë një normë inflacioni 10%) e ardhura juaj rritet nga 9.500 lekë në 10.450 lekë, ju nuk do të paguani më 10% tatim, por 12%. Për të shmangur këtë ulje të të ardhurave reale, sistemi tatimor rekomandohet të jetë i indeksuar me inflacionin, pra klasat e tatimeve të ndryshojnë me ndryshimin e inflacionit.

Të gjitha këto efekte, janë më pak të ndjeshme kur inflacioni është vazhdimisht i ulët. Sa më tepër të ketë sukses një bankë qendrore në uljen e inflacionit, aq më tepër ekonomia i afrohet drejtimit apo shfrytëtzimit optimal të burimeve, gjë kjo që do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe ngritjen e standardeve të jetesës.

B. Stabiliteti financiar.

Arsyeja e dytë pse inflacioni pengon rritjen ekonomike është se ai ndikon në stabilitetin financiar. Një ekonomi me inflacion të ulët ka më pak të ngjarë të përjetojë luhatje të theksuara në çmimet e aseteve dhe në pritshmëritë për këto çmime. Problemet e lidhura me keqvlerësimin e çmimeve të aseteve dhe parashikimet për to, nuk janë shumë të ndryshme nga konfuzioni për ndryshimet në çmimet relative dhe ato të përgjithshme që u përshkruan pak më sipër. Investitorët dhe kreditorët mund t'i keqintepretojnë sinjalet që marrin nga çmimet dhe të nxjerrin konkluzione të gabuara. Në këto rrethana, burimet financiare nuk shfrytëzohen siç duhet. Stabiliteti financiar është i domosdoshëm për një ekonomi të shëndetshme.

- Vendimet për kreditimin që përcaktojnë shfrytëzimin e burimeve financiare mund të jenë më pranë nivelit optimal në një ekonomi me inflacion të ulët. Ky përfundim rrjedh nga ideja që bankierët dhe klientët e tyre bëjnë zakonisht një punë më të mirë për vlerësimin e ecurisë së biznesit në një atmosferë çmimesh relativisht të qëndrueshme;

- Stabiliteti financiar rrit aftësitë e një ekonomie për të zbutur goditjet e mundshme: rritjen e çmimeve të energjisë, ndryshime të theksuara teknologjike, zhvillime të paparashikuara në ekonomitë e shteteve partnere në tregti, e kështu me radhë. Ngjarje të tilla sjellin keqpërdorim të burimeve por një sistem financiar i shëndoshë mund 't'i thithë' këto goditje pa lejuar që ato të dëmtojnë aktivitetin ekonomik. Në këto rrethana, rritja reale do të ndikohej më pak nga ç'do të ndikohej në kushtet ku sektori financiar do të zmadhonte dhe përhapte efektet e goditjes. Për më tepër, ka të ngjarë që efektet e goditjeve dhe reagimet e duhura të jenë më lehtë të identifikueshme në një mjedis jo-inflacionist.

I.2 PSE DUHET PRANUAR INFLACIONI?

Megjithë ekspozenë e mësipërme dhe konsensusin e arritur mbi pasojat negative të inflacionit në aktivitetin ekonomik në një periudhë afatgjatë, praktika tregon se asnjë bankë qendrore nuk ka si objektiv të vetin një nivel inflacioni 0. Në gjuhën teknike thuhet se objektivi i stabilitetit të çmimeve përkthehet në një objektiv inflacioni pozitiv, në nivele të ulta, por jo 0. Në vijim, do të parashtrojmë shkurtimisht disa arsye pse duhet pranuar inflacioni i ulët inflacioni në ekonomi:

- Ashtu siç u theksua edhe më sipër, inflacioni paraqet një rritje të përgjithshme të nivelit të çmimeve në ekonomi. Por, ekonomia është vazhdimisht në lëvizje: shijet e konsumatorëve ndryshojnë ndërsa inovacionet teknologjike prezantojnë produkte të reja në treg apo ulin kostot e prodhimit. Të gjithë këta faktorë janë burim për lëvizjen e çmimeve relative të mallrave në ekonomi, e cila ka si pasojë riorientimin e burimeve të ekonomisë drejt produkteve më fitimprurëse. Lëvizja relative e çmimeve ushtron presion për rritjen e nivelit të çmimeve për një arsye të thjeshtë: çmimet kanë njëfarë rezistence në ulje por jo në rritje. Normalisht, ju mund të shikoni një çmim të rritur trefish, por vështirë se mund të gjendet një shembull i reduktimit të çmimit në një të tretën. Në qoftë se politika monetare do të orientohej drejt një niveli inflacioni 0, ajo do të pengonte lëvizjen relative të çmimeve dhe ristrukturimin e ekonomisë në përputhje me realitetin e ri. Kjo lëvizje është edhe më e madhe në një ekonomi në zhvillim. Për këtë arsye, vendet në zhvillim, një ndër të cilat është dhe Shqipëria, pranojnë objektiva më të lartë inflacioni se vendet e zhvilluara.

- Diskutimi mbi efektet negative të inflacionit, duhet vendosur në një sfond krahasues. Kështu, deflacioni (e kundërta e inflacionit apo ulja e nivelit të përgjithshëm të çmimeve) është më i dëmshëm për ekonominë sesa inflacioni. Në një situatë ku çmimet bien dita-ditës, vendimet për konsum do të bien, në pritje të çmimeve më të ulta dhe më të favorshme. Po kështu, deflacioni rrit koston reale të huamarrjes dhe, për rrjedhojë, dekurajon vendimet e kompanive për investime. Ulja e konsumit dhe e investimeve do të sillte pa dyshim një ngadalësim të aktivitetit

ekonomik. Në këtë mënyrë, nëqoftëse banka qendrore do të synonte një inflacion 0, ajo do të mbante përsipër rrezikun e situatave deflacioniste.

- Inflacioni thuhet shpesh se maskon aspektin cilësor të mallrave dhe shërbimeve. Nevoja për të qenë konkurrentë apo dhe thjesht akumulimi i eksperiencës në fushat respektive, bën që firmat të ofrojnë produkte gjithnjë e më cilësore në treg. Por ndryshimi ciësor nuk reflektohet i gjithi në çmimin e produktit. Për shembull, megjithëse një aparat telefoni celular mund të ketë të njëjtin çmim në treg, teknologjia, funksionet dhe cilësia e tij janë mjaft më të larta sot në krahasim me dy vjet më parë. Nga ky këndvështrim, mund të themi se tolerimi i një niveli të ulët inflacioni është "çmimi" që duhet të paguajë shoqëria për të garantuar ekzistencën e stimulit ekonomik për inovacione teknologjike.

Si përfundim, mund të thuhet se ndërsa efektet negative të inflacionit në ekonomi dihen dhe janë të pranuara gjerësisht, asnjë bankë qendrore nuk barazon stabilitetin e çmimeve me ruajtjen e inflacionit në nivelin 0. Në praktikë, vendet e zhvilluara[3] synojnë një inflacion rreth nivelit 2 për qind. Për vendet në zhvillim, diapazoni i objektivit të inflacionit është më i gjerë. Në vendet e Evropës Lindore, një ndër të cilët është dhe Shqipëria, mund të thuhet se përgjithësisht ky objektiv luhatet rreth nivelit 3-5 për qind.

II. INSTRUMENTET MONETARE DHE POLITIKA MONETARE.

Deri në këtë pikë është bërë e qartë se inflacioni i ulët mund të ketë efekte të dukshme në rritjen dhe zhvillimin ekonomik nëpërmjet efektit që ai ka në shfrytëzimin e burimeve reale dhe në stabilitetin financiar.

Një nga pikat e pakta për të cilat shumë makroekonomistë bien dakord është që inflacioni është pikësëpari dhe më së shumti një fenomen monetar. Ai ndodh si pasojë e krijimit, për një periudhë afatgjatë, të parasë në një masë që e kalon prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në ekonomi. Për më tepër, është arritur në konsensus se oferta e parasë përcaktohet nga banka qendrore në një periudhë afatgjatë. Në këtë mënyrë, me një politikë të përshtatshme, banka qendrore mund të arrijë dhe të ruajë nivele të ulëta inflacioni në një periudhë afatgjatë. Në një kuptim të gjerë banka qendrore duhet të ketë si përgjegjësi të saj rritjen e parasë në përputhje me nivele të ulëta të inflacionit. Nëse banka qendrore e arrin këtë, vendi do të ketë përfitime të rëndësishme ekonomike.

E drejta si edhe detyrimi për të kontrolluar krijimin e parasë në një periudhë afatgjatë, lejon luhatje të theksuara në lëvizjen afatshkurtër të parasë. Në të kaluarën agregatët monetarë përdoreshin për të lidhur periudhën afatshkurtër me atë afatgjatë. Megjithëse ndikimi i agregatëve monetarë në nivelin e çmimeve në ekonomi nuk diskutohet, fortësia dhe koherenca e kësaj lidhjeje janë zbutur. Lidhja afatshkurtër midis parasë dhe ekonomisë ka ardhur duke u dobësuar.

Për këtë arsye, horizonti optimal kohor në të cilin duhet të veprojë politika monetare është ai afatmesëm. Bankat qendrore i kushtojnë pak rëndësi interpretimit të lëvizjeve afatshkurtra dhe reagimit ndaj tyre. Një rrjedhim i rëndësishëm i këndvështrimit afatgjatë të bankave qendrore është nevoja për një pavarësi reale të tyre. Politikat ekonomike të qeverive, shpesh janë provuar të jenë politika të kufizuara nga horizonti kohor i mandatit qeverisës. Garantimi i stabilitetit makroekonomik dhe kontrolli i inflacionit kërkojnë politika afatgjata, jashtë konsideratave politike. Koncepti i pavarësisë së bankave qendrore nga politika ka gjetur konsensusin akademik dhe praktik në të gjithë botën.

II.1 MEKANIZMI I TRANSMISIONIT.

Në mënyrë që ndërhyrja e një banke qendrore të jetë e suksesshme, ajo duhet të ketë të qartë

[3] Këtu duhen përmendur: Sh.B.A., vendet e Evropës Perëndimore, Kandaja, Australia, Zelanda e Re, Japonia etj..

mënyrën se si përcillet në ekonomi politika e saj monetare. Mekanizmi i transmisionit përmbledh kanalet nëpërmjet të cilave instrumentet e politikës monetare ndikojnë aktivitetin real ekonomik dhe përmbushin objektivin e inflacionit. Në vija të përgjithshme, mekanizmin e transmisionit mund ta përmbledhim me skemën e mëposhtme:

3. Ndryshimi i normave nominale të interesit, në një periudhë afatshkurtër, shndërrohet në një ndryshim të normës reale të interesit. Ndryshimi i normave reale ndikon nivelin e kërkesës agregate në ekonomi. Në veçanti, normat reale të interesit ndikojnë dy komponentë përbërës të saj:

Figura 1. Mekanizmi i transmisionit të politikës monetare[4].



Duke iu referuar skemës së mësipërme, mund të bëjmë një analizë të shkurtër të funksionimit të mekanizmit të transmisionit.

1. Zbatimi i politikës monetare fillon nëpërmjet instrumenteve të saj. Banka qendrore është në gjendje të kontrollojë me saktësi vetëm përdorimin e këtyre instrumenteve. Duke lëvizur nga e majta në të djathtë të skemës, ndikimi i politikës monetare vjen duke u zbehur.

2. Instrumentet e politikës monetare përcaktojnë nivelin e likuiditetit në tregun ndërbankar dhe ndikojnë në normën nominale të interesit të tregut ndërbankar[5]. Gjithashtu, niveli i likuiditetit ushtron ndikim edhe në kursin e këmbimit.

- Konsumin. Niveli i normave të interesit ndikon vendimet e individëve për konsum/investime. Rritja e normës së interesit rrit kursimet në ekonomi, duke ulur konsumin, dhe anasjelltas. Një kanal i dytë nëpërmjet të cillit normat e interesit ndikojnë konsumin është i ashtuquajturi *efekti i pasurisë* (wealth effect). Ulja e normave të interesit rrit vlerën e aseteve financiare të individëve, duke rritur pasurinë e tyre dhe duke nxitur kosumin e tyre.

- Investimet. Ulja/rritja e normës reale të interesit ul/rrit koston reale të huamarrjes, duke ndikuar në nivelin e investimeve në ekonomi. Por ka dhe dy rrugë të tjera me anë të të cilave ndryshimi i normave të interesit ndikon në nivelin e investimeve. (a) *Kanali i ngushtë i kredisë* (narrow credit channel): ulja e normave të

[4] Me vija të ndërprera janë pasqyruar lidhjet, fortësia e të cilave mendohet se ka një ndikim dytësor në mekanizmin e transmisionit. Kjo skemë duhet konsideruar vetëm si një skemë orientuese, për të struktuar diskutimin në vijim. Ajo nuk pretendon të jetë një skemë e plotë e të gjitha kanaleve të mundshme të mekanizmit të transimisionit.
[5] Mënyrën se si instrumentet e politikës monetare ndikojnë normat e interesit të tregut ndërbankar do ta sqarojmë në vijim.

interesit presupozon rritje të likuiditetit, çka do të thotë më shumë fonde në dispozicion të ekonomisë, dhe anasjelltas. (b) *Kanali i gjerë i kredisë* (broad credit channel): ulja e normave të interesit sjell rritje të vlerës së aseteve financiare, çka do të thotë se firmave iu rritet niveli i kolateralit që kanë në dispozicion dhe, rrjedhimisht, edhe mundësia për të marrë kredi.

4. Ndryshimi i normave të interesit ndikon në pritjet e agjentëve ekonomikë për inflacionin. Këto pritje janë një input shumë i rëndësishëm në mekanizmin e përcaktimit të çmimeve, sidomos për ato ekonomi të cilat funksionojnë mbi bazën e kontratave afatgjata të pagave. Ndryshimi i normave të interesit sinjalizon publikun për politikën e bankës qendrore në lidhje me inflacionin. Niveli i besimit të publikut në bankën qendrore bën që ai të reagojë duke modifikuar pritjet inflacioniste, edhe pa u shfaqur ende efektet reale të ndryshimit të normës së interesit. Sa më e besueshme të jetë politika monetare dhe sa më kredibël të jetë institucioni i bankës qendrore aq më i fortë është ky kanal dhe aq më i lehtë është kontrolli i inflacionit.

5. Ndryshimi i normave të interesit ndikon nivelin e kursit të këmbimit[6]. Mekanizmi nëpërmjet të cilit bëhet i mundur ky ndikim është i ashtuquajturi UIP (Uncovered Interest rate Parity)[7]. Sipas tij, monedhat të cilat kanë norma interesi relativisht të larta pritet të mbiçmohen dhe anasjelltas, monedhat të cilat kanë norma interesi relativisht të ulta pritet të nënçmohen. Në vendet e zhvilluara kjo realizohet nëpërmjet lëvizjes ndërkombëtare të kapitalit. Në Shqipëri, megjithëse mungojnë flukset afatshkurtra të kapitalit ndërkombëtar, ky efekt realizohet nëpërmjet sasisë të konsiderueshme të valutës që ekziston në ekonomi. Më konkretisht, gjatë vitit 2003, diferenca e normave të interesit midis lekut dhe valutave, ka ushtruar vazhdimisht presion për mbiçmimin e lekut.

6. Ndikimi i kursit të këmbimit në inflacion formon atë që quhet kanali i kursit të këmbimit. Ky kanal mund të ndahet në tre pjesë:

- Ndryshimi i kursit të këmbimit ndikon në nivelin e inflacionit të importuar[8]. Me inflacion të importuar do të kuptojmë atë inflacion që vjen në ekonomi si pasojë e konsumit në ekonomi të mallrave të importit. Kuptohet që një nënçmim i lekut do të rriste çmimin e tyre dhe, si rrjedhim do të rriste edhe inflacionin e importuar. Ekonomia shqiptare është një ekonomi me një bazë të vogël prodhuese dhe, si rrjedhim, mjaft e ekspozuar ndaj këtij kanali.

- Kursi i këmbimit ndikon në kompetitivitetin e eksporteve të një vendi, në bilancin tregtar (eksportet neto) dhe në kërkesën agregate[9].

- Kursi i këmbimit ushtron një ndikim psikologjik në përcaktimin e çmimeve në ekonomi[10]. Në këtë mënyrë ai ndikon në pritjet inflacioniste dhe në inflacionin real.

7. Ndryshimi i konsumit, i investimeve dhe i bilancit tregtar ndikojnë në nivelin e kërkesës agregate. Kjo ilustron një fakt shumë të rëndësishëm. Në fakt, politika monetare është një instrument për kontrollin e kërkesës agregate në ekonomi. Por, ajo që është më e rëndësishme për inflacionin dhe që përcakton së fundi nivelin e tij është output-gap-i ose diferenca midis produktit aktual dhe produktit potencial[11]. Në qoftë se kjo diferencë është pozitive, kërkesa agregate ushtron presion për inflacion. Në qoftë se kjo diferencë është negative, niveli i aktivitetit të brendshëm ekonomik nuk është burim për presione inflacioniste.

Mekanizmi i transmisionit është mjaft i rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e politikës monetare. Ai përshkruan mënyrën se

[6] Efektet e përshkruara në shënimin 4 dhe në shënimin 5 formojnë atë që quhet kanali i normave të interesit.
[7] Megjithëse vitet e fundit po rritet literatura e cila vë në pikëpyetje efektin e këtij mekanizmi, këto studime mbeten thjesht në formën e konstatimeve empirike, kjo do të thotë se efekti i këtij mekanizmi mbetet i pranishëm, por ai zbehet nga një sërë faktorësh si pritjet e agjentëve ekonomikë dhe natyra shpesh spekulative e tregjeve valutore.
[8] Në literaturë ky efekt njihet si exchange rate pas-through. Ndikimi i tij mendohet se është afatshkurtër dhe mjaft i konsiderueshëm në vendet në tranzicion. Studimet empirike në Shqipëri tregojnë se nënçmimi i lekut rrit inflacionin brenda një periudhe njëmujore.
[9] Për ekonominë shqiptare, ku eksportet janë kryesisht lëndë të para ose mallra me material porositësi, ky ndikim është mjaft i dobët,
[10] Ky kanal nuk është paraqitur në skemën e mësipërme të mekanizmit të transmisionit.

si funksionon politika monetare në të gjitha aspektet e saj, duke filluar nga instrumentet e politikës monetare deri në ndikimin e tyre në inflacion. Ndërkohë, duke patur parasysh mekanizmin e transimisionit, hartimi i politikës monetare ndjek rrugën e kundërt, pra ai fillon nga objektivi i inflacionit dhe vazhdon me përcaktimin e kuadrit të përgjithshëm të politikës monetare dhe përdorimin e instrumenteve të politikës monetare për përmbushjen e tyre.

II.2 KUADRI I PËRGJITHSHËM I POLITIKËS MONETARE.

Politika monetare konceptohet dhe konkretizohet nëpërmjet objektivave të ndërmjetëm dhe operacionalë dhe kuadrit të instrumenteve të saj.

Politika monetare vepron në ekonomi me njëfarë vonese[12]. Kjo vonesë kushtëzohet nga përcjellja e vendimeve të politikës monetare në tregjet financiare dhe nga reagimi i tregjeve dhe i ekonomisë ndaj tyre. Sa më pak të zhvilluara të jenë tregjet financiare dhe sa më e dobët të jetë lidhja e tyre me aktivitetin e sektorit real të ekonomisë aq më e gjatë është kjo periudhë kohore. Për këtë arsye, banka qendrore duhet të reagojë ndaj zhvillimeve të pritshme në inflacion dhe jo ndaj ecurisë aktuale të inflacionit, sepse kjo e fundit është jashtë mundësisë së ndikimit të saj. Kjo i detyron bankat qendrore të zhvillojnë instrumente dhe procedura që i lejojnë ato të reagojnë në avancë ndaj zhvillimeve të pritshme në inflacion. Bankat qendrore përdorin tregues të tjerë për të vlerësuar nevojën për ndërhyrje të politikës monetare dhe efektivitetin e saj. Këta tregues njihen si *objektiva të ndërmjetëm* dhe *objektiva operacionalë.*

Objektivi i ndërmjetëm[13] realizon lidhjen midis objektivit të inflacionit dhe një treguesi, i cili mund të përdoret si sinjalizues i hershëm i nivelit të tij. Teorikisht, objektivat e ndërmjetëm duhet të plotësojnë dy kushte: (i) ata duhet të kenë një lidhje të fortë dhe të qëndrueshme me objektivin përfundimtar dhe (ii) objektivat e ndërmjetëm duhet të jenë nën kontrollin e bankave qendrore.

Megjithatë, as objektivat e ndërmjetëm nuk mund të jenë nën kontroll të plotë nga autoritetet. Për më tepër, ekzistojnë vonesa kohore që zbehin kontrollin e autoriteteve monetare mbi nivelin e objektivave të ndërmjetëm. Për këtë arsye, del nevoja për të identifikuar objektiva operacionalë, të cilët vendosin një lidhje midis instrumenteve të një banke qendrore dhe objektivave të ndërmjetëm të saj. Si rregull, ecuria e objektivave operacionalë mund të monitorohet me frekuenca mjaft të shkurtra, zakonisht ditore ose javore. Objektivat operacionalë mund të ndahen në dy grupe të medha:

- objektiva sasiorë, të cilët synojnë kontrollin e likuiditetit të sistemit bankar ose të një agregati tjetër monetar, i cili është nën kontroll të plotë të bankës qendrore; dhe,

- objektiva cilësorë, si normat e interesit në tregun ndërbankar.

Objektivat e ndërmjetëm dhe ata operacionalë ndryshojnë në varësi të regjimit të politikës monetare të aplikuar. Në vijim, do të ndalemi në regjimet kryesore të politikës monetare që sugjeron praktika botërore, implikimet e tyre për përcaktimin e objektivave të ndërmjetëm dhe operacionalë, regjimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe kuadrin e saj të objektivave.

[11] Produkti potencial është një koncept teorik. Ai tregon nivelin e produktit (PBB-së) që do të ishte në ekonomi në kushtet e punëzënies së plotë, Si punëzënie e plotë nuk konsiderohet një nivel papunësie 0. Në fakt, në ekonomi pranohet se duhet të ketë një nivel papunësie duke reflektuar ndryshimin dhe ristrukturimin e ekonomisë. Si nivel i punëzënies në kushtet e produktit potencial përdoret e ashtuquajtura NAIRU (Non Accelerating-Inflation Rate of Unemployement).

[12] Studime të ndryshme kanë treguar se horizonti khor gjatë të cilit ndikimi i politikës monetare shfaqet i plotë shkon nga 6 në 24 muaj.

[13] Objektivi i ndërmjetëm shpesh njihet edhe si ankorë (nominal anchor), sepse ai shpallet dhe shërben për të orientuar pritjet e agjentëve ekonomikë.

II.3 REGJIMET KRYESORE TË POLITIKËS MONETARE.

Regjimet kryesore të politikës monetare janë:

- targetimi i kursit të këmbimit;
- targetimi monetar;
- targetimi i inflacionit.

TARGETIMI I KURSIT TË KËMBIMIT[14].

Në këtë regjim, bankat qendrore synojnë kontrollin e kursit të këmbimit, duke e parë këtë të fundit si përcaktuesin kryesor të zhvillimeve ekonomike. Fiksimi i monedhës kombëtare kundrejt një valute të huaj (ose një shporte të valutave të huaja) arrin objektivin e qëndrueshmërisë së çmimeve[15] dhe nxit shkëmbimet tregtare, duke ulur pasigurinë e kursit të këmbimit.

Në varësi të fortësisë së angazhimit të bankës qendrore për të ruajtur kursin e këmbimit, këto regjime mund të shkojnë nga regjime të kursit të këmbimit të administruar në regjime të kursit të këmbimit në "currency board", ose adoptim i monedhes së një vendi të huaj.

Ruajtja e një niveli të caktuar të kursit të këmbimit kërkon që banka qendrore të jetë vazhdimisht e pranishme në tregun valutor, duke qenë e gatshme të blerë dhe të shesë valutë me kurset e caktuara. Në këtë kënvdështrim, ky regjim i politikës monetare nuk kërkon vendosjen e objektivave të ndërmjetëm dhe operacionalë.

TARGETIMI MONETAR[17].

Baza teorike e këtij regjimi të politikës monetare është pikëpamja monetariste se inflacioni është një fenomen monetar. Duke u nisur nga kjo,

Box 1. Variantet e mundshme të targetimit të kursit të këmbimit:

Managed floating -	*Banka qendrore synon kontrollin e lëvizjeve të kursit të këmbmit, por pa bërë angazhime formale në publik.*
Soft peg[16] -	*Banka qendrore angazhohet në ruajtjen e një niveli të caktuar të kursit të këmbimit, duke e përkufizuar këtë në formën e një intervali me një tolerance relativisht të konsiderueshëm.*
Hard peg -	*Banka qendrore angazhohet në ruajtjen e një niveli të caktuar të kursit të këmbimit, me nje interval minimal tolerance.*
Currency board -	*Është një regjim i rreptë i fiksimit të kursit të këmbimit. Ai përmbledh një mekanizëm të ngurtë angazhimesh institucionale me anë të të cilave banka qendrore angazhohet të hedhë në qarkullim monedhë kombëtare vetëm nëse në rezervat e saj valutore hyn sasia korresponduese e valutës së huaj, sipas një kursi të fiksuar.*
Adoptim i një valute të huaj -	*Praktikisht një vend heq dorë nga e drejta e tij sovrane për të emetuar monedhën kombëtare dhe njeh si mjet këmbimi zyrtar për të gjitha transaksionet e zhvilluara një valutë të huaj.*

[14] Këtë strategji e ndjekin shumë vende të rajonit si Bullgaria, Maqedonia, Kroacia, Bosnja, vendet balltike, etj..
[15] Përgjithësisht, kursi i këmbimit fiksohet kundrejt një valute të fortë, si për shembull dollari amerikan ose euro. Me fiksimin e kursit të këmbmit kundrejt valutës së një vendi tjetër, importohet edhe inflacioni i atij vendi. Euro dhe usd karakterizohen nga norma inflacioni relativisht të ulta, prandaj edhe ky regjim i politkës monetare siguron qëndrueshmëri të çmimeve megjithëse nuk e ka atë objektivin primar të deklaruar nga banka qendrore.
[16] Niveli i kursit të këmbimit dhe intervali i tolerancës që e shoqëron atë mund të ndryshojnë në varësi të kohës. Në këtë rast kemi atë që quhet crawling peg.
[17] Këtë strategji e kanë ndjekur vende të tilla si: RFGJ, SHBA, Cekia, Rumania, Ish-Jugosllavia, etj.. Kohët e fundit po vihet re një tendencë e shmangies së kësaj metode,

bankat qendrore synojnë që kontrollin e inflacionit ta realizojnë nëpërmjet kontrollit të nivelit të mjeteve monetare në ekonomi. Synimi i politikës monetare është përafrimi i ofertës monetare me kërkesën e ekonomisë për mjete monetare reale.

Këto regjime kërkojnë si objektiv të ndërmjetëm të tyre kontrollin e nivelit të agregatëve monetarë. Si rregull, objektiv i ndërmjetëm është rritja e ofertës monetare. Ky regjim i politikës monetare mund t'i pranojë të dy tipet e objektivave operacional. Si kontrolli i nivelit të bazës monetare ashtu dhe ai i normave të interesit në tregun e parasë ndikojnë në ekspansionin e ofertës së parasë. Të dy këta variabla mund të kontrollohen nga instrumentet e politikës monetare.

TARGETIMI I INFLACIONIT[18].

Targetimi i inflacionit është aktualisht regjimi më në modë ndër vendet e zhvilluara. Nga ana konceptuale, ai i bazon vendimet e politikës monetare në parashikimin e inflacionit duke shfrytëzuar të gjithë informacionin e mundshëm. Adoptimi i një regjimi të tillë kërkon studimin në detaje të mekanizmit të transmetimit dhe zbërthimin e tij në një model të integruar ekuacionesh. Targetimi i inflacionit është regjimi më i saktë i politikës monetare, sepse ai shfrytëzon të gjitha njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të ekonomisë dhe dinamikën e ndërveprimit të sektorëve të saj.

Objektivi i ndërmjetëm i një regjimi të tillë është vetë parashikimi i inflacionit[19]. Ndërsa si objektiva operacionalë përdoren normat e interesit në tregun ndërbankar.

Banka e Shqipërisë, zbaton regjimin e targetimit monetar[20]. Për arritjen e objektivit të saj të inflacionit, Banka e Shqipërisë përdor si objektiv të ndërmjetëm normën vjetore të rritjes së ofertës së parasë. Ajo synon të sigurojë një rritje të sasisë së parasë gjithsej që të përputhë kërkesën me ofertën për para dhe të përshtatë rritjen reale të ekonomisë me objektivin e inflacionit. Në rast të mospërputhjeve do të kemi rritje të inflacionit dhe/ose zhvlerësim të kursit të këmbimit (në rast se oferta për mjete monetare është më e madhe se kërkesa); ose dizinflacion dhe/ose mbiçmim të kursit të këmbimit (në rast se kërkesa është më e madhe se oferta). Kontrolli i rritjes së parasë për të ruajtur stabilitetin e çmimeve do të thotë se Banka e Shqipërisë shikon te niveli i mjeteve monetare në ekonomi një shpjegues të rëndësishëm të nivelit të çmimeve në të.

III. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË.

Fillimisht, instrumenti kryesor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë ka qenë kontrolli i nivelit minimal të normave të interesit të bankave me kapital shtetëror dhe kontrollet mbi kreditin e bankave. Këto instrumente futen në grupin e instrumenteve direkte. Ato janë në fakt masa administrative që kufizojnë aspekte të caktuara të tregut financiar. Si të tilla, ato janë të dëmshme dhe, kudo ku zhvillimi i tregjeve financiare arrin një nivel të tillë që i mundëson, janë zëvenëdsuar nga instrumentet indirekte të politikës monetare.

Marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta të riblerjes (repot dhe repot e anasjellta) janë prezantuar në vitin 2000 dhe gradualisht u bënë mbizotëruese. Në muajin shtator të vitit 2000, Banka e Shqipërisë eleminoi kontrollin e normave të interesit të depozitave, duke kaluar tërësisht në instrumentet indirekte të politikës monetare. Avantazhi i këtyre instrumenteve është se ato veprojnë në përputhje me logjikën e tregut, duke mos shkaktuar deformime në të. Banka qendrore ndikon aktivitetin e tregut financiar duke qenë thjesht një pjesëmarrës në të[21].

[18] Këtë strategji e ndjekin vende të tilla si Zelanda e Re, Australia, Kandaja, Cekia, Hungaria, Turqia etj.. Banka Qendrore Europiane mund të mendohet sendjek një version shumë të modifikuar të saj.
[19] Funksioni kryesor i objektivit të ndërmjetëm është vlerësimi i hershëm i përshtatshmërisë së politikës monetare, me qëllim që t'i japë asaj kohën e duhur për të reaguar.
[20] Së fundi, Banka e Shqipërisë ka bërë publik angazhimin e saj për adoptimin e regjimit të targetimit të inflacionit në një periudhë afatmesme.
[21] Megjithatë, duhet pranuar se banka qendrore është njëpjesëmarrës i privilegjuar, duke u nisur nga sasia e fondeve që ajo ka në dispozicion dhe shkalla e informacionit.

Box 2. Instrumentet indirekte të politikës monetare.

Për një kohë relativisht të gjatë (1992-2000) zbatimi i politikës monetare iu besua dy instrumenteve kryesore, kufirit të kredisë dhe përqindjes së detyruar të interesit të depozitave me afat në lekë. Këto instrumente, në vetvete ishin thjesht dy vendime administrative të Bankës së Shqipërisë të cilat konsistonin në rritjen e kufizuar të tepricës së kredisë nga ana e bankave tregtare si dhe në detyrimin që kishin bankat me kapital shtetëror për të respektuar nivelin minimal të normës së interesit për depozitat me afat në lekë të shpallur nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Kufiri i kredisë. Sistemi bankar i pazhvilluar dhe mosprania e një tregu formal të zhvilluar të kredisë, i imponuan Bankës së Shqipërisë, domosdoshmërinë, që duke filluar nga mesi i vitit 1992, të kontrollonte sasinë e kredisë të dhënë sektorit
joqeveritar, nëpërmjet aplikimit të kufijve të kreditit në mënyrë të veçantë për çdo bankë të sistemit bankar. Për të siguruar një lloj fleksibiliteti si dhe për të inkurajuar bankat që të fillonin forma të thjeshta të transaksioneve ndërbankare, u pa e arsyeshme që kufijtë të ishin të tregtueshëm.

Problemet e hasura ishin të shumta, sidomos në lidhje me raportimin dhe me mbikëqyrjen e respektimit të kufijve të akorduar. Kredia e re për sektorin privat filloi të rritet me ritme të shpejta, dhe në fund të vitit 1993, ajo zinte rreth 11 për qind të totalit të kredisë krahasuar me 4 për qind që ishte një vit më parë. Për shumë arsye objektive dhe subjektive, respektimi i këtyre kufijve, në shumë raste, u bë i pamundur, duke ulur eficiencën e këtij instrumenti.

Shtimi i huamarrjes në sektorin informal të ekonomisë, uli gradualisht kërkesën për kredi ndaj sistemit bankar, ndërkohë që, duke filluar nga muaji maj 1995, sistemit bankar iu shtua dhe një alternativë tjetër investimi, bonot e thesarit. Në këtë mënyrë, roli i kufirit të kredisë ra ndjeshëm dhe sidomos pas krizës së vitit 1997, kur, si për shkaqe të normave të mbikëqyrjes bankare ashtu dhe për arsye të skepticizmit që karakterizon sistemin bankar ndaj biznesit privat në përgjithësi, ky instrument filloi të humbasë kuptimin e tij derisa në vitin 1999, u hoq dorë përfundimisht nga aplikimi i mëtejshëm i tij.

Përqindja e interesit. Me fillimin e përpjekjeve për stabilizimin e ekonomisë, në mesin e vitit 1992, akordimi i një përqindjeje reale të kthimit të depozitave në lekë u mendua se do të ishte kyçi kryesor në arritjen e suksesit, sidomos për mobilizimin e burimeve dhe të investimeve financiare. Lëvizja e parë ishte rritja e përqindjes minimum për depozitat me afat në lekë, nga nivele të ulta në 4 – 8 për qind në 22 – 32 për qind (respektivisht për depozitat tre dhe dymbëdhjetë mujore). Efekti i kësaj rritjeje, në dy tre vitet e para të tranzicionit ishte i dukshëm. Frenimi i hemoragjisë së parasë, përkoi me një rritje të depozitave në sistem, ndërkohë që inflacioni u frenua ndjeshëm duke zbritur në mënyrë konstante deri sa arriti në një nivel njëshifror, në fundin e vitit 1995.

Periudha 1996 – 1997, me lindjen e fenomenit fajde, përkon me një kolaps total të rolit të përqindjes së interesit dhe të vetë politikës monetare të asaj kohe, derisa vijmë në një periudhë tjetër rritjeje të madhe të përqindjes administrative të interesit për depozitat me afat në lekë. Zhvillimet e faktuara në inflacion, gjatë periudhës 1999 – 2000, ishin të pazakonta, pasojë e tyre ishte një zbutje e vazhdueshme e kushteve të politikës monetare përgjatë gjithë kësaj periudhe. Në këtë mënyrë vijmë në tremujorin e tretë të vitit 2000, kur reagimi i bankave nuk po ndiqte më uljet e vazhdueshme të përqindjes administrative, nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Në këto rrethana u mor në konsideratë, një rikonceptim i tërë kuadrit operacional të deriatëhershëm, dhe u vendos që politika monetare e Bankës së Shqipërisë të bazohej vetëm në zbatimin e instrumenteve të tregut. Roli i përqindjes bazë në ekonomi iu dha normës së interesit të marrëveshjes së riblerjes (repove), transaksione këto që do të zhvilloheshin në ankande të rregullta javore, të cilat do të mbaheshin nga ana e Bankës së Shqipërisë.

III.1 KUADRI AKTUAL I INSTRUMENTEVE MONETARE.

Kuadri aktual i instrumenteve të Bankës së Shqipërisë është modeluar sipas atij të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe është mjaft i ngjashëm me të. Kuadri i instrumenteve përbëhet nga:

- operacionet e tregut të hapur;
- operacionet lehtësuese të Bankës së Shqipërisë; dhe,
- rezerva e detyruar.

III.1.1 OPERACIONET E TREGUT TE HAPUR.

Operacionet e tregut të hapur përmbledhin:

- Marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta[22]);
- transaksionet me të drejta të plota;
- ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në valutë.

Funksioni i këtyre instrumenteve është administrimi i likuiditetit dhe i normave të interesit në tregun ndërbankar. Marrëveshja e riblerjes ose repoja, është instrumenti kryesor i Bankës së Shqipërisë. Ai përcjell edhe politikën monetare të saj. Funksioni i repos është i dyfishtë: (i) ajo përdoret për administrimin e nivelit të likuiditetit në sistem dhe (ii) shërben si orientuese për nivelin e normave të interesit në ekonomi.

MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE ATO TË ANASJELLTA TË RIBLERJES.

Marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta të riblerjes luajnë rolin kryesor në transmetimin e politikës monetare. Ato kanë për qëllim të rregullojnë normën e interesit në treg, të administrojnë likuiditetin e tregut si dhe t'iu transmetojnë bankave sinjale në lidhje me politikën monetare që do të ndiqet nga Banka e Shqipërisë. Operacionet e tregut të hapur janë ekskluzivitet i Bankës së Shqipërisë. Ajo vendos llojin e instrumentit qe do përdorë si dhe kushtet përkatëse lidhur me ekzekutimin e tij.

Para se të përpiqemi të kuptojmë se si arrin banka qendrore të kontrollojë nivelin e likuiditetit dhe normën e interesit në tregun ndërbankar, le të shikojmë se ç'përfaqëson repoja dhe si realizohet ajo në praktikë.

- Lloji i instrumentit. Marrëveshjet e riblerjes janë operacione të tregut të hapur gjatë të cilave Banka e Shqipërisë u shet letra me vlerë bankave të nivelit të dytë dhe i riblen ato në datën e caktuar sipas kushteve të paracaktuara. Diferenca e çmimit të blerjes me çmimin e shitjes paraqet interesin që Banka e Shqipërisë iu paguan bankave të nivelit të dytë. Ndërsa marrëveshjet e anasjellta të riblerjes janë operacione të tregut të hapur gjatë të cilave Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë dhe i rishet në datën e caktuar sipas termave të kontratës. Në këtë rast, diferenca midis çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes paraqet interesin që bankat e nivelit të dytë i paguajnë Bankës së Shqipërisë për huanë që ato marrin prej saj.

Këtu duhen dalluar dy momente:

- Afati i maturimit të instrumentit, i cili në Shqipëri mund të jetë një javë, një muaj ose tre muaj.

- Norma e interesit të instrumentit. Norma e interesit të repove javore shërben si norma bazë e interesit në ekonomi. Marrëveshjet e riblerjes me afate më të gjata maturimi shërbejnë si instrumente rregulluese dhe strukturuese të likuiditetit në treg. Norma e interesit të tyre nuk sinjalizon drejtimin e politikës monetare.

- Natyra ligjore e instrumentit. Letrat me vlere që tregëtohen nëpërmjet zhvillimit të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes janë të blera paraprakisht nga Banka e Shqipërisë ose nga bankat e nivelit të dytë në tregun primar apo sekondar të bonove të thesarit.

[22] Repoja dhe marrëveshjet e riblerjes janë terma ekuivalentë. Repoja vjen nga shkurtimi i termave repurchase offer (agreement).

Grafik 1. Pesha e repos në tërësinë e operacioneve të Bankës së Shqipërisë.



Sipas qëllimit të përdorimit të tyre operacionet e tregut të hapur ndahen në: (i) operacionin kryesor të tregut, (ii) operacione rregulluese dhe (iii) operacione strukturore. Norma e interesit të operacioneve rregulluese dhe strukturore nuk shërben si sinjal i politikës monetare. Banka e Shqipërisë i zhvillon këto operacione në formë ankandi dhe pranon normën e interesit që del në to (natyrisht brenda kufijve te caktuar).

Marrëveshjet e riblerjes janë instrumenti kryesor dhe mund të përdoren për të tre qëllimet e lartpërmendura. Shitblerjet me të drejta të plota përdoren vetëm për qëllime rregulluese ose strukturore.

Box 3. Karakteristikat themelore të marrëveshjeve të riblerjes.

A. Operacioni kryesor i tregut.
Operacioni kryesor i tregut konsiderohet marrëveshja e riblerjes (e anasjelltë e riblerjes) me maturim njëjavor. Ai është dhe instrumenti kryesor i Bankës së Shqipërisë për zbatimin e politikës monetare. Karakteristikat themelore të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes mund të përmblidhen si më poshtë:

- *Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i interesave të tregut, administrimi i likuiditetit dhe sinjalizimi i qëndrimit të politikës monetare.*
- *Janë të tipit ankand me shumë të përcaktuar dhe me shumë çmime ose ankand me çmim fiks dhe shumë të papërcaktuar.*
- *Norma fikse e interesit të marrëveshjeve të riblerjes miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo normë shërben dhe si nivel maksimal ose minimal për ankandet me shumë çmime.*
- *Marrëveshja e riblerjes përdoret për tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar, ndërsa marrëveshja e anasjelltë e riblerjes përdoret për injektimin e likuiditetit në sistem.*
- *Ankandi për këto lloj marrëveshjesh organizohet çdo javë dhe është i tipit standard.*
- *Maturimi i këtij instrumenti është shtatë ditë.*
- *Të gjitha bankat e nivelit të dytë që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrëse në këto ankande.*

B. Operacionet strukturore.
Instrumentet që përdoren për operacione strukturore të tregut të hapur janë marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim një dhe tremujor si dhe shit/blerjet me të drejta të plota. Karakteristikat e marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim një dhe tremujor janë:

- Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i pozicioneve strukturore si dhe administrimi i likuditetit (shtimi ose pakësimi me baza të përkohshme).
- Ankandet për këto lloj marrëveshjesh janë të tipit të shpejtë dhe nuk janë të fiksuara paraprakisht.
- Norma e interesit për këto marrëveshje i referohet normës së tregut në kohën e shpalljes së ankandit.
- Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i refuzojë kërkesat të cilat lëvizin shumë nga normat aktuale të interesit në tregun e parasë.
- Të gjitha bankat e nivelit të dytë që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrëse në këto ankande.

C. Operacionet rregulluese.
Për ekzekutimin e operacioneve rregulluese të tregut të hapur përdoren marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes me maturim një ditë, një dhe tre
muaj si dhe shit/blerjet me të drejta të plota. Tiparet operacionale të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim njëditor janë:

- Qëllimi i përdorimit të tyre është rregullimi i luhatjeve të papritura në treg.
- Ankandet jane të tipit të shpejtë dhe frekuenca e tyre nuk është e standardizuar.
- Norma e interesit i referohet normës fikse të interesit të marrëveshjeve (të anasjellta) të riblerjes me maturim shtatëditor, i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.
- Të gjitha bankat e nivelit të dytë që kanë llogari pranë Bankës së Shqipërisë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrëse në këto ankande.

III.1.2 INSTRUMENTET LEHTËSUESE TË BANKËS SË SHQIPËRISË:

Instrumentat lehtësuese (standing facilities) janë:

1. Kredia dhe depozita njëditore.
2. Kredia lombard.

Këto instrumente përshkruajnë një huadhënie ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Nëpërmjet kredisë njëditore dhe kredisë lombard, Banka e Shqipërisë i jep hua bankave të nivelit të dytë (injekton likuiditet), ndërsa nëpërmjet depozitës njëditore Banka e Shqipërisë merr hua nga bankat e nivelit të dytë (tërheq likuiditet nga tregu).

Funksioni i këtyre instrumentave është mbështetja e instrumentit kryesor të repove. Këto instrumenta përcaktojnë kufijtë në të cilët mund të lëvizë norma e interesit në tregun ndërbankar. Norma e interesit të depozitave njëditore aktualisht është 3.0 pikë përqindjeje nën normën e interesit të repos, ndërsa norma e interesit të kredisë njëditore aktualisht është 2.5 pikë përqindjeje mbi normën e interesit të repos. Norma e interesit të kredisë lombard është 6.0 pikë përqindjeje mbi normën e interesit të repos. Ajo jepet vetëm në raste të vecanta, kur mungesa e likuiditetit në një bankë duket se ka natyrë permanente.

Si rregull, këto instrumente përdoren me iniciativën e bankave të nivelit të dytë. Në këtë mënyrë, këto instrumente caktojnë një korridor brenda të cilit mund të lëvizin normat e interesit. Asnjë bankë nuk do të pranonte të merrte hua në treg ndërbankar me një normë interesi më të lartë se norma e interesit të kredisë njëditore, duke patur parasysh se ajo mund të marrë kredi njëditore lirisht në Bankën e Shqipërisë. Po kështu, asnjë bankë nuk do të pranonte të investonte fonde me një normë interesi më të ulët se ajo e depozitës njëditore, duke patur parasysh se ajo mund t'i depozitojë këto fonde në formën e depozitës njëditore në Bankën e Shqipërisë.

III.1.3 REZERVA E DETYRUAR.

Funksioni kryesor i këtij instrumenti është kontrolli i rritjes së ofertës monetare dhe, nëpërmjet mundësisë që jep banka qendrore duke mesatarizuar nivelin ditor të rezervës së detyruar, ajo kryen edhe funksionin e stabilitetit të normave të interesit në tregun ndërbankar.

III.2 ROLI I MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES NË MEKANIZMIN E TRANSMISIONIT

III.2.1 ROLI I REPOS NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVIT OPERACIONAL.

Në përgjithësi, ashtu si e theksuam edhe më lart, objektivat operacionalë janë dy llojesh: objektiva sasiorë dhe objektiva cilësorë (të normave të interesit).

Objektivat operacionalë sasiorë të likuiditetit përdoren në kushtet e regjimit të targetimit monetar. Nëpërmjet mekanizmit të multiplikatorit të parasë, ato vendosin një lidhje midis objektivit të ndërmjetëm (nivelit të ofertës monetare) dhe objektivit operacional (nivelit të likuiditetit në sistem dhe nivelit të bazës monetare). Në këtë këndvështrim, repoja përdoret për të arritur nivelin e dëshiruar të likuiditetit, duke tërhequr ose, duke injektuar likuiditet.

Objektivat operacionalë në formën e normave të interesit përgjithësisht janë norma të interesit të tregut ndërbankar (norma e interesit me te cilën bankat e nivelit të dytë marrin dhe japin hua me njëra-tjetrën). Pra ato nuk janë direkt norma e interesit të marrveshjeve të riblerjes. Në këtë këndvështrim, norma e interesit të repove është vetëm një normë orientuese për normat e interesit të tregut.

Fillimisht, Banka e Shqipërisë i ka përdorur repot (të cilat janë prezantuar në korrik 2000) ekskluzivisht për të administruar likuiditetin në treg. Zhvillimi i tregut ndërbankar ka bërë që Banka e Shqipërisë t'i kushtojë një rëndësi më të madhe rolit të repove në administrimin e normave të interesit të tregut. Po si arrin një banke qendrore të bëjë të mundur që norma e interesit të tregut ndërbankar të jetë afër (ndryshimet janë praktikisht të papërfillshme) normës së interesit të repove?

Si fillim, duhet të ndalemi pak te gjendja agregate e likuiditetit në sistemin bankar. Ky koncept është shuma aritmetike e gjendjeve individuale të likuiditetit të bankave. Pra, një ose shumë banka mund të jenë me mungesë / tepricë likuiditeti, ndërsa bankat e tjera me tepricë / mungesë likuiditeti, por sistemi bankar si i tërë do të jetë me mungesë ose me tepricë likuiditeti.

A. Supozojmë se sistemi është me mungesë likuiditeti. Në këto raste, banka qendrore, duke parashikuar saktë nevojat e likuiditetit të sistemit dhe duke injektuar në sistem nivelin e dëshiruar të likuiditetit, bën të mundur që normat e interesit të transaksioneve ndërbankare të qëndrojnë afër normës së interesit të marrvëshjeve të riblerjes. Një bankë do të pranonte të merrte hua vetëm në norma interesi që janë afër asaj (zakonisht më ulët) të repos; në të kundërt ajo do t'i drejtohej Bankës së Shqipërisë. Në këtë këndvështrim, norma e interesit të repos është norma marxhinale e marrjes hua. Nëqoftëse banka qendrore nuk parashikon saktë nivelin e likuiditetit të kërkuar nga sistemi bankar, mund të kemi shmangie të normave të interesit të tregut nga ajo e repos.

B. Supozojmë se sistemi bankar është me tepricë likuiditeti. Në këtë rast, banka qendrore shndërrohet në tërheqëse të likuiditetit. Supozojmë përsëri se banka qendrore do të bënte një parashikim të saktë të likuiditetit dhe do të tërhiqte saktësisht sasinë e ofruar nga bankat. Edhe në këtë rast, niveli i normave të interesit në tregun ndërbankar do t'i afrohej atij të repos. Një bankë nuk do të pranonte të jeptë hua në tregun ndërbankar me një normë interesi më të ulët se ajo me të cilën tërheq fondet Banka e Shqipërisë. Në këtë rast, norma interesit të repos është kostoja e oportune e mbajtjes së fondeve të tepërta për sistemin bankar. Nëqoftëse parashikimi i likuiditetit nuk ka qenë i saktë mund të kemi përsëri shmangie të normave të interesit të tregut ndërbankar nga norma e interesit të repove.

Në të dyja rastet, normat e interesit të tregut ndërbankar do të jenë afër normës së interesit të repos. Gjithsesi, edhe në rast të parashikimi të gabuar të likuiditetit nga banka qendrore, instrumentet dhe operacionet lehtësuese të përmendura më lart kufizojnë lëvizjet e normave të interesit në tregun ndërbankar.

III.2.2 SI PËRCILLET NDRYSHIMI I NORMËS SË INTERESIT TË REPOVE NË EKONOMI?

Duke iu kthyer skemës së mekanizmit të transmetimit të politikës monetare të paraqitur më parë, duhet theksuar se normat e interesit të cilat kanë ndikimin më të madh në transmetimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi, janë normat e interesit të instrumenteve afatgjata.

Por, normat e interesit të repove janë vetëm norma interesi afatshkurtra. Si ndikojnë ato në normat afatgjata të interesit? Këtu duhet futur në punë koncepti i kurbës kohore të normës së interesit (*yield-curve*). Dihet se instrumentet afatgjata kanë norma interesi më të larta, kryesisht si pasojë e rrezikut më të madh që ato paraqesin (linja 1 e grafikut).

Banka e Shqipërisë, duke ndryshuar normën e interesit të repove, dëshiron një zhvendosje paralele të kurbës së normave të interesit. Me fjalë të tjera, duke ulur/rritur normën e interesit të repove me 0.5 pikë përqindjeje, Banka e Shqipërisë dëshiron që norma e interesit të depozitave në lekë, norma e interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit, si dhe të gjitha normat e interesit në ekonomi, të ulen/rriten me 0.5 pikë përqindjeje. Grafikisht kjo do të ilustrohej me zhvendosjen e linjës 1 në linjën 2 të grafikut. Kalimi i kurbës së normës së interesit në pozicionin 3 është reagimi më i padëshiruar i sistemit financiar ndaj një shtrëngimi të politikës monetare.

Praktika tregon se tregjet financiare janë mjaft komplekse. Faktori kryesor që përcakton formën e kurbës së normave të interesit janë pritjet inflacioniste. Në qoftë se publiku nuk e percepton si të drejtë politikën monetare të ndjekur, reagimi i tij mund ta bëjë të pavlefshme politikën monetare. Prandaj, bankat qendrore janë mjaft të kujdesshme në përputhjen e instrumenteve të tyre të politikës monetare me realitetin ekonomik dhe pritjet e agjentëve të tregut.

Figura 2. Kurba e normave të interesit.



“DOBISHMËRIA E INDEKSEVE TË BESIMIT PËR BANKËN QENDRORE”[1].*

1. HYRJE

Ndërtimi i indekseve të besimit[2] paraprihet nga vrojtime të rregullta apo periodike pranë aktorëve të ndryshëm, të cilët vlerësohet se luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e një vendi.

Puna për ndërtimin e treguesve të besimit apo siç njihen rëndom sot në botë, indekseve të besimit, ka filluar që prej disa kohësh në Bankën e Shqipërisë (tetor 2001). Fillimisht, është vrojtuar grupi i bizneseve të sektorëve të prodhimit dhe të ndërtimit (tetor 2001). Ky vrojtim mund të quhet prova e parë, për ndërtimin e sistemit të treguesve të besimit, nga ana e Bankës së Shqipërisë. Ai ka vijuar të kryhet, në mënyrë të rregullt, me frekuencë tremujore, që prej muajit korrik 2002 duke përfshirë në të edhe sektorin e shërbimeve.

Në qershor të vitit 2003 u krye vrojtimi i parë pilot pranë konsumatorëve. Ashtu si edhe vrojtimi pranë biznesve, ai vijoi të kryhet gjatë vitit 2003 dhe 2004 po me frekuencë tremujore, madje në të njëjtën kohë si edhe vrojtimet pranë bizneseve.

Ndërtimi i indekseve të besimit përbën një tjetër përpjekje serioze të Bankës së Shqipërisë, që konsiston në kryerjen e analizave të fakteve dhe të fenomeneve ekonomike, në mënyrë sa më realiste dhe bashkëkohore. Në këtë kuptim, projekti paraqitet, njëkohësisht, ‘ambicioz’ dhe ‘i matur’.

Ambicioz, sepse ai synon ndërtimin e sistemit te indekseve te besimit, sipas standardeve evropiane. Për këtë qëllim, me mbështetjen e gtz-së, grupi i punës që është angazhuar në këtë projekt është ndihmuar nga ekspertët gjermanë të Institutit të Studimeve dhe Kërkimeve Ekonomike, IFO, me reputacion botëror në këtë fushë.

I matur, sepse në mënyrë graduale është synuar arritja e treguesve të besimit sa më realë dhe pa u nxituar. Të arrihen tregues të matur, do të thotë që jo vetëm vendimmarrja në bankë, por edhe publiku të kenë nivel të kënaqshëm besimi tek ata. Kjo do të ndikojë edhe rritjen e besueshmërisë së publikut tek mesazhet e dhëna nga Banka e Shqipërisë.

2. RËNDËSIA E TREGUESVE TË BESIMIT.

Rëndësia e ndërtimit të treguesve të besimit është mjaft e lidhur me faktin se përse këta tregues janë të nevojshëm. Qëllimi i ndërtimit të tyre, konsiston, kryesisht, në njohjen e tendencave në sektorin real të ekonomisë, në mbledhjen e informacionit sa më të plotë për analizat që ndihmojnë vendimmarrjen në Bankën e Shqipërisë si edhe në vlerësimin e rezultateve që gjenerohen nga një proces i tërë vrojtues. (vrojtimet me frekuencë tremujore “Mbi besimin e bizneseve dhe të konsumatorëve”).

Nevoja e hartimit të një sistemi treguesish të besimit lidhet me:

- zhvillimin e sistemeve të parashikimit për të ardhmen afatshkurtër në sektorin real të ekonomisë;

- plotësimin e disa mangësive të sistemit të sotëm të informacionit, sidomos për atë të statistikave të sektorit real të ekonomisë (aktivitet ekonomik, punësim, çmime, investime, konkurrencë, situatë financiare, kursime, perceptime të publikut për inflacionin etj..);

[1] Leksion në Universitetin e Gjirokastrës, nga: Prof. Dr. Shkëlqim Cani, Dr. Evelina Çeliku, Maj 2004
[2] Indeksi i besimit të biznesit (IBB) & Indeksi i besimit të konsumatorit (IBK).
* Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Shkëlqim Cani, me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, me datë 14 maj 2004. Materialin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

- mbështetjen që i krijohet vlerësimeve për presionet inflacioniste me origjinë nga prodhimi (çmimet e prodhimit, aktiviteti prodhues ne rënie apo në rritje);

- krijimin e një serie të dhënash për një periudhë të mjaftushme kohore që të mundësojnë bërjen e analizave statistikore e më pas të atyre ekonometrike;

- krahasimin e të dhënave të vrojtimit me ato që vijnë nga statistikat zyrtare dhe analiza e variancës së rezultuar, e shkallës së besueshmërisë së vrojtimit dhe e vetë statistikave zyrtare. Këtu mund të studiohen hapësirat e mundshme për përmirësime të mëtejshme të sistemit statistikor, kryesisht të treguesve që flasin për zhvillimet afatshkurtra (tremujore) deri afatmesme (gjashtëmujore);

- shtimin e rubrikave të veçanta të pyetjeve në pyetësorë, për probleme më specifike për të cilat Banka e Shqipërisë është e interesuar të marrë informacion nga biznesi dhe nga konsumatorët.

Përvoja botërore e ndërtimit të serive të indekseve të besimit ka treguar se ekziston një korrelacion i fortë linear midis parashikimeve të vrojtimit të besimit dhe treguesve të faktuar të sektorit real të ekonomisë.

3. KONSIDERATA TEORIKE DHE PRAKTIKE MBI INDEKSET E BESIMIT.

- Indekset e besimit, janë tregues të cilëve u referohen, në përgjithësi, të gjitha analizat e ekonomisë reale, sot në botë. Thesojmë se, gjithmonë, ata luajnë një rol plotësues të informacionit statistikor. Ata janë orientues dhe jo përcaktues në vendimmarrje.

- Arsyeja e ndërtimit dhe e kryerjes së analizave mbi informacionin që ata japin lidhet me faktin që shpejtësia e lëvizjes së informacionit në rrugët e sistemit statistikor, sado e madhe që të jetë, arrin te përdoruesit e tij dhe te hartuesit e analizave dhe strategjive, i sfazuar në kohë. Ky është një fenomen që pak a shumë ndeshet në të gjitha vendet, qoftë edhe në ato më të zhvilluara ekonomikisht. Në kushtet e vendit tonë, intensiteti i ndeshjes së tij është mëse i dukshëm. Informacioni dhe të dhënat për ekonominë reale arrijnë me vonesë kohore të rendit 3 deri 6 muaj.

- Në këto kushte, është e përshtatshme të matet ndjesia që bizneset dhe konsumatorët kanë për situatën e kaluar dhe të merren në konsideratë parashikimet e tyre për periudhat afatshkurtra.

- Treguesit që masin këtë ndjesi janë të thjeshtë në llogaritje, por me një rëndësi të veçantë për informacionin që sjellin. Dy janë aspektet më të vlerësuara të treguesve të besimit:

a) sasior;
b) cilësor.

Aspekti i parë (sasior), ka të bëjë me një vlerë në përqindje, që rezulton nga një diferencë e thjeshtë e vlerës që ka marrë alternativa pozitive me atë të alternativës negative për një pyetje të veçantë. Përgjigjet janë relative apo të krahasuara me një përiudhë më parë (në rastin tonë – krahasuar me tremujorin paraardhës ose edhe me gjashtëmujorin paraardhës për ecurinë e investimeve).

Për të qenë më të qartë metodologjikisht, do të japim një shembull të ndërtimit të njërit prej treguesve.

Shembull hipotetik:

Nga të gjitha përgjigjet e grumbulluara lidhur me "aktivitetin e biznesit", kanë rezultuar këto përgjigje:

60 për qind raportojnë që aktiviteti është rritur, krahasuar me tremujorin paraardhës;

25 për qind që nuk ka ndryshuar, krahasuar me tremujorin paraardhës;

45 për qind që ka rënë, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Llogaritja:

Vlerësimi i treguesit do të jepet nëpërmjet asaj që quhet "balanca e tendencës së biznesit", njëri

nga më të rëndësishmit në sistemin e treguesve të besimit, e cila rezulton si diferencë midis përgjigjeve pozitive dhe atyre negative. Në rastin konkret do të ishte: 60-45 = 15 pikë përqindjeje[3].

Interpretimi:

Nëse në tremujorin pasardhës, kur do të kryhet përsëri vrojtimi, numri i përgjigjeve pozitive do të ishte më i madh se 15 pikë përqindjeje, vlerësimi do të ishte që aktiviteti sipas "Besimit të biznesit" është rritur me "x" pikë përqindjeje kundrejt periudhës paraardhëse[4].

E njëjta metodologji do të zbatohej edhe për të vlerësuar shkallën e aktivitetit investues, pritshmëritë për çmimet e prodhimit, vëllimin e shitjeve (sipas ndryshimit të gjendjes së inventarit), problemet e punësimit etj.. Kjo pikë është tashmë e zgjidhur që në vrojtimin e parë të IBB-së dhe të IBK-së.

Elementi i dytë i aspektit sasior është përcaktimi i treguesve të agreguar për sektorët dhe për ekonominë në tërësi, hap tashmë i realizuar si për IBB ashtu edhe për IBK.

Elementi i tretë është, përcaktimi i përiudhës bazë që lejon kalimin nga tregues besimi në indeks besimi. Për të realizuar këtë element duhet të disponohen seri të dhënash minimalisht 3 vjeçare, në mënyrë që të studiohet me kujdes cikli ekonomik. Megjithatë, përsa kohë që seria jonë, është ende e re, mund të procedohet me ndërtim indeksesh, në trajtë zinxhir dhe vit mbi vit.

Aspekti i dytë (cilësor), ka të bëjë me analizën e kësaj shifre që në vetvete është një diferencë. Çfarë shenje merr ajo? Çfarë tendence paraqet? Për të kaluar tek pjesa më e rëndësishme se çfarë tendencash paralajmëron. Këto momente studiohen për tregues të tillë si: " klima e përgjithshme e biznesit", si edhe për "sektorët e veprimtarisë së biznesit" (aktiviteti, inventari, situata e çmimeve, e punësimit, tendenca e kursimeve, e konsumit). Përfundimet që nxirren evidentojnë një ndjesi të biznesit dhe të konsumatorëve në tërësi për treguesit e sipërpërmendur, pra, i përkasin tërë zgjedhjes.

4. BESIMI I BIZNESIT

4.1. DISA KRITERE DHE HAPA METODOLOGJIKË.

Si hap i parë është përcaktimi i kufijve të zgjedhjes, pra se cilët biznese do të përfshihen në zgjedhje.

Përmbushja e kësaj kërkese në vrojtim është e lidhur me plotësimin e disa elementeve të cilët në rastin konkret janë realizuar si më poshtë:

- vrojtimi është kryer pranë bizneseve të regjistruara të sektorëve të prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimeve;

- vrojtimi është organizuar në trajtën e panelit, pra që ruan parimin e krahasueshmërisë mbi bazën e së njëjtës zgjedhje në kohë, me një marzh rishikimi nga viti në vit me rreth 8-10 për qind;

- bizneset i përkasin vetëm sektorit privat të ekonomisë për degët e mësipërme;

- janë përfshirë biznese të mëdhenj dhe të mesëm. Kjo kërkohet për të siguruar qëndrueshmëri të panelit në kohë. Po kështu, sigurohet parimi i përfaqsueshmërisë së zgjedhjes, i cili është mjaft i rëndësishëm, në momentin e analizës dhe të nxjerrjes së konkluzioneve mbi tendencat e aktiviteteve ekonomike të sektorëve dhe të ekonomisë;

- firmat e vogla, janë vrojtuar vetëm një herë dhe i përkasin sektorit të shërbimeve (dhjetor 2002). Ato do të vijojnë të vrojtohen vetëm një herë në vit, për të plotësuar informacionin e sjellë nga aktiviteti i madh dhe i mesëm i bizneseve. Fakti që bizneset e vegjël janë më pak të qendrueshëm në aktivitetin e

[3]Në parim veprohet kështu, si për IBB ashtu edhe për IBK, por IBK e ka pak më të ndërlikuar këtë llogaritje për shkak të modaliteteve më të shumta në përgjigje (shihni: Besimi konsumator).
[4]Krahasimi sot bëhet jo vetëm kundrejt periudhës paraardhëse, por në të shumtën e rasteve kundrejt një periudhe bazë, duke krijuar kështu një indeks. Ai mund të bëhet edhe kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë (vit mbi vit).

tyre, e bën të vështirë procesin e vrojtimit dhe të krahasimit të rezultateve;

- madhësia e zgjedhjes kushtëzohet nga fakti që bizneset e vrojtuara të çdo sektori, kontribuojnë jo më pak se 70 për qind në prodhimin (shifrën e afarizmit) e sektorit përkatës;

- vrojtimi ka një shpërndarje gjeografike në të gjithë vendin, duke u përqendruar në zonat me aktivitet më të lartë ekonomik.

Këto janë kriteret bazë, si rrjedhojë e zbatimit të të cilave në vrojtimet tona ka rezultuar një zgjedhje prej rreth 600 biznesesh për të tre sektorët së bashku. Megjithatë, për të arritur deri këtu, janë reflektuar ndryshime të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin në vijimësi të cilësisë së treguesve të besimit.

4.2. HAPAT E REALIZIMIT TË VROJTIMIT.

a) Si rezultat i zbatimit të kritereve metodologjike për zgjedhjen të përcaktuara nga grupi i punës i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me ekspertët e INSTAT është përcaktuar zgjedhja (*sample*);

b) Vrojtimi në terren është realizuar plotësisht nga INSTAT (paraprakisht është kryer edhe një vrojtim testues kryesisht për të parë nivelin e kuptueshmërisë së pyetjeve nga ana e bizneseve);

c) Trajnimi i intervistuesve është realizuar në një bashkëpunim të vazhdueshëm (INSTAT dhe Banka e Shqipërisë);

d) Kontrolli i pyetësorëve është realizuar nga grupi i punës në Bankën e Shqipërisë;

e) Hedhja e të dhënave është realizuar nga sektori i informacionit pranë DTIS në Bankën e Shqipërisë;

f) Përpunimi dhe analiza e rezultateve janë realizuar nga grupi i punës së Bankës së Shqipërisë, përbërja e të cilit vjen nga stafi i DK dhe DPM.

Sot në ndjekjen e këtij projekti është angazhuar edhe Zyra e Vrojtimeve, pranë DTIS në Bankën e Shqipërisë.

4.3. FORMULIMI I PYETËSORËVE TË BESIMIT TË BIZNESIT[5].

Për të realizuar qëllimin e vrojtimit, nisur nga treguesit që do të llogariteshin më pas në analizën e të dhënave, u gjykua që pyetësori të ishte i ndarë në tre rubrika të përherëshme dhe kur paraqitet e nevojshme në të përfshihet edhe një rubrikë e veçantë.

Rubrika e parë (*të dhëna të përgjithshme*). Siguron një informacion të përgjithshëm mbi aktivitetin e firmës dhe fushën e aktivitetit të saj në tre nënndarjet e mëdha, prodhim, ndërtim dhe shërbime, sipas nomenklaturës që zbatohet në Republikën e Shqipërisë për klasifikimin e ndërmarrjeve (NACE).

Rubrika e dytë (vlerësim mbi klimën e përgjithshme të biznesit). Ka për qëllim të vlerësojë situatën aktuale të biznesit në vend, rendit faktorët që kanë ndikuar në krijimin e saj dhe parashikon situatën për tre muajt në vijim, sipas opinionit të bizneseve.

Rubrika e tretë (vlerësime për veprimtarinë e bizneseve). Kjo rubrikë është e ndarë në disa pjesë. Në çdo nëndarje bizneset private kanë dhënë gjykimin e tyre për gjendjen aktuale dhe parashikimin për tremujorin në vijim. Nënndarjet janë: mbi *aktivitetin* e firmës, mbi *investimet* e firmës, mbi *inventarin* e firmës, mbi *çmimet e prodhimeve* të saj, mbi *punësimin* në firmë, mbi *konkurrencën* dhe mbi *situatën financiare* të saj.

[5] Pyetësorët e përdorur në vrojtimet e besimit të biznesit gjenden në aneksin A1 të këtij materiali. Për pyetësorin e IBB, si model ka shërbyer pyetësori bazë që përdoret sot nga IFO, që mban në konsideratë standartet e vendosura në BE. Kuptohet, që janë bërë disa ndryshime apo përshtatje që lidhen me kushtet ekonomike dhe sociale të Shqipërisë. Për secilin nga sektorët përdoren pyetësorë të veçantë, ku pyetjet bazë janë të njëjta.

Pra elementi më i rëndësishëm i këtij vrojtimi është pritshmëria mbi treguesit e përgjithshëm mikroekonomikë të bizneseve, të cilat duke u agreguar japin tendencat në nivel makroekonomik.

Rubrika e veçantë[6], mund të përdoret për qëllime të veçanta studimi. Sipas nevojave mund të hartohet një rubrikë me pyetje që kerkojnë të vjelin informacione më specifike. Në një rubrikë të tillë janë trajtuar çështje të tilla si: tregu joformal i kredisë (IBB); mënyra e dërgesave dhe vlerësimi i sasisë së dërgesave nga emigrantët (IBK); si dhe sa i kupton publiku sinjalet e Bankës së Shqipërisë? (IBB); bizneset, konsumatorët dhe përdorimi i *cash*- it në ekonomi (IBB & IBK).

5. ECURIA E TREGUESVE TË BESIMIT TË BIZNESIT (2002 – 2004)

Për të gjithë sektorët e vrojtuar, vihet re një shkallë e lartë bashkëpunimi ndërmjet bizneseve dhe intervistuesve. Kjo shprehet së pari në, nivelin e lartë të të përgjigjurve, mbi 95 për qind si edhe në harmoninë që vërehet tek rezultatet. Kjo flet për një kuptim deri-diku të kënaqshëm të pyetjeve mbi treguesit ekonomikë, nga ana e bizneseve.

Megjithatë, vërehet një karakteristikë e cila përçon pothuaj të gjithë vrojtimet: bizneset janë më optimistë për të ardhmen afatshkurtër dhe kjo del në pritjet më të larta se sa vlerat aktuale në tremujorin përkatës.

Pra, ka një lloj vlerësimi të situatës ekonomike për periudhat e ardhme me ngjyra më pozitive, se sa ata pohojnë më pas apo se sa atyre u faktohet.

Kjo veçori dhe probleme te tjera për të cilat reflektohet gjatë punës dhe analizave të rezultateve, bëjnë që këta tregues të vijojnë të jenë në proces testimi.

Ndonëse Banka e Shqipërisë nuk i ka bërë publike shifrat, ajo e përdor informacionin e marrë prej treguesve te besimit për nevojat e saj analizuese. Ne gjykojmë se ende nuk ka ardhur koha që përdorimi i tyre të shtrihet edhe më gjerë, për të interesuar të tjerë. Procesi i punës vazhdon të kryhet me seriozitet, me synim arritjen, në një të ardhme sa më të afërt, të publikimit të tyre.

5.1. SEKTORI I PRODHIMIT INDUSTRIAL.

Bizneset e sektorit të prodhimit kanë një shpërndarje që justifikon deri-diku peshat e nën-aktiviteteve ekonomike, që realisht janë të larmishme, brenda tij.

Grafik 1: Shpërndarja sipas nën-aktiviteteve prodhuese (në%).



[6] Kjo është një rubrikë që në raste të ndryshme është përfshirë edhe tek pyetësori i besimit konsumator.

Dihet që industria ushqimore, ajo e prodhimit të materialeve të ndërtimit si edhe ajo e fabrikimit të tekstileve, zënë një peshë të konsiderueshme në sektorin e prodhimit industrial në vend, fakt që konfirmohet edhe nga shpërndarja e firmave në zgjedhjen e këtij vrojtimi.

Disa komente të shkurtra të informacionit që sjellin treguesit e besimit të biznesit për sektorin e prodhimit na cojnë në përfundimin se, situata ekonomike e biznesit prodhues industrial, gjatë gjithë vitit 2003 ka ndjekur një tendencë deri-diku rënëse.

Rritja e ekonomisë shqiptare në tërësi përgjatë vitit 2003, duket se ka ardhur më tepër nga sektorë të tjerë të ekonomisë si: shërbimet, ndërtimi dhe transporti.

Pengesat kryesore në zhvillimin e industrisë, sipas opinionit të bizneseve të këtij sektori, marrë nga përpunimi i përgjigjeve të tyre, lidhen në disa momente kohore me probleme të rendit dhe të sigurisë si edhe me aspekte të tjera si:

marrëdhëniet me administratën fiskale; zbatueshmërinë e diferencuar të ligjit në gjirin e bizneseve; etj..

Nga analizat e treguesve duket se rënia e prodhimit është shkaktuar në pjesën më të madhe nga rënia e kërkesës. Nga ana e tij, një aktivitet prodhues në rënie, ka shkaktuar njëfarë pamundësie për të gjeneruar vende të reja pune, një gjendje jo të mirë financiare, një rënie të ndjeshme të investimeve si edhe një rënie të nivelit të eksportit të këtij sektori.

Rënia e kërkesës, sidomos në fillim të tremujorit të katërt të vitit, nuk ka ushtruar presione mbi çmimet e prodhimeve industriale, për pasojë edhe mbi një pjesë të çmimeve të konsumit.

5.2. SEKTORI I NDËRTIMIT.

Bizneset ndërtuese paraqesin ecuri më pozitive në tremujorët e dytë dhe të tretë të viteve dhe kjo verifikohet edhe përgjatë periudhës 2002-2004.

Faktorët kryesorë që kanë kushtëzuar zhvillimet në këtë sektor gjatë vitit 2003, sipas përgjigjeve të bizneseve ndërtuese, janë:

- zbatueshmëria e kuadrit ligjor;
- klima e brendshme politike;
- gjendja e rendit dhe e sigurisë.

Grafik 2: Ecuria e treguesve të agreguar të besimit të biznesit në sektorin prodhues (2002-2004).



Grafik 3: Ecuria e treguesve të agreguar të besimit të biznesit në sektorin e ndërtimit (2002-2004).



Çmimet e larta të objekteve të ndërtimit mendohet të kenë ndikuar deri – diku në tkurrjen e kerkesës në sektorin e ndërtimit. Një kërkesë në rënie është shoqëruar me rënie të prodhimit, e cila ka reduktuar edhe numrin e të punësuarëve në firmat e ndërtimit. Megjithatë, vërehet një rënie e vazhdueshme në inventareve apo një rritje e shitjeve në këtë sektor. Konkurrenca brenda sektorit të ndërtimit vlerësohet të njohë rritje nga tremujori në tjetrin, por që në fakt nuk ka ndikuar ende në rënien e çmimeve.

5.3. SEKTORI I SHËRBIMEVE.

Ecuria vjetore e sektorit të shërbimeve, sipas treguesve të besimit të bizneseve të këtij sektori, dëshmon për një luhatshmëri deri-diku të verifikuar që ky sektor demonstron gjatë vitit. Tremujorët më "të mirë" në drejtim të aktivitetit ekonomik në rritje (klima e përgjithshme & balanca e biznesit) paraqiten i dyti dhe i treti dhe ndër këta të fundit, është tremujori i tretë ai me ecuri më të mirë. Kjo shpjegohet me faktin se aktivitetet e shërbimit hotele, restorante dhe turizmi në tërësi, në këtë tremujor, janë shumë më aktive se në tremujorët e tjerë të vitit.

Tremujori i katërt paraqitet me një balancë biznesi më të ulët ashtu siç edhe pritej nga vetë bizneset në vrojtimin e shtatorit '03 (T3-'03).

Gjatë vitit 2003, faktorët që kanë ndikuar më së shumti janë ata që lidhen :

a) me kuadrin ligjor dhe institucional, që në pjesën më të madhe shprehen në politikën e tatimeve dhe të taksave, ndoshta të intensifikuar në tremujorin e katërt të vitit (ky faktor ka dalë si më i rëndësishmi edhe në vrojtimin e një viti më parë).
b) me rendin dhe me sigurinë (kryesisht në tremujorin e dytë të vitit 2003)

Grafik 4: Ecuria e treguesve të agreguar të besimit të biznesit në sektorin e shërbimeve (2004).



Aktiviteti në rënie në të gjitha rastet mbështetet nga një kërkesë në rënie për shërbime. Një kërkesë në rënie dhe një konkurrencë në rritje, shprehet në tendencën rënëse të çmimeve në këtë sektor, gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit 2003.

Situata e punësimit, përveç tremujorit të tretë, në të gjithë pjesën tjetër të vitit paraqitet e përkeqësuar, fakt që përkon me aktivitetin në rënie të sektorit të shërbimeve në këto periudha të vitit.

5.4. TREGUESIT E BESIMIT TË BIZNESIT PËR EKONOMINË[7] DHE ZHVILLIMET NGA STATISTIKAT ZYRTARE.

Vërehet krijimi i një cikli, që ndjen një rritje në tremujorin e tretë të vitit. Kjo është një tendencë e verifikuar që dëshmon për një ndjesi të drejtë të bizneseve shqiptare. Tendenca e çmimeve, në përgjithësi gjatë vitit 2002-2003 është verifikuar dhe ky është një informacion shumë i rëndësishëm për vendimmarrjen në bankën qendrore.

Punësimi, gjithashtu ka ndjekur tendencat që janë verifikuar edhe nga statistikat zyrtare. Faktorët ndikues në aktivitetin ekonomik, deri-diku, janë të justifikuar me situata të veçanta të zhvillimeve ekonomike dhe politike në vend.

Duket se ngjyrat në treguesin e agreguar për ekonominë i jep balanca e biznesit. Ky tregues, konsiderohet si më i ploti dhe më i besueshmi , sepse ai mbart edhe diferencat më të vogla ndërmjet situatës aktuale dhe pritjeve për një periudhë kohore të caktuar.

Grafik 5 (a-b): Ekonomia (2002-2004)
5-a) Balanca e agreguar biznesit.



5-b) Treguesi i agreguar besimit të biznesit.



[7] Me ekonomi janë nënkuptuar tre sektorët (prodhim industrial, ndërtim dhe shërbime), të ponderuar me peshat e korrektuara në PBB.

6. BESIMI I KONSUMATORIT.

Indeksi i besimit të konsumatorit interpretohet si parashikim për ecurinë e ekonomisë së një vendi për një periudhë të afërt, sepse ai tenton të diktojë ndryshime në ciklin e ekonomisë, pra një ulje e besimit të konsumatorit tek ekonomia interpretohet si ulje e konsumit në të ardhmen, dhe anasjelltas. Për disa ekonomi ku konsumi konsumator zë një peshë të konsiderueshme të PBB-së, ky tregues është mjaft i rëndësishëm, pasi është ndër të paktët që mat ndjesinë e shpenzimeve konsumatore.

vendeve, u mendua që për kryerjen e vrojtimit të konsumatorit në Shqipëri të përdorej i njëjti pyetsor si ai që citohet në manualin e BE-së.

Qëllimi i tij është të masë shkallën e besueshmërisë së konsumatorit në gjendjen aktuale dhe të pritshme të ekonomisë. Pra, të kuptojë se si i përshtat konsumatori vendimet e veta për konsum dhe kursim duke u nisur nga pritjet për të ardhmen.

Për këtë arsye ai është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë i referohet gjendjes aktuale

Box 1: Disa fjalë më shumë për besimin e konsumatorit.

Pak histori.
Fillimet e IBK datojnë që në vitin 1967 në Amerikë kur Univeristeti i Miciganit mori inisiativën e ndërtimit të indeksit. Ndërtimi i indeksit bazohet në rezultatet e Vrojtimit të Konsumatorit, i cili konsiston në një grup pyetjesh mbi situatën e pritshme financiare dhe ekonomike të konsumatorit. Në fillim të viteve 1970, Komisioni Europian vendosi që të perfshije në Programin për Harmonizimin e Vrojtimeve edhe Vrojtimin për Konsumatorin. Harmonizimi i Vrojtimeve nënkupton njesueshmërinë e pyetsorit që përdoret në vrojtimet që kryehen nga vendet e BE-së. Edhe vendet që do të hyjnë së shpejti në BE përdorin të njëjtën metodologji të miratuar nga Komisioni Europian.

Përparësi dhe probleme të treguesit të besimit konsumator.

- *Besimi i konsumatorit është një tregues 'udhëheqës' për ciklin e biznesit.*
- *Ky tregues siguron informacion mbi vlerësimet e konsumatorëve për situatën aktuale dhe pritjet për të ardhmen. Përmirësimet në pritjet për të ardhmen tregojnë që konsumatorët do të jenë më të gatshëm për të shpenzuar tani ose në muajt e ardhshëm.*
- *Përgjigjet e vrojtimit janë të segmentuara sipas të ardhurave familjare, sipas moshës dhe profesionit të anëtarit të familjes që gjeneron më shumë të ardhuara në të.*

Megjithë informacionin që sjell, besimi konsumator duhet konsideruar me kujdes.

- *Shpesh konsumatorët nuk kanë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar me saktësi rritjen e punëzënies dhe të të ardhuarve gjashtë muaj më vonë;*
- *Analiza e besimit të konsumatorit siguron informacion mbi shpenzimet e planifikuara, të cilat jo domosdoshmërisht do të kthehen në shpenzime reale. Megjithatë, është shumë e vështirë që një një rritje e besimit të konsumatorit të shoqërohet nga një rënie në shpenzime.*

ekonomike krahasuar me një tremujor më parë, dhe pjesa e dytë i referohet pritshmërive për tremujorin e ardhshëm. Gjithsej pyetsori përmbledh 15 pyetje, tre prej të cilave – ato që lidhen me investime afatgjata – pyeten vetëm një herë në vit.

Pyetjet synojnë të marrin përgjigje për tregues të ndryshëm ekonomik si për shembull për papunësinë, inflacionin dhe të ardhurat reale. Më konkretisht:

6.1. VROJTIMI I KONSUMATORIT NË SHQIPËRI.

PYETËSORI[8].

Duke patur si parim ruajtjen e krahasueshmërisë së rezultateve me vendet e tjera dhe duke u nisur edhe nga praktika e këtyre

[8] Pyetësori i IBK gjendet në aneksin A1 të materialit.

Subjekti i pyetjes	Treguesi makroekonomik
Situata financiare e konsumatorit	Të ardhurat e disponueshme
Situata e përgjithshme ekonomike	PBB
Kostoja e jetesës	Indeksi i çmimeve të konsumit
Papunësia	Papunësia
Mundesi për blerjet në shuma të mëdha	Konsumi privat
Mundësitë për kursim	Kursimet
Mundësi për blerjen e shtëpisë	Investimet familjare

VEÇORI TË LLOGARITJES SË TREGUESVE TË BESIMIT KONSUMATOR.

Secila pyetje merr 5 alternativa të mundshme si përgjigje – njëra prej të cilave tregon neutralitet. Për çdo pyetje, rezultati është llogaritur si diferencë e përqindjeve të përgjigjeve pozitive nga ato negative të shprehura në përqindje. Meqenëse ka më shumë se një alternativë që mbart tendencë positive (negative), alternativave iu është caktuar peshë e ndryshme. Pra, është menduar që të përdoret kjo mënyrë llogaritjeje e rezultantes per cdo pyetje:

R = (PP +1/2P) – (1/2N+NN)

ku:

PP - përqindja e alternativës "përmirësuar shumë";
P - përqindja e alternativës "përmirësuar ";
N - përqindja e alternativës "keqësuar";
NN - përqindja e alternativës "keqësuar shumë".

Alternativave iu jepet peshë e ndryshme për të dalluar ngjyrimet e përgjigjeve.

Në bazë të rezultateve të përgjigjeve llogariten tre tregues të besimit konsumator. Treguesit llogariten si mesatare aritmetike e rezultateve të pyetjeve përkatëse.

1. Treguesi i Besimit të Konsumatorit (TBK) që merr parasysh situatën aktuale dhe të pritshme financiare të konsumatorit, situatën aktuale dhe të pritshme ekonomike të vendit, të ardhmen mbi nivelin e papunësisë, kursimet dhe investime të mëdha (shtëpi).

2. Treguesi i Gjendjes Aktuale Ekonomike (TAE) që merr parasysh situatën financiare aktuale të konsumatorit, situatën e përgjithshme ekonomike aktuale dhe mundësinë për blerje të mëdha.

3. Treguesi i Gjendjes së Pritshme Ekonomike (TPE) që merr parasysh situatën e pritshme financiare të konsumatorit, situatën e përgjithshme ekonomike të pritshme, papunësinë, kursimet.

Me kryerjen e disa vrojtimeve dhe llogaritjen e këtyre treguesve, bëhet indeksimi i tyre. Për çdo pyetje ndërtohet një indeks, indekse që në fund përdoren për të formuar një indeks të vetëm.

ZGJEDHJA DHE SHPËRNDARJA E SAJ.

Numri i konsumatorëve që pyeten është 1206. Numri është përcaktuar në raport me popullsinë dhe duke marrë për bazë dhe eksperiencën e vendeve të tjera. Vrojtimi kryhet pranë familjeve qytetare, meqenëse edhe vrojtimi për indeksin e çmimeve të konsumit bëhet në zonën urbane.

Popullsia e qyteteve që morën pjesë në këtë vrojtim përfaqëson rreth 86.4 për qind të popullsisë urbane të Shqipërisë apo 36.4 për qind të popullsisë totale. Ndërkohë që popullsia e zonës urbane zë rreth 42.2 për qind të totalit të popullsisë[9]. Këto të dhëna krahasuese, flasin për faktin se kriteri gjeografik, në metodologjinë e këtij vrojtimi, është respektuar deri – diku kënaqshëm.

Përzgjedhja e familjeve bëhet me metodën e zgjedhjes së rastit dhe metoda e intervistimit është ajo e drejtpërdrejtë apo ballë për ballë.

[9] Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, viti 2001: "Popullsia e Shqipërisë në 2001", INSTAT.

REZULTATET E VROJTIMEVE.

Deri tani janë kryer katër vrojtime të konsumatorit me frekuencë tremujore. Gjykojmë se ky është ende një numër i vogël për të verifikuar përshtashmërinë e rezultateve të vrojtimit. E thënë ndryshe, është ende shpejt të gjykojmë nëse rezultatet e vrojtimit na japin me një përafërsi të pranueshme tendencën e sjelljes së konsumarit në të ardhmen, apo ndjesinë e tij në lidhje me situatën ekonomike. Kjo për disa arsye: e para, konsumatori shqiptar ende nuk është i edukuar me kulturën e vrojtimeve të tilla. Prandaj, mendojmë se do të duhet pak kohë (një numër vrojtimesh) që konsumatori të familjarizohet me llojin e pyetjes dhe të nuhasë mbase se çfarë nënkupton pyetja. Për më tepër, pyetjet gjithmonë bëjnë krahasime me periudha të mëparshme dhe të mëvonshme prandaj është esenciale që kjo ndjesi të reflektohet në përgjigjet e konsumatorit. Një rol të rëndësishëm ne tërë këtë proces luajnë padyshim intervistuesit, të cilët janë trainuar për kryerjen e vrojtimeve të tilla.

Së dyti, sic u përmend më sipër, vrojtimi i konsumatorit synon të masë edhe tregues për të cilët ekzistojnë burime të tjera informacioni dhe janë lehtësisht të verifikueshëm. Për shembull, ndjesia mbi rritja e cmimeve mund të verifikohet me indeksin e cmimeve të konsumit, apo pritjet për rritjen e papunësisë mund të verifikohen me të dhënat e INSTAT-it për papunësinë. Po kështu rritja ekonomike matet me të dhënat për PBB-në. Duke qenë se të dhënat statistikore për ekonominë reale në përgjithësi dalin me vonesë, duhet pritur disi për verifikimin e rezultateve të konsumatorit.

Megjithatë, mund të themi se deri tani, rezultatet nga kater vrojtimet përputhen me të dhënat statistikore, vecanërisht me të dhënat për inflacionin, si statistikë që ka frekuencë më të shpeshtë (cdo muaj). Duke u nisur nga kjo, jemi shumë optimistë se vrojtimi që kryejmë aktualisht ofron informacion të shfrytëzueshëm mbi disa tregues ekonomikë për të cilat statistikat ose mungojnë, ose dalin me një vonesë të konsiderueshme.

7. KONKLUZIONE

Treguesit e besimit janë orientues të tendencave të aktiviteteve ekonomike në përgjithësi. Ata plotësojnë kuadrin e informacionit statistikor dhe ndihmojnë procesin e vendimmarrjues si për institucioniet e administatës shtetërore ashtu edhe për bizneset dhe investitorët në sektorin privat të ekonomisë.

Rezultatet mbi treguesit e besimit japin informacione të vlefshme edhe për tendencat ekonomike sipas sektorëve duke ndihmuar kështu orientimin e drejtë të politikave sektoriale.

Vlefshmëria e të dhënave nga indekset e besimit lidhet edhe me ndihmën e tyre në drejtim të informacionit mbi zhvillimet ekonomike rajonale të vendit. Hartuesit e politikave të zhvillimit rajonal, do të shihnin tek indekset e besimit elemente mbështetëse për arritjen e synimeve afatgjata, duke hedhur hapa të sigurt në terma afatshkurtra dhe afatmesme.

Megjithë rolin e tyre të rëndësishëm[10] në orientimet që ato japin për zhvillimet ekonomike të pritshme në vend, përsëri shifrat që indekset e besimit sjellin duhen konsideruar me kujdes në një kuadër të plotë të zhvillimeve ekonomike-sociale dhe politike të një vendi.

Në këtë aspekt, shifrat e treguesve të besimit të biznesit dhe të konsumatorit shqiptar, janë studiuar që prej vitit 2002, me shumë kujdes nga ana e Bankës së Shqipërisë. Prandaj e gjithë kjo periudhë deri me sot është konsideruar si një periudhë prove apo testuese, me synimin e krijimit të një serie domethënëse të këtyre treguesve. Në këtë të rrugë jo të thjeshtë, ne gjykojmë se treguesit e besimit të ndërtuar janë shumë më përfaqësues apo cilësorë për situatat ekonomike aktuale, ndërkohë që pritjet, në pjesën më të madhe të rasteve, janë më optimiste. Kjo vjen jo vetëm nga një lloj dëshire e bizneseve dhe e konsumatorëve për të shpresuar për situata më të mira ekonomike në të ardhmen, por edhe pse informacioni që ata kanë në një moment kohor të caktuar nuk u lejon të bëjnë parashikime të plota. Edhe kur ky

[10] Shihni në aneksin A2, rezultate të indekseve të besimit të publikuara në revista ekonomike me reputacion ndërkombëtar.

informacion ekziston deri-diku i mjaftueshëm, kufizimet në kulturën e përgjithshme dhe në atë ekonomike të një pjese të bizneseve bizneseve, nuk lejojnë arritjen e përafrimeve të kënaqshme për ardhmëritë e aktivitetit ekonomik. Sidoqoftë, konsiderata e fundit, duket se nga vrojtimi në vrojtim ka ardhur duke u zbutur.

Kjo na bën të shpresojmë se treguesit e besimit janë në rrugën e konsolidimit dhe si të tillë mund të përdoren nga ana e Bankës së Shqipërisë, kryesisht për marrjen e sinjaleve për tendencat e ardhme afatshkurtra dhe afatmesme në ekonomi.

Banka e Shqipërisë, po vijon t'i vrojtojë me kujdes dhe t'i përdorë ata për qëllime të analizave të brendshme. Synimi kryesor mbetet, përmirësimi i në vijimësi i tyre, për të kaluar në publikimin e treguesve sa me cilesorë dhe domethënës, për një përdorim më të gjerë nga ana e institucioneve publike e private, nga ana e vetë bizneseve vendase e të huaja si edhe nga ana e konsumatorëve shqiptarë.

8. ANEKSE

8.1.

A 1: Pyetësorët

Besimi i bizneseve
Besimi i konsumatorëve

8.2.

A 2: Besimi i biznesit dhe i konsumatorit në faqet e Business Week

Ky pyetësor ka për qëllim të tërheqë opinionet e bizneseve në lidhje me ecurinë e treguesve më të rëndësishëm ekonomikë dhe financiarë të aktiviteteve që ushtrojnë, si edhe disa parashikime afatshkurtra të tyre .

Rubrika I: Të dhëna të përgjithshme të biznesit:
Me qëllim të kuptimit të njëllojtë të pyetjeve të dhëna në këtë rubrikë, më poshtë ju mund të gjeni këto shpjegime:

Përcaktimi i aktivitetit :

- Në përcaktimin e aktivitetit tuaj do të mbështeteni në shifrën e afarizmit . Nëse kryeni me shumë se një nga aktivitetet e shënuara më sipër, do të rrethoni aktivitetin që ka shifrën e afarizmit më të lartë.
- Po kështu do të veproni edhe për pyetjen e dytë të kësaj rubrike, në rast se kryeni më shumë se një nga aktivitetet e renditura.
- Shënim: a).Ndërmarjet me "fason" të përfshihen në aktivitet prodhues. b).Ndërmarjet që prodhojnë materiale ndërtimi të përfshihen në numrin 9 të pyetjes 2.

1. Jeni firmë me aktivitet (rrethoni një nga mundësitë e mëposhtme.):

1. Aktivitet prodhues. ☐
2. Aktivitet ndërtimor. ☐

2. Nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen e parë rrethoni aktivitetin në të cilin ushtroni biznesin tuaj:

1. Industria ushqimore. ☐
2. Industria tekstile . ☐
3. Industria e lëkurës dhe këpucëve. ☐
4. Punime me dru dhe fabrikim i artikujve me dru. ☐
5. Industria e letrës, kartonit, botime. ☐
6. Koksifikimi, rafinimi, industria nukleare. ☐
7. Industria kimike. ☐
8. Industria e kauçukut dhe plastikës. ☐
9. Fabrikimi i artikujve mineralë jo metalikë. ☐
10. Metalurgjia dhe përpunimi i metaleve. ☐
11. Fabrikimi i makinave, pajisjeve, pjesë të ndërrimit. ☐
12. Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike. ☐
13. Fabrikimi i mjeteve të transportit. ☐
14. Industri të tjera përpunuese. ☐
15. Ndërtimi. ☐

Rubrika II: Vlerësimi i klimës aktuale të biznesit:
Në dhënien e vleresimeve tuaja për këtë çështje, ju mund të gjykoni rreth:

- Klimës së brendshme politike të vendit dhe klimës politike në rajon.
- Gjendjes së sigurisë dhe rendit publik.
- Kuadrit ligjor dhe institucional, përfshirë legjislacionin fiskal e tatimor, atë të pronësisë, marrëdhëniet tuaja me administratën shtetërore dhe lokale etj.
- Marrëdhëniet tuaja me bankat dhe me sektorin financiar në tërësi (lehtësia e kreditimit, termat e kreditimit, shpejtësia e shërbimeve bankare, etj).
- Çështje të tjera specifike të biznesit tuaj (si lehtësia e gjetjes së tregut të shitjes, të burimeve të furnizimit, të sistemeve të informacionit mbi mundësitë e biznesit dhe të tregut të huaj dhe të vendit etj).

Ju mund të jepni më shumë pikë faktorëve që janë më të ndjeshëm në veprimtarinë e biznesit tuaj. Në po të njëjtët faktorë bazohet edhe parashikimi juaj për të ardhmen e klimës së biznesit.

3. Si e vlerësoni klimën aktuale të biznesit në vend gjatë tremujorit të tretë të vitit 2003 (korrik- shtator)?:

1. Të mirë
2. Normale
3. Jo të mirë

4. Renditni faktorët e mëposhtëm nga 1 (faktori më i rëndësishëm) deri në 5 (faktori më pak i rëndësishëm) të cilët kanë ndikuar në dhënien e përgjigjes në pyetjen e parë:

a. Klima e brendshme politike .
b. Gjendja e rendit dhe sigurisë .
c. Kuadri ligjor dhe institucional .
d. Marrëdhëniet me bankat dhe me sektorin financiar në tërësi .
e. Çështje të tjera specifike të biznesit tuaj.(specifiko)_____

1	2	3	4	5

(ju lutem të plotësoni të gjithë kuadratet sipas rëndësisë)

5. Si mendoni se do të jetë kjo klimë në të ardhmen (tetor-dhjetor)?:

1. Më e mirë
2. E njëjtë
3. E përkeqësuar

***Rubrika* III: Vlerësimi i aktivitetit të firmës suaj.**
Ju mund të bazoheni në treguesit kryesorë të biznesit tuaj, të tilla si volumi i shitjeve apo i shërbimeve që keni realizuar; numri i kontratave që keni lidhur apo i porosive që keni marrë nga klientët etj. dhe në parashikimet që keni për periudhën në muajt në vazhdim.

- **Inventari.**

Përfshin çdo ndryshim në gjendjen e produkteve të pashitura (stok) dhe të lëndëve të para të papërdorura.

- **Gjendja financiare.**

Përfshin çdo ndryshim në gjëndjen financiare të firmës, duke patur parasysh edhe nëse keni ndonjë vonesë në pagesat e kontratateve që keni me klientët privatë ose publikë.

III.1. Aktiviteti i përgjithshëm i firmës:

6. Si paraqitet ecuria e përgjithshme e firmës suaj në tremujorin e tretë të këtij viti (*korrik-shtator*)?

1. Është rritur
2. I njëjtë
3. Ka pësuar rënie

7. Si mendoni se do të paraqitet aktiviteti i firmës suaj në të ardhmen (tetor- dhjetor)?

1. Në ngritje
2. I njëjtë
3. Do të pësojë rënie

8. Si është paraqitur kërkesa për mallrat dhe shërbimet tuaja për periudhën korrik- shtator (duke u bazuar në vëllimin e shitjeve, nr e kontartave të lidhura apo porosive që keni marrë nga klientët?

1. Është rritur
2. I njëjtë
3. Ka pësuar rënie

9. Si mendoni do të paraqitet kërkesa për mallrat dhe shërbimet e firmës suaj në tre muajt e ardhshëm?

1. Në ngritje
2. I njëjtë
3. Do të pësojë rënie

10. Në rast se keni aktivitet eksporti, si është paraqitur kërkesa për eksport për mallrat dhe shërbimet tuaja? (Nëse nuk keni aktivitet eksporti, kaloni te pyetja 12).

1. Është rritur
2. I njëjtë
3. Ka pësuar rënie

11. Si mendoni do të paraqitet kërkesa për eksport për mallrat dhe shërbimet e firmës suaj në tre muajt e ardhshëm?

1. Në ngritje
2. I njëjtë
3. Do të pësojë rënie

12. Si është paraqitur ecuria e prodhimit në firmën tuaj në tremujorine e tretë (korrik-shtator?

1. Është rritur
2. E njëjtë
3. Ka pësuar rënie

13. Si mendoni do të jetë ecuria e prodhimit në firmën tuaj në të ardhmen (tetor-dhjetor)?

1. Në ngritje
2. E njëjtë
3. Do të pasojë rënie

III.2. Inventari (*Stock*-u)

14. Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në inventarin e firmës tuaj gjatë tre muajve të fundit (korrik-shtator)?

1. Është rritur
2. S'ka ndryshime
3. Ka pësuar rënie.

15. Çfarë ndyshimesh mendoni se do të ndodhin në tre muajt e ardhshëm (tetor-dhjetor)?

1. Do të rritet
2. S'do të ndryshojë
3. Do të pësojë rënie.

III.3. Çmimet:

16.Çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në çmimet e produkteve që firma juaj prodhon gjatë 3 muajve të fundit?

1. Janë rritur
2. S'kanë ndryshuar
3. Kanë pësuar rënie

17. Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet e produkteve tuaja në tre muajt e ardhshëm (tetor-dhjetor)?

1. Do të rriten
2. S'do të ndryshojnë
3. Do të bien.

III.4.Punësimi:

18. Si ka ndryshuar niveli i punësimit në firmën tuaj gjatë tre muajve të kaluar (tetor-dhjetor)?

1. Është rritur
2. Nuk ka ndryshuar
3. Ka pësuar rënie.

19. Si mendoni se do të ndryshojë punësimi në firmën tuaj në tre muajt e ardhshëm?

1. Do të rritet
2. S'do të ndryshojë
3. Do të pësojë rënie.

III.5. Konkurrenca dhe gjëndja financiare:

20. Si ka qenë konkurrenca në sektorin e aktivitetit tuaj ekonomik në këtë tremujor krahasuar me tremujorin paraardhës?

1. Më e madhe
2. E njëjtë
3. E përkeqësuar

21. Si ka qenë gjendja financiare e firmës suaj në tremujorin që kaloi?

1. Më e mirë
2. E njëjtë
3. E përkeqësuar

Rubrika IV : Investimet.

Investimet.

Investimet në struktura do të përfshinin zgjerime dhe rikonstruksione të ambjenteve të punës, apo punime të tjera rehabilituese si dhe çdo lloj investimi, që nuk përfshihet në zërin e pajisjeve. Investimet në pajisje të reja do të përfshinin vetëm zëvendësimin e teknologjive (makinerive e pajisjeve) që përdor firma juaj.

22. A ka kryer firma juaj investime në struktura apo në pajisje teknologjike të reja në gjashtë muajt e kaluar?

1. Po
2. Jo

23. Në rast se po ku mendoni se janë kryer ato? (mund të zgjidhni më shume se një mundësi):

1. Në struktura
2. Në pajisje teknologjike

24. A do të kryejë firma juaj investime në struktura apo në pajisje tekonologjike të reja në gjashtë muajt e ardhshëm?

1. Po
2. Jo

25. Në rast se po ku mendoni se do të kryhen ato?:

1. Në struktura
2. Në pajisje teknologjike

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Ky pyetësor ka për qëllim të tërheqë opinionet e konsumatorëve në lidhje me ecurinë e ekonomisë në përgjithësi dhe situatën financiare familjare, si edhe disa parashikime afatshkurtra të tyre.

***Shënim*:** Për çdo pyetje, ju lutemi, zgjidhni vetëm një nga mundësitë e rradhitura.

***Rubrika I:* Vlerësimi i situatës financiare familjare**
Me "situatë financiare" kuptohet aftësia që ka familja për të shpenzuar, për të kursyer apo për të investuar bazuar në nivelin e të ardhurave dhe të borxheve që merr.

1. Si ka ndryshuar situata financiare e familjes tuaj krahasuar me 3 muaj më parë?:

1. është përmirësuar shumë
2. është përmirësuar
3. nuk ka ndryshuar
4. është keqësuar
5. është keqësuar shumë

2. Si prisni të ndryshojë situata financiare e familjes tuaj gjatë 3 muajve të ardhshëm (janar -mars 2004)?:

1. do të përmirësohet shumë
2. do të përmirësohet
3. nuk do të ndryshojë
4. do të keqësohet
5. do të keqësohet shumë

***Rubrika II:* Vlerësimi i situatës ekonomike.** Me "situatë të përgjithshme ekonomike" kuptohet gjendja e ekonomisë së vendit në tërësi.

3. Si ka ndryshuar situata e përgjithshme ekonomike në vend gjatë 3 muajve të fundit?:

1. është përmirësuar shumë
2. është përmirësuar
3. nuk ka ndryshuar
4. është keqësuar
5. është keqësuar shumë

4. Si prisni të ndryshojë situata e përgjithshme ekonomike në vend gjatë 3 muajve të ardhshëm (janar -mars 2004)? :

1. do të përmirësohet shumë
2. do të përmirësohet
3. nuk do të ndryshojë
4. do të keqësohet
5. do të keqësohet shumë

***Rubrika III.* Kosto mesatare e jetesës.** Me termin "kosto mesatare e jetesës" nënkuptohet sasia mesatare e shpenzimeve të një familjeje për mallra dhe shërbime për konsum (afatshkurtër).

5. Si ka ndryshuar kostoja mesatare e jetesës krahasuar me 3 muaj më parë?

1. është rritur jashtëzakonisht shumë
2. është rritur ndjeshëm
3. është rritur pak
4. është e njëjtë
5. është ulur

6. Si mendoni se do të ndryshojnë çmimet në 3 muajt e ardhshëm (janar -mars 2004)?:

1. do të rriten me ritëm më të lartë
2. do të rriten me të njëjtin ritëm
3. do të rriten me ritëm më të ulët
4. nuk do të ndryshojnë
5. do të ulen pak

7. Si mendoni se do të ndryshojë niveli i papunësisë gjatë 3 muajve të ardhshëm (janar -mars 2004)?:

1. do të rritet shumë
2. do të rritet pak
3. nuk do të ndryshojë
4. do të ulet pak
5. do të ulet shumë?

8. A mendoni se tani është koha më e mirë për të bërë blerje në shuma të mëdha (si për shembull, mobilje, makinë larëse, TV etj.)?

1. po, tani është koha më e mirë për këto lloj blerjesh
2. nuk ka rëndësi koha kur bëhen këto blerje
3. jo, nuk është kohë e mirë këto blerje duhen lënë për më vonë

9. Krahasuar me 3 muajt e kaluar, për blerje në shuma të mëdha (si për shembull, mobilje, makinë larëse, TV etj.) në 3 muajt e ardhshëm (janar-mars 04), prisni të shpenzoni:

1. shumë më tepër
2. pak më tepër
3. pak a shumë njësoj
4. më pak
5. shumë më pak

***Rubrika IV.* Mundësia për të kursyer.** Kjo rubrikë i referohet nivelit aktual të kursimeve dhe aftesisë së familjarëve për të kursyer në të ardhmen, duke patur parasysh gjendjen ekonomike dhe nivelin e punësimit në vend.

10. Duke patur parasysh situatën e përgjithshme ekonomike, a mendoni se tani është:

1.kohë shumë e mirë për të kursyer
2. kohë e mirë për të kursyer
3. kohë e pafavorshme për të kursyer
4. kohë shumë e pafavorshme për të kursyer

11. A mendoni se gjatë 3 muajve të ardhshëm (janar - mars 2004,)të kurseni do të jetë:

1. shumë e mundshme
2. e mundshme
3. e pamundshme
4. krejtësisht e pamundshme

12. Cila nga fjalitë e mëposhtme përshkruan më me saktësi gjendjen aktuale financiare të familjes suaj?

1. po marrim borxh
2. për të përballuar shpenzimet po përdorim edhe kursimet
3. ia dalim të mbulojmë shpenzimet vetëm me të ardhurat
4. po kursejmë pak
5. po kursejmë shumë

13. A mendoni se blerja e një makine brenda vitit të ardhshëm (viti 2004) do të jetë:

1. shumë e mundshme
2. e mundshme
3. e pamundshme
4. krejtësisht e pamundshme

14. A mendoni të blini apo të ndërtoni një shtëpi brenda dy viteve të ardhshme (2004, 2005) ?

1. po, patjetër
2. ka mundësi
3. nuk ka shumë mundësi
4. absolutisht jo

15. Sa është e mundur që në vitin e ardhshëm (2004) të ndërmerrni shpenzime për riparimin e shtëpisë (instalime, ndërtime etj.)?

1. shumë e mundshme
2. e mundshme
3. e pamundshme
4. krejtësisht e pamundshme

***Rubrika V:* Të dhëna të përgjithshme**

Ju lutem plotësoni të dhënat personale si më poshtë:

a. Mosha: 1. 16 – 29 vjeç

2. 30 – 49 vjeç

3. 50 – 64 vjeç

4. 65 + vjeç

b. Edukimi: 1. tetëvjeçar
2. i mesëm
3. i lartë

c. Gjinia: 1. Femër

2. Mashkull

d. Punësimi: 1. i papunë
2. i vetëpunësuar
3. i punësuar në sektorin shtetëror
4. i punësuar në sektorin privat
5. pensionist
6. të tjera (shtëpiak, ushtar etj.)

International Figures of the Week

BESIMI I BIZNESIT

Country Focus / France

BERSHOR '03

Labor strife, a strong euro, and a reprimand by euro zone finance ministers calling on France to clamp down on its budget deficits could hamper the French economy for the rest of 2003.

The May factory purchasing managers' index slumped to 46.1%. Factory output fell for the third straight month, with respondents saying the recent labor strikes against government pension reforms contributed to the slowdown. The potential for more strikes and the decline in export orders to a 17-month low mean further output declines are likely.



The service sector is growing, but not by much. The purchasing managers' index was only 51% in May. Future expectations are improving, but current business activity shrank for a second straight month.

The weak economy is prompting the government to run a budget deficit anticipated to be 3.7% of the economy this year, well above the 3% euro zone ceiling. On June 3, France was given an October 3 deadline to take steps to "correct the excessive deficit position." That could put another drag on the economy heading into 2004. But to the dismay of some euro zone members, France got some breathing room. The decision stops short of forcing any reductions in its deficit this year.

Country Focus / Japan

KORRIK '03

Japanese manufacturers show signs of rebounding. However, don't expect anything more than weak growth in the second half of the year for the economy as a whole.

The second-quarter Tankan survey showed an unexpected improvement in business sentiment. The index of business conditions for large manufacturers climbed to −5, from −10 for the previous quarter, and expectations for the next three months held steady. In addition, the outlook for profits and fixed investment were upbeat.



The latest Tankan survey is buttressed by other factory data. May industrial output rose a strong 2.5%, with manufacturers saying June production was likely up 1.2%. And the Reuters purchasing-managers survey for June rose to a ten-month high of 50.4%. A reading above 50% indicates increasing factory activity.

The nascent recovery is, once again, based on exports. The Tankan report shows small- and medium-size factories, as well as nonmanufacturers—businesses that are more reliant on domestic demand—were not as optimistic. If exports accelerate, the labor market and consumer demand will get a boost. But a pickup at home depends on the strength of U.S. and Asian recoveries.

Country Focus / Germany

SHTATOR '03

Germany's economy contracted for a second straight quarter, a rule-of-thumb definition of recession. However, the worst appears to be over for the euro zone's largest economy.

Real gross domestic product fell by 0.1% in the second quarter, after dropping 0.2% in the first three months. Increases in capital investment and government outlays were more than canceled out by a further deterioration in foreign trade. Exports fell by 2.3% in the period.

The second half should be better. The IFO Institute's August business confidence index hit a 14-month high of 90.8. The hard-hit factory sector reported a particularly strong improvement. Some of the optimism is due to the 8% fall in the euro versus the U.S. dollar since late May. With exports making up almost a third of the German economy, a weaker euro will help. Labor productivity is also accelerating. Output per hour in the second quarter jumped by 0.7%, the biggest quarterly rise in three years.

Economists now expect real GDP will be flat this year. But the German government believes that if it can push social security reforms and tax cuts through the opposition-held upper house of parliament, the Bundesrat, growth should hit 2% in 2004.

COUNTRY FOCUS / GERMANY

So far, the appreciating euro is eating at profits German business earns from abroad. But the currency doesn't seem to be having a large enough impact on foreign demand to curb business confidence.

The IFO's January business climate index for western Germany hit a three-year high of 97.4. A more encouraging sign was the rise in the current situation index to 84.3. The gap between future expectations and current conditions indexes widened over 2003 as growth failed to meet expectations.

SHKURT 64

But the upturn in economic fortunes elsewhere, such as the U.S., is pushing up demand for exports. Indeed, the IFO said the January improvement was driven by the factory sector. And in its annual economic report on Jan. 27, the Economy Ministry forecasts a 5.8% jump in exports for 2004.

But the government and companies are leery of an even stronger currency. The annual report noted that the stout euro is starting to hurt exports. And an exchange rate of $1.30 is generally considered a critical level. If crossed, exports could take a further hit, jeopardizing the government's 2004 growth projection of 1.5% to 2%.

BESIMI I KONSUMATORIT

Country Focus / Euro Zone

JANAR '03

Euro Zone consumers were fairly resilient during 2002 despite disappointing economic performances throughout most of the region. Heading into 2003, though, consumer resolve is waning.

December consumer confidence in the twelve-nation euro zone declined for a third straight month, reaching a five-year low of −16. In addition, sentiment among retailers fell in December, with a large drop in their assessment of current conditions. The trend suggests consumers didn't keep the momentum from October, when retail sales rebounded 0.7%. Already, Germany reported monthly sales plunged 3.2% in November, and French vehicle sales fell 1.3% during December.



A large source of consumer unease is unemployment. Consumer expectations for the labor market in the next twelve months deteriorated in December. And while the November unemployment rate for the region held at 8.4%, the number of jobless increased by 100,000.

Of course, jobs aren't the only issue. Higher oil prices, government belt tightening to cap budget deficits, and uncertainty over the outcome in Iraq are also factors. These drags on consumers, as well as businesses, are leading economists to lower growth estimates for 2003 to near 1.5%.

Country Focus / France

PAIL '03

French consumers are very jittery. Although it is unlikely that they will really throw in the towel, conditions have grown bad enough to prompt the government to lower this year's growth forecast from 2.5% to 1.1%.

March consumer confidence fell for a third straight month, to −36. The war in Iraq and higher energy prices were to blame for some of the decline. But the longer-term concern is over jobs. Consumer pessimism regarding unemployment hit a record high, the March unemployment rate ticked up to 9.2%, and manufacturers say labor conditions are worsening.



Consumer sentiment may now be affecting spending. Demand for manufactured goods fell 0.5% in February, and economists see a further decline in March. Also, a government survey of retailers shows expectations for the coming months are the bleakest since 1996.

If the war doesn't drag on and postwar energy prices promptly unwind, spending could snap back. Lower inflation would boost purchasing power and fears regarding unemployment would likely ease somewhat. In addition, consumers haven't reported much change in their current financial position in months. Nor are they turning up their savings in case things get worse.

"RISTRUKTURIMI I SISTEMIT TË PAGAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË".[1]

1. HYRJE

Artikulli studimor që paraqitet në vijim trajton rikonceptimin e sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë. Ky rikonceptim përfshin në mënyrë të detajuar pjesën dërrmuese të strukturës së vjetër të pagave.

Gjatë trajtimit të sistemit të ri janë patur parasysh dhe janë materializuar qëllimi, parimet dhe synimet e përcaktuara nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë lidhur me politikën e pagave në Bankën e Shqipërise. Krijimi i strukturës që paraqitet, bazohet konceptualisht në teorinë "pagesë për rezultate" (*pay for performance*).

Në ndërtimin e kësaj strukture të re është realizuar:

1. eliminimi në maksimum i dhënies së të ardhurave pa punë të bërë, të treguar e të pranuar;

2. ruajtja dhe forcimi në maksimum i të drejtave të fituara të çdo anëtari të personelit të Bankës së Shqipërisë, por duke i disiplinuar ato në drejtim të interesit të ndërsjelltë të palëve: individit dhe institucionit.

Arsyeja kryesore e ndryshimit të strukturës së vjetër të pagave është orientimi i vazhdueshëm i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërise lidhur me hartimin e një politike të re pagash, e cila të merrte parasysh nivelin aktual të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe realitetet e reja të krijuara në tregun e punës. Por, nxitje për zëvendësimin e saj kanë qenë edhe mangësitë apo problemet e ndryshme që janë vënë re gjatë aplikimit të strukturës së vjetër.

Mjaft prej tyre janë konstatuar edhe nga këshilltarët e huaj që kanë këshilluar për një kohë të caktuar Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridik pikërisht për këto çështje. Ata kanë lënë edhe rekomandime të ndryshme, që janë reflektuar në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.

Struktura e re e pagave në Bankën e Shqipërisë ka si qëllim kryesor arritjen e objektivave të mëposhtëm.

1. Të vlerësojë sa më drejt arritjet dhe kontributin individual të anëtarëve të personelit dhe ta lidhë këtë vlerësim me pagën e marrë nga secili prej tyre. Si pasojë, konkurrenca ndërmjet anëtarëve të personelit dhe motivimi i tyre për punë më cilësore e rritje profesionale do të ishte më e lartë.[2]

2. Motivimi të jetë i vazhdueshëm, të shtrihet tek të gjithë anëtarët e personelit dhe të japë mundësi për një karrierë të drejtë, jo vetëm vertikale, por edhe horizontale. Në këtë mënyrë së pari, gjithkush do të gjejë veten aty ku ndjehet më i aftë dhe së dyti, do të kemi një element më shumë që do ta bëjë gjithësecilin që të mbetet i interesuar të qëndrojë e të punojë në Bankën e Shqipërisë.

3. Të mbajë në punë anëtarë personeli sa më të kualifikuar dhe sa më të aftë profesionalisht nëpërmjet një sistemi konkurrues pagese dhe të krahasueshëm me vende të njëjta apo të ngjashme pune të tregut aktual të punës.[3]

4. Të tërheqë specialistët më të aftë profesionalisht që gjenden në tregun e punës, duke i motivuar ata për marrëdhënie afatgjata me Bankën e Shqipërisë duke iu ofruar atyre siguri punësimi, shpërblim të drejtë dhe mundësi për rritje profesionale.[4]

---

[1] Artikulli është përgatitur nga Prof.Assoc.Dr.Roland Kajca, Përgjegjës i Zyrës së Politikave të Burimeve Njerëzore pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridik në Bankën e Shqipërisë. Në përpunimin dhe paraqitjen për botim të këtij materiali kanë ndihmuar edhe Z. Artur Lama e Zj. Eralda Dume. Materialin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

[2] Marrë nga rekomandimet e bëra nga z. David L. Schannon dhe z. Iain Thomson, ish-këshilltarë për burimet njerëzore në Bankën e Shqipërisë. Specialistët e mësipërm kanë qenë të dërguar nga FSVC në Bankën e Shqipërisë për ndihmë lidhur me zhvillimin e strategjisë së burimeve njerëzore në Bankë.

[3] Marrë nga rekomandimet e këshilltarëve të huaj.

[4] Marrë nga rekomandimet e këshilltarëve të huaj.

2. TË METAT, MANGËSITË DHE PROBLEMET E STRUKTURËS SË VJETËR TË PAGAVE

Paga e përgjithshme bazë në Bankën e Shqipërisë, sipas strukturës së vjetër përbëhej nga paga bazë dhe shtesat mbi të, të strukturuara si në tabelën e mëposhtme (tabela 1):

Si pasojë, me gjithë ndërhyrjet apo rregullimet e herëpashershme në të vihen re të meta, disa prej të cilave (që konsiderohen si më thelbësore) paraqiten në vazhdim së bashku me argumentimin përkatës.

E meta e parë, qartësisht e dukshme e strukturës së vjetër të pagave, është shtesa mbi pagë për vjetërsi të përgjithshme pune (shtesa

Tabela 1 – Tabela përmbledhëse e pagës (paga bazë plus shtesat mbi të) në Bankën e Shqipërisë sipas strukturës së vjetër.

Paga Totale Bruto	**Paga bruto = Paga bazë + Shtesat mbi pagë**							
Elementet e pagës	**Paga bazë**	**Shtesat mbi pagë**						
Elementet e pagës	Paga bazë	1. Shtesë për vjetërsi pune	2. Shtesë për vjetërsi pune në Bankën e Shqipërisë	3. Shtesë për rëndësi departamenti	4. Shtesë për rezultate në punë (shtesë për performancë)	5. Shtesë për kualifikim shkencor	6. Shtesë për vështirësi të vendit të punës	7. Shtesë për pjesëmarrje në projekt
Masa e secilit element	Në varësi të vendit të punës	0.4% për çdo vit vjetërsi pune por jo më shumë se 10% gjithsej	1% për çdo vit pune në bankë por jo më shumë se 20% gjithsej	20% për departamentet parësore, 10% për departamentet dytësore	Deri në 20% për rezultatet vjetore në punë	1000 lekë për DSTP 3300 lekë për Doktor 3850 lekë për Profesor i asocijuar 4400 lekë për Profesor	10% dhe 5% për vende të ndryshme pune	Deri 10% për pjesëmarrje në projekte

Sipas kësaj strukture page të gjitha shtesat së bashku, edhe në rastin më të mirë, janë në vlera më të vogla ose të barabarta me pagën bazë. Por, praktikisht ato me vështirësi arrijnë, maksimumi, deri në masën 50-70 për qind të saj. Shtesa e katërt, shtesa e pestë dhe shtesa e shtatë janë shtesa të pasigurta e të lidhura me rezultatet në punë ndërkohë që shtesa e parë, e dytë, e tretë dhe e gjashtë janë shtesa të sigurta, të cilat merren automatikisht. Theksojmë se shtesat e pasigurta përfitohen vetëm nga një pjesë (e vogël) e personelit.

Kjo strukturë pagash është në fuqi prej një kohe relativisht të gjatë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të Bankës por ajo, gjithsesi, nuk ka mundësuar një trajtim të përshtatshëm dhe të diferencuar të anëtarëve të saj të personelit.[5]

1 në tabelën 1)[6].

Së pari shtesa mbi pagë e dhënë për vjetërsi të përgjithshme pune në një profesion të ndryshëm nga ai që anëtari i personelit ushtron në Bankën e Shqipërisë, përbën një kosto jo efektive pune. Ajo nuk përfaqëson një vlerësim dhe shpërblim të drejtë të bazuar në aftësi apo kualifikim profesional, elementë këto që janë thelbësore në arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë. Po japim një shembull, i cili shpjegon më tej arsyetimin e mësipërm:

"Anëtari x i personelit është punësuar në Bankën e Shqipërisë si Përgjegjës Zyre në Departamentin e Burimeve Njerëzore. Më parë se të punësohej në Bankën e Shqipërisë ai ka punuar si manaxher në Departamentin e Burimeve Njerëzore të një banke tregtare, si

[5] Rekomandimet e këshilltarëve të huaj.
[6] E meta e parë dhe e dytë janë marrë nga rekomandimet e bëra nga z. David L. Schannon dhe z. Iain Thomson.

manaxher financiar në një kompani private biznesi, si llogaritar në një institucion mjekësor dhe si arkëtar në departamentin e pagesave në një bankë tjetër tregtare."

Ndërsa përvoja e anëtarit në fjalë të personelit si manaxher në Departamentin e Burimeve Njerëzore do t'i shërbejë atij pas punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë lidhur me eksperiencën e fituar si llogaritar ose si arkëtar. Prandaj, eksperienca si administrator i burimeve njerëzore duhet të konsiderohet si një element i lidhur me pozicionin e tij të punës në Bankën e Shqipërisë dhe duhet të merret parasysh gjatë analizës lidhur me punën në këtë pozicion. Ndërkohë që pjesa tjetër e eksperiencës nuk mund të konsiderohet si me vlerë e, si e tillë, nuk duhet të merret në konsideratë

Së dyti, në strukturën e vjetër të pagave eksperienca në punë, trajtohet si një motivues i jashtëm dhe jo si një motivues i brendshëm. Ndërkohë që, motivues të vërtetë janë vetëm motivuesit e brendshëm. Si pasojë, për këtë arsye, duhet të synohet që, aty ku ka mundësi, motivuesit e jashtëm të kthehen në të brendshëm.

Konkretisht, shtesa mbi pagë që përfitohet për efekt të kësaj eksperience jepet "gratis" dhe pa patur nevojë që të tregohet ndonjë vlerë apo punë e çfarëdolloji. Duke iu referuar Teorisë së Herzbergut "Higjena dhe Motivimi", nëse një pjesë e pagës do të jepet falas (sikurse përfitohet sipas strukturës së vjetër të pagave shtesa mbi pagë për vjetërsi të përgjithshme në punë apo për vjetërsi pune në bankë), atëhere ajo vetëm mund të ulë moskënaqësinë në punë (motivim i jashtëm) por nuk mund të rrisë kënaqësinë në të (motivim i brendshëm). Ndërkohë që do të verifikohej një tjetër pamje nëse eksperienca në punë rikonsiderohet e trajtohet si pjesë e përmbajtjes së punës; për shembull si një element që merret parasysh gjatë analizës për zënien e një vendi pune apo si kriter për promovim (karrierë) (sikurse është në strukturën e re). Në rastin e dytë ajo do të konvertohet e do të klasifikohej në një faktor të vërtetë motivues.

Një e metë e dytë e strukturës në fjalë të pagave identifikohet në shtesën mbi pagë të bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë.

Kjo shtesë, sipas strukturës së vjetër të pagave, jepet nga Guvernatori bazuar në propozimet e bëra nga eprorët e drejtpërdrejtë dhe nga drejtuesit e tjerë të lartë të bankës. Duke patur parasysh numrin e madh të anëtarëve të personelit të Bankës së Shqipërisë dhe faktin se kjo shtesë jepet për punën e përditshme, një metodë e tillë përfitimi e saj mund të mos rezultojë shumë efektive.

Kjo, sepse titullarët e Bankës së Shqipërisë, para së gjithash, janë përgjegjës për arritjen e objektivave institucionalë (dhe jo departamentalë) si dhe për udhëheqjen e të gjitha veprimeve të Bankës në një mjedis jo të qëndrueshëm (sikurse është ai shqiptar). Si pasojë, atyre u duhet që të fokusohen në shpërndarjen dhe administrimin e të gjitha burimeve të bankës dhe të delegojnë më shumë autoritet në nivelet e ulëta të administrimit.

Delegimi tek drejtuesit e departamenteve i të drejtës për dhënien e shtesës mbi pagë që lidhet me rezultatet në punë, do të ishte një zgjedhje e cila, përveç të tjerave, do t'i jepte më shumë autoritet niveleve përkatëse të drejtimit. Në këtë mënyrë, ata do të bëhen më të motivuar lidhur me përcaktimin e objektivave të departamenteve që ata drejtojnë (të dala nga objektivat e institucionit) dhe me ndarjen, me përmbushjen e me vlerësimin e drejtë të detyrave të personelit që kanë nën mbikëqyrje.

E meta e tretë është se struktura e vjetër e pagave nuk krijon mundësi për karrierë të drejtë horizontale duke mos lejuar (apo edhe penalizuar) kështu, mbi të gjitha, motivimin e mjaftueshëm të atyre burimeve njerëzore që janë të aftë e që, për shkak të mundësive të kufizuara reale për karrierë, nuk kanë mundësi të bëjnë karrierë vertikale.

Më konkretisht, anëtarë të caktuar stafi gëzonin nëpërmjet struktures së vjetër të pagave dhënie automatike shtese mbi pagë bazuar në vjetërsi pune të përgjithshme dhe në vjetërsi pune në bankë. Kjo e drejtë gëzohej pa treguar asgjë dhe pavarësisht nga rezultatet në punë që arrinte gjithësecili prej tyre.

Një analizë sipërfaqësore e kësaj situate do të nxirrte në pah se kemi të bëjmë me një lloj karriere horizontale që i mundësohet kujtdo, por që nuk vë asnjë kusht për ta përfituar. Thjesht

mjafton të kesh marrë pagën për një periudhe të caktuar diku ose në bankë.

Një analizë më e kujdesshme do të tregonte se karriera në fjalë është jo e bazuar apo e argumentuar qartë në ndonjë menyrë. Gjithkush e ka të lehtë ta kuptojë se të kesh marrë pagën diku nuk përbën ndonjë lloj të veçantë merite, që të mund të shërbejë si kriter për rritje automatike të përvitshme page. Ajo nuk gjeneron ndonjë lloj të ardhure apo nuk ndikon në ndonjë mënyrë në ndonjë burim tjetër të ardhurash prej të cilave të mund të merret pjesa që i jepet pagëmarrësit. Po ashtu, formalisht, ajo nuk ndikon që të sigurohet qoftë edhe një e ardhur minimale për vetë institucionin.

Praktikisht kemi të bëjmë me një të ardhur, përfitimi i së cilës, në një këndvështrim të caktuar, mund të konsiderohet deri si parazite; si e tillë efekti që ajo ka është demotivues apo edhe dëmtues. Pasi verifikohet që këtë shtesë page e përfitojnë automatikisht njëlloj, si ai që ka patur rezultate të larta në punë edhe ai që është më pak rezultativ apo që nuk impenjohet njësoj me të parin.

Dhe pa dyshim që, në të gjitha këndvështrimet, një sistem i tillë shpërblimi, vetëm punën apo njerëzit që punojnë nuk i nxit, duke krijuar kështu një barazitizëm jo të këndshëm.

E ardhura në fjalë do të kishte kuptim vetëm nëse klasifikohet si element social i pagesës. E shprehur ndryshe, kur pagat janë shumë të ulëta krijohen elemente të tilla shtese në page, që të justifikohet rritje e tyre në një nivel të mëtejshëm më të pranueshëm. Në një rast të tillë ajo ka kuptim të ekzistojë. Por, pagat në Bankën e Shqipërisë janë larg të qenit me natyrë sociale apo të ulëta. E si të tilla nuk ka arsye që një e ardhur e tillë të ekzistojë.

Si përfundim, mund të themi se vitet në punë, në vetvete, nuk kanë asnjë vlerë në drejtimin për të cilin po diskutojmë. Vetëm nëse shoqërohen me elemente të tjera të punës (që sjellin vlerë të re të shtuar) atëhere ato mund të merren në konsideratë, por thjesht për të dhënë mundësi për përfitim duke krahasuar punën e gjithkujt me atë të të tjerëve.

E meta e katërt që vihet re në strukturën aktuale të pagave është konceptimi dhe vlerësimi që i bëhet shtesës mbi pagë të atyre anëtarëve të personelit që kanë kualifikim shkencor.

Në strukturën e vjetër të pagave vlerësimi material që përfitohej për efekt të kualifikimit shkencor shprehet nëpërmjet një shtese mbi pagë, që vihet re se ka natyrë simbolike. Shumat e përfituara nuk arrijnë të përbëjnë element motivues e, për më tepër, vihet re edhe se konceptimi i tyre nuk i shërben punës në një bankë qendrore.

Nevojitet që kjo shtesë të rikonceptohet rrënjësisht e të shërbejë si një levë e fuqishme në interes të institucionit dhe të individëve të interesuar. Ky rikonceptim, së pari, duhet të synojë të rrisë cilësinë e punës kërkimore në bankë (e cila rezulton përherë e më dominuese në punën e një banke qendrore) dhe së dyti, të krijojë mundësi dhe shtytje reale për kualifikim të vazhdueshëm e prodhimtar të atyre specialistëve, që janë të prirur të zhvillohen në këtë drejtim. Dhe së treti, të mundësojë edhe rritjen e thithjes së këtij segmenti të kualifikuar burimesh njerëzore nga tregu përkatës i punës.

Një problem i pestë (i trashëguar dhe i verifikuar sërish edhe pas disa vrojtimeve të fundit) i strukturës së vjetër të pagave është mungesa e një vertikalizimi të plotë normal të sistemit të pagave dhe pagat relativisht të ulëta, veçanërisht në nivelet e sipërme, krahasuar me pagat për pozicione të njëjta ose të ngjashme të tregut aktual të punës.

Nëse do të bënim një krahasim të pagave të përfituara në nivele të ndryshme drejtuese te Bankës së Shqipërisë me ato në pozicione të njëjta apo të ngjashme me to në mjedise të tjera pune, të krahasueshme me atë të Bankës së Shqipërisë, do të vinim re dallime, të cilat penalizojnë drejtuesit e Bankës së Shqipërisë. Kur, në fakt, duhet të jetë e kundërta. Pasi Banka e Shqipërisë, përveçse është institucion unik dhe kushtetues, rezulton edhe shumë i rëndësishëm për nga profili i punës që kryen apo objektivat që merr përsipër të realizojë.

Për të ilustruar këtë fakt, mjafton të kujtojmë se Banka e Shqipërisë është institucioni që licencon, mbikëqyr dhe kontrollon të gjitha bankat e nivelit të dytë. Ndërkohë që të ardhurat e niveleve drejtuese në këto të fundit janë, nga më të larta, shumë më të larta, se

korrespondueset e tyre (nëse mund të bëhej një paralelizëm i tillë) në Bankën e Shqipërisë. Ndërkohë që normalisht duhej të ishte e kundërta.

E meta e gjashtë është mungesa e një klasifikimi të saktë e të plotë e të gjitha vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë, klasifikim i cili do të lejonte një shpërndarje më të drejtë edhe të të ardhurave përkatëse në formën e një shtese mbi pagë.

Në strukturën e vjetër të pagave verifikohet një paradoks i çuditshëm dhe i pajustifikueshëm në lidhje me klasifikimin dhe me trajtimin përkatës material të secilit vend pune. Nga një anë ka një unifikim të atyre të vendeve të punës që mbajnë të gjithë peshën e punës të një banke qendrore (rrjedhimisht verifikohet edhe një unifikim i pagave përkatëse). Nga ana tjetër, ka një "pafundësi" vendesh pune që janë të njëjta apo gati të njëjta ndërmjet tyre për nga rëndësia që paraqesin në arritjen e objektivave të një banke qëndrore - e që për më tepër as që mund të krahasohen me të parat - që trajtohen në mënyrë të diferencuar në pagë.

E shprehur ndryshe, të gjithë specialistët e bankës (pjesa që mundëson edhe kryerjen reale të punës që lejon ekzistencën e bankës) trajtohen njëlloj me pagë bazë pavarësisht llojit të punës që ata bëjnë (që rezulton e ndryshme në varësi të profilit të departamentit ku ata janë të punësuar). Ndërkohë që trajtohen me pagë të ndryshme bazë deri edhe mirëmbajtësit (në varësi të profilit që ata kanë), shoferët apo edhe pastrueset në varësi të të qenurit në organikën e administratës qendrore apo në degët e saj.

Për të qenë të saktë duhet thënë se ekziston në strukturën e vjetër të pagave një diferencim për të parët (ai që lidhet me shtesën për klasifikim departamenti), por ky diferencim pa dyshim që nuk është i mjaftueshëm në nivelin aktual të zhvillimit të mjedisit të Bankës së Shqipërisë e nuk do të jetë i tillë akoma më shumë në të ardhmen e afërt të saj (kemi parasysh këtu impenjimet afatmesme të marra prej Bankës së Shqipërisë). Dhe për me tepër nuk lidhet me llojin e punës së individit, por me llojin e strukturës ku ai bën pjesë.

Nuk duhet harruar këtu të kujtohet se kriteret e përdorura për të realizuar klasifikimin ekzistues ose mungojnë tërësisht ose janë të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundime të sakta.

Niveli i zhvillimit të punës në Bankën e Shqipërisë kërkon një klasifikim të rikonceptuar, i cili duhet të ndryshojë situatën e sipërcituar. Një klasifikim i tillë i plotë, i cili merr parasysh disa kritere vlerësimi (janë tetë të tilla nga maksimumi dy që janë përdorur në klasifikimin e vjetër) është në përpunim e do të paraqitet së afërmi për t'u implementuar.

3. SI DO TË NDRYSHOJË SKEMA E PAGËS ME RISTRUKTURIMIN E SAJ?

Ristrukturimi i sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë u konceptua të realizohej të paktën në dy faza. Kjo, në varësi të zgjidhjes së problemeve të sipërpërmendura dhe të krijimit të një sistemi që të ishte shumë më fleksibël se sa i mëparshmi.

Modeli final synon të ketë pagë bazë sa më të ulët e sistem shtesash të lidhura ngushtësisht me elemente të caktuara të punës, të pranuar këta të fundit si të rëndësishëm për të lejuar marrjen e shtesave përkatëse. Sipas këtij modeli, në pagën e përgjithshme bruto, ulet pesha e pjesës së sigurtë të pagës dhe rritet pesha e pjesës së pasigurtë të saj (përfitimi i së cilës lidhet me rezultatet në punë).

Konkretisht, do të ulet sa më shumë pesha e pagës bazë dhe e shtesave të sigurta mbi të, ndërkohë që do të rritet pesha e shtesave të pasigurta. Le ta shikojmë më në detaje këtë transformim.

Sipas strukturës së vjetër të pagës kemi këtë ndërtim të saj:

Paga bruto = Pagë bazë + shtesa mbi pagë

Ku:

Paga bazë – është një madhësi e përcaktuar (fikse) në vlerë.

Shtesat mbi pagë – në pjesën dërrmuese janë madhësi të përcaktuara (fikse) në vlerë dhe jo të lidhura me rezultatet në punë.

Edhe në strukturën e re ruhet po e njëjta skemë e përgjithshme e saj; pra paga e përgjithshme përsëri do të rezultojë si shumë e pagës bazë me shtesat mbi të.

Në mënyrë skematike paga sipas strukturës së vjetër jepet në skemën 1[7]:

Paga bruto	=	Paga bazë	+	Sht. mbi pagë

Skema 1. Struktura e vjetër e pagës në Bankën e Shqipërisë

Vihet re pesha e madhe e pagës bazë në pagën bruto (krahasuar me pjesën tjetër të saj) dhe pesha e ulët e shtesave në të. Kujtojmë se shtesat janë të gjitha të sigurta, me përjashtim të njërës (asaj për rezultate në punë) e cila përfitohet vetëm nga një pjesë e caktuar (e kufizuar) e personelit. Sipas të dhënave statistikore të viteve të fundit që ne disponojmë, rezulton se kjo shtesë ka një peshë fare të parëndësishme në pagën e përgjithshme.

Sipas modelit të propozuar struktura përmbyset (bëhet fjalë për peshën e elementeve përbërëse të saj) duke marrë formën e paraqitur në skemën e mëposhtme (skema 2):

Paga bruto	=	Paga bazë	+	Shtesat mbi pagë

Skema 2. Struktura e re e pagës e propozuar në Bankën e Shqipërisë.

Ku:

Paga bazë - është një madhësi e përcaktuar (fikse) në vlerë, por sa më e ulët.

Shtesat mbi pagë - madhësi sa më pak fikse në vlerë, të lidhura sa më shumë me rezultate në punë dhe me peshë të përgjithshme sa më të madhe në pagën bruto.

Ndryshon edhe strukturimi i vetë shtesave. Në modelin e vjetër shtesat ishin të strukturuara sipas skemës së mëposhtme (skema 3):

Shtesat mbi pagë	=	Shtesa të sigurta	+	Shtesa jo të sigurta

Skema 3. Struktura e shtesave mbi pagë dhe e peshës përkatëse sipas llojit të tyre në modelin e vjetër

Vihet re pesha e madhe e shtesave të sigurta dhe pesha e vogël (në praktikë gati e papërfillshme) e shtesave të pasigurta e të lidhura me punën.

[7] Në të gjitha skemat madhësia e kuadrateve përkon afërsisht me peshën e secilit përbërës

Ndërkohë që sipas skemës së re, struktura e shtesave do të ndryshojë si më poshtë (skema 4):

Shtesat mbi pagë	=	Shtesë e sigurtë	+	Shtesë pjesërisht e sigurtë	+	Shtesë jo e sigurtë (e varur nga rezultatet në punë)

Skema 4. Struktura e shtesave mbi pagë dhe e peshës përkatëse sipas llojit të tyre në modelin e ri.

Edhe këtu vihet re përmbysje e skemës së vjetër. Ulet pesha e shtesave të sigurta dhe rritet pesha e atyre që janë të pasigurta e të lidhura me punën.

Si përfundim, mund të themi se në skemën e re vihen re përmbysje të raporteve të pagës bazë krahasuar me shtesat mbi të.

Dhe mbi të gjitha realizohet ajo që kërkuam më lart: ndryshimi i strukturimit të të gjithë pagës; ulja e peshës së sigurtë të saj dhe rritja e peshës së pasigurtë e të lidhur me punën.

Një paraqitje e mundshme skematike e modelit përfundimtar do të ishte ajo në vijim (tabela 2)[8]:

Tabela 2 – Tabela përmbledhëse e pagës (paga bazë plus shtesat mbi të) në Bankën e Shqipërisë sipas strukturës së re.

Paga Totale Bruto	**Paga bruto = Paga bazë + Shtesat mbi pagë**							
Elementet e pagës	**Paga bazë**	**Shtesat mbi pagë**						
Elementet e pagës	Paga Bazë	1. Shtesë për klasifikim të vendit të punës	2.Shtesë për kategori pune	3. Shtesë për rezultate në punë (i gjithë stafi me përjashtim të drejtuesve)	4. Shtesë për funksione drejtuese (bazuar në rezultate në punë dhe vetëm për drejtuesit)	5. Shtesë për rezultate në punë (lloj tjetër dhe e përfitueshme nga i gjithë stafi me arsim të lartë)	6. Shtesë për kualifikim shkencor	7. Shtesë për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete
Masa e secilit element	Në varësi i të vendit të punës	Në përpunim (nuk është ende në fazën e implementimit)	Në varësi të kategorisë dhe të pagës bazë	Aktualisht deri në 20%	Aktualisht (me përjashtim të administratorëve (është 0-20%)	Në përpunim (nuk është ende në fazën e implementimit)	Aktualisht sa në strukturën e vjetër (do të synohet të ndryshojnë)	Deri 10% për pjesëmarrje në projekte

Bazuar në skemën e sipërtreguar, përveçse do të ulet masa dhe pesha e pagës bazë në vlerë absolute, do të rritet pesha e shtesave (synimi përfundimar është që të shkojë në rreth 150 për qind e më tepër në raport me pagën bazë) dhe do të kemi vetëm një shtesë të sigurtë (shtesa për klasifikim të vendit të punës), një shtesë pjesërisht të sigurtë dhe që duhet fituar njësoj si shtesat e pasigurta (shtesa për kategori) dhe pesë shtesa të tjera të pasigurta. Theksojmë se gjashtë shtesat e fundit do të varen nga rezultatet në punë.

Duhet thënë se një pjesë e konsiderueshme e modelit të ri, tashmë është e implementuar. Ndërkohë që është në përpunim faza e dytë e tij, e cila, të paktën në këndvështrimin strukturor, synohet që ta përmbyllë plotësisht atë.

[8] Në vijim do të flitet më hollësisht për secilin element të kësaj strukture të re e cila aktualisht është vetëm pjesërisht e implementuar.

4. TË REJAT KRYESORE TË MODELIT TË RI TË PAGAVE DHE NJË SHPJEGIM I SHKURTËR I TYRE

Të rejat e modelit të ri të pagave lidhen me *rikonfigurimin e klasifikimit* që lejon strukturimin e pagës si dhe me vetë *strukturën* e saj. Trajtohen në vazhdim të rejat kryesore të të dyja drejtimeve të sipërpërmendura.

Ristrukturimi i sistemit të pagave u parapri fillimisht nga një klasifikim dhe rigrupim i vendeve të punës dhe i pagave bazë përkatëse. Risistemim i cili u krye dhe i shërbente vetëm këtij ristrukturimi. Në këtë kontekst, të gjitha vendet e punës u klasifikuan në klasa, grupe dhe nivele. Ky risistemim përbën *të renë e parë* të modelit të ri të pagave.

Futja e konceptit të klasës, të grupit dhe të nivelit ka qëllim identifikues e klasifikues të vendeve të punës. Në strukturën e vjetër të pagave kishte ndarje vertikale të vendeve të punës, por pa i dhënë një emër të vetëm një numri të caktuar syresh kur ata trajtoheshin njëlloj me pagë bazë apo me elementet e tjera të saj.

Për të lehtësuar identifikimin e secilit grup vendesh të njëjta pune (për nga rëndësia) u fut koncepti i "klasës", koncept ky i përdorur gjerësisht për këtë qëllim edhe në struktura të tjera të organizuara (mund të sjellim këtu si shembull klasifikimin aktual në administratën publike shqiptare). Në strukturën e re, me konceptin klasë do të kuptohet një ose më shumë vende pune, të cilat klasifikohen si të njëjtë për nga rëndësia që kanë në Bankën e Shqipërisë. Klasa është një klasifikim vertikal i vendeve të punës dhe lidhet me vlerësimin bazë material (pagën bazë) apo me vlerësime të tjera që i bëhen vendit apo grupit përkatës të vendeve të punës.

Në strukturën e re ka dhjetë klasa, tetë prej të cilave janë ekzistuese pavarësisht se nuk identifikohen nëpërmjet këtij koncepti (janë lehtësisht të identifikueshme nëse vihen re pagat e përfituara sipas strukturës së vjetër), ndërsa dy të fundit janë rigrupime të të gjitha vendeve të tjera të punës të të njëjtit lloj (gjithsej 20 nivele page bazë) e që lidhen me veprimtaritë ndihmëse të punës në Bankën e Shqipërisë.

Nisur nga llojshmëria dhe sasia e madhe e punëve ndihmëse (apo të atyre që sidoqoftë nuk mund të konsiderohen si kryesore në lidhje me punën apo me detyrat kryesore të një banke qëndrore), si edhe nga klasifikimi përkatës i tyre (i identifikueshëm vetëm nëpërmjet pagës bazë) këto dy klasa u ndanë në pesë grupe (nënndarje vertikale). Ky rigrupim lejoi kalimin nga 20 nivele pagash bazë të këtyre lloj punëve në vetëm 5 të tilla. Sasi që justifikon edhe rëndësinë e pakët të tyre në llojin e punëve që kryhen në një bankë qendrore. Nuk përjashtohet mundësia që këto grupe të reduktohen akoma më tej.

Duhet thënë se futja e konceptit të klasës lehtëson edhe futjen e konceptit të kategorisë[9]. Koncepti i kategorisë konfiguron një lloj të ri karriere (karrierë horizontale) në Bankën e Shqipërisë. Kjo karrierë nuk ekzistonte sipas strukturës së vjetër të pagave.

Secila klasë e merr emrin nisur nga vendi më i rëndësishëm i punës që bën pjesë në të apo nga karakteristikat më të përgjithshme të punës që lejojnë klasifikimin në të.

Me konceptin e klasës dhe të grupit lidhet edhe paga bazë e të gjithë punonjësve të bankës. Pra, çdo klase (kur nuk ka grupe) dhe çdo grupi (kur ka të tillë), i përket një pagë bazë e caktuar e ndryshme nga gjithë të tjerat.

Ndërsa me konceptin nivel, në strukturën e re identifikohet një (makro) ndarje vertikale. Klasifikohen brenda një niveli punë të ndryshme që, megjithëse janë aq të ndryshme sa që nuk mund të klasifikohen dot brenda një klase apo grupi, kanë mjaft elemente apo karakteristika të tjera të përbashkëta cilësore që i dallojnë në grup nga ndarjet e tjera. Për shembull, vendi i punës "Guvernator" dhe vendi i punës "Zëvendësguvernator" dallohen midis tyre për nga shumë elemente. Por, krahasuar me të gjitha vendet e tjera të punës në Bankën e Shqiperise, ajo që i bashkon është më e fortë se sa ajo që i ndan. Prandaj, në shume raste, vendet e punës në fjalë identifikohen me një emër të vetëm dhe pa i ndarë nga njëri-tjetri

[9] Për këtë koncept do të flitet më hollësisht në vijim.

(termi administratorë). Po kështu mund të vazhdohet analiza edhe me grupime të tjera. "Drejtorët e departamenteve" dhe "Zëvendësdrejtorët e departamenteve" kanë gati të njëjtën peshë në drejtimin e departamenteve dhe elementet që i bashkojnë janë më të fortë se sa ato që i ndajnë, krahasuar me grupimet e tjera poshtë dhe sipër tyre. Kjo i bën të dallohen qartë si nivel krahasuar me të gjitha vendet e tjera të punës poshtë tyre. Por, ata nuk kanë as karakteristikat cilësore të administratorëve e si rrjedhim nuk mund të klasifikohen në të njëjtin nivel me ta.

Në strukturën e re të propozuar të vendeve të punës dallohen pesë nivele (vertikale) punësimi. Secili nivel përbëhet nga dy klasa.

Qëllimi kryesor i futjes së konceptit nivel, ashtu sikurse edhe në rastin e klasës apo të grupit, është mundësia e trajtimit të klasave përbërëse të ndonjërit apo secilit prej tyre në grup për efekt të arritjes së qëllimeve të ndryshme të strukturës së re të pagave.

Treguam se tre konceptet e sapotrajtuara janë ndarje vertikale të vendeve të punës. Ato mundësojnë karrierën vertikale të punës në Bankën e Shqipërisë. Por, jo të gjithë e kanë këtë mundësi. Sa më lart të kërkosh të ngjitesh në hierarki aq më e vështirë bëhet ngritja në të. Arsyet janë lehtësisht të kuptueshme për të gjithë, pasi në një departament nuk mund të ketë tre drejtorë dhe tetë zëvendësdrejtorë; vetë natyra e punës nuk e lejon këtë.

Për këtë arsye, në strukturën e re të pagave është futur koncepti i kategorisë, i cili është tërësisht i ri. Kategoria është *e reja e dytë* e modelit të ri të pagave. Në fakt kemi të bëjmë më shumë me përshtatjen e këtij koncepti në kuadrin e ristrukturimit të organigramës së vendeve të punës në Bankën e Shqiperisë dhe jo ne futjen e ndonjë koncepti të papërdorur. Pasi edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një nocion gjerësisht të njohur në shumë lloje organizatash.

Kategoria është një ndarje apo një klasifikim që i bëhet secilit vend pune dhe që lejon rritjen e pagës pas periudhave të caktuara kohore e duke u bazuar në vitet në punë dhe, ajo që është më e rëndësishme, në rezultatet në punë. Me marrjen e kategorisë përfitohet rritja përkatëse e pagës nëpërmjet shtesës me të njëjtin emër. Ndërkohë që mungesa e rezultateve mund të sjellë uljen në kategori apo edhe mosklasifikimin në ndonjërën prej tyre.

Kjo lloj ndarjeje lejon eliminimin e dy shtesave më të përfolura mbi pagë (sipas strukturës së vjetër të pagave); *për vjetërsi të përgjithshme në punë* dhe *për vjetërsi pune në bankë.* Kategoria është një ndarje horizontale e secilës klasë (ose grup). Kjo ndarje nuk do të thotë përparim kryesisht në përgjegjësi (sikurse ndodh në rastin e karrierës vertikale) por përparim kryesisht në profesion (rritje profesionale).

Qëllimi i futjes së konceptit të kategorisë është i shumëfishtë:

- Nëpërmjet kategorisë mënjanohet dhënia falas e dy shtesave të sipërpërmendura. Strukturimi i secilit vend pune në kategori dhe shtesa përkatëse e secilës prej tyre, lejojnë klasifikimin e kësaj të fundit, si faktor real motivues në punë. Theksojmë se është tentuar që sasia e shpërblimit material të përfituar nga klasifikimi në një kategori të caktuar të jetë e njëjtë ose e përafërt me atë të përfituar nga dy shtesat e eleminuara. Vihet re pra që sasi e njëjtë shpërblimi material nuk jepet falas por kundrejt pune të bërë. Kjo sjellje lejon largimin nga konceptimi i strukturës së vjetër ku kjo sasi parash trajtohej si kosto joefektive apo vetëm si zvogëluese pakënaqësie.

- Nëpërmjet futjes së kategorive mundësohet një lloj tjetër karriere përveç asaj vertikale - e quajtur horizontale - e cila mund të përbëjë një motivim më shumë për të qëndruar (apo për të ardhur) në Bankën e Shqipërisë, për të gjithë ata individë që janë apo që ndjehen rezultativë në punën e tyre.

- Kushtëzimi i kalimit në një kategori më të lartë me rezultatet në punë do të nxisë punën në të gjitha nivelet e punësimit, pasi nëse nuk ka rezultate në punë nuk ka ngritje në kategori.

- Nëpërmjet futjes së kategorive realizohet një e drejtë më tepër, jo vetëm për një segment të caktuar individësh, por për të gjithë anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë. Bëhet fjalë për të drejtën për karrierë. Për përfitimin e së cilës ka vetëm një kriter të vetëm cilësor matës: rezultatet në punë. Një e drejtë e tillë tregon edhe një impenjim të Bankës së Shqipërisë në drejtim të shtimit dhe të konsolidimit të mundësive për zhvillim të potencialeve të anëtarëve të saj të personelit.

- Rritet fleksibiliteti i sistemit të pagave duke "e copëtuar" atë në funksion të rezultateve në punë; rrjedhimisht, kemi strukturimin e saj sipas kërkesave të *"pay for performance".*

Paraqitja e marrëdhënieve të krijuara ndërmjet niveleve, klasave, grupeve dhe kategorive jepet në mënyrë skematike në skemën e mëposhtme (tabela 3)[10].

atyre anëtarëve të personelit, që nuk kanë mundësi për t'u zgjedhur në nivele drejtuese dhe/ose që kanë aftësi të mëdha profesionale. Por, futja e këtij klasifikimi lidhet edhe me faktin se në rastin e departamenteve me numër të lartë të punësuarish, mund të lindë nevoja e një klasifikimi më të detajuar të këtyre të fundit në funksion të detyrave që ata kryejnë.

Tre të rejat mësipërme kishin të bënin me *rikonfigurimin e klasifikimit* që lejon strukturimin e pagës, ndërkohë që të tjerat në vazhdim lidhen me vetë *strukturën e saj.*

Treguam më sipër se skema e pagës mbetet po ajo e strukturës së vjetër; pagë bazë plus shtesa mbi pagën bazë. Ndërkohë që struktura e re, bazuar sidomos në zhvillimin e mjedisit në Bankën e Shqipërisë apo në detyrimin për të realizuar përherë e më mirë detyrat dhe punën në të, (a) redukton nivelet e pagës bazë dhe (b) eliminon, rikoncepton ose ndryshon shtesat mbi to.

Në strukturën e vjetër verifikoheshin gjithsej 28 nivele page bazë dhe mbi to shtoheshin shtesat e mëposhtme:

Tabela 3 – Lidhja ndërmjet niveleve, klasave dhe grupeve në strukturën e re të pagave në Bankën e Shqipërisë.

Niveli	Klasa	Grupi	Kategoritë							
Niveli i lartë i drejtimit	Klasa I	Nuk ka							1	2
	Klasa II	Nuk ka							1	2
Niveli i ulët i drejtimit	Klasa III	Nuk ka					1	2	3	4
	Klasa IV	Nuk ka					1	2	3	4
Niveli i shërbimit profesional	Klasa V	Nuk ka			1	2	3	4	5	6
	Klasa VI	Nuk ka	1	2	3	4	5	6	7	8
Niveli i shërbimit të përgjithshëm	Klasa VII	Grupi A	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi B	1	2	3	4	5	6	7	
	Klasa VIII	Grupi A	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi B	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi C	1	2	3	4	5	6	7	

E reja e tretë e modelit të ri të pagave nuk është gjë tjetër veçse "kthim në origjinë". Bëhet fjalë për rifutjen në strukturë të klasifikimit "kryespecialist". Arsyeja kryesore e futjes së këtij klasifikimi lidhet me shtimin e mundësive për karrierë vertikale (krahas asaj horizontale) të

- (1) për vjetërsi të përgjithshme pune;
- (2) për vjetërsi pune në bankë;
- (3) për klasifikim departamenti (ose njësie organizative);

[10] Paraqitja e kategorive tregon në mënyrë të përafërt edhe periudhën kohore që kushtëzon marrjen e kategorive apo kalimin nga një kategori në tjetrën. Vihet re se sa më lart të ngjitesh vertikalisht (sa më shumë karrierë vertikale që të jetë bërë) aq më të pakta janë mundësitë për të bërë karrierë horizontale. Gjatë diskutimit të aplikimit të kategorive u vendos që të zbatohej ky model krahasuar me një tjetër që lejonte karrierë të barabartë si vertikale ashtu edhe horizontale për të gjitha vendet e punës. Arsyeja kryesore ishte se karriera horizontale, si koncept, u fut edhe si një mundësi apo e drejtë për karrierë për ata punonjës që nuk kishin mundësi të bënin karrierë vertikale. Ndërkohë që adoptimi i modelit tjetër e eliminonte këtë arsye.

- (4) për vlerësimin e rezultateve në punë;
- (5) për kualifikim shkencor;
- (6) për vështirësi të vendit të punës;
- (7) për pjesëmarrje në projekt.

Treguam gjithashtu, se paga e mundshme bruto sipas strukturës së re përbëhet nga paga bazë plus shtesat e mëposhtme (tabela 2):

- (1) për klasifikim të vendit të punës;
- (2) për kategori pune;
- 3) për vlerësimin e rezultateve në punë;
- (4) për funksione drejtuese;
- (5) për rezultate në punë (e ndryshme nga e mësipërmja);
- (6) për kualifikim shkencor;
- (7) për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete.

Nga të gjitha shtesat e mësipërme të strukturës së re vetëm shtesa e parë nuk varet nga rezultatet në punë. Ndërkohë që të tjerat, në një mënyrë apo tjetër, kushtëzohen prej tyre në mënyrë vendimtare. Duke bërë të mundur kështu modelimin e plotë të strukturës së re të pagave në Bankën e Shqipërisë sipas konceptit *"pay for performance".*

Do të shtjellojmë në vazhdim shkurtimisht secilën prej tyre.

(1) Shtesa për klasifikim të vendit të punës është një shtesë ende jo e implementuar dhe në përpunim. Me pak fjalë kjo shtesë bazohet në klasifikimin e të gjithë vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë, bazuar në pikët që merr secili prej tyre në tetë kritere që konsiderohen si të mjaftueshme për të mundësuar këtë klasifikim. Ky klasifikim përfshin dhe zëvendëson (duke përmirësuar rrënjësisht dhe konceptualisht) dy nga shtesat e strukturës së vjetër; *shtesën për klasifikim departamenti* dhe *shtesën për vështirësi të vendit të punës.* Kjo shtesë është fikse si madhësi dhe llogaritet mbi pikët që përfiton secili vend pune. Ekziston mundësia që kjo shtesë të suprimojë tërësisht pagën bazë dhe të shërbejë ajo vetë si kriter kryesor në përcaktimin e pagës bazë.

(2) Shtesa per kategori pune është shtesa e dytë tërësisht e re, e cila tashmë është e implementuar. Kjo shtesë zëvendëson dy shtesa të strukturës së vjetër të pagave, të cilat perfitoheshin automatikisht dhe falas. Zëvendësimi i shtesave në fjalë përbënte një ndër problemet më kryesore që duhej përballuar në konceptimin e strukturës së re të pagave pasi pesha e tyre në strukturën e vjetër ishte e konsiderueshme. Shtesa për kategori është fikse për secilën kategori dhe e ndryshme për kategori të ndryshme. Ajo përfitohet nëse plotësohen disa kushte, më kryesorja e të cilave, sikurse është thënë edhe më sipër, janë rezultatet në punë.

(3) Shtesa për vlerësimin e rezultateve në punë dhe shtesat e tjera të kësaj natyre që do të tregohen në vijim, pësojnë dhe përbëjnë ndryshime të rëndësishme, shpjegimet e zgjeruara të të cilave meritojnë një artikull studimor më vete. Madhësia e saj është e ndryshueshme dhe masa e përfituar për një periudhë të caktuar varet vetëm nga rezultatet në punë. Në vijim do të mjaftohemi vetëm me një përshkrim të shkurtër të saj.

Së pari, kjo shtesë ndryshon "përbërjen" e saj. janë thjeshtuar kriteret që lejojnë përfitimin e saj, duke u bërë më të drejtpërdrejtë e duke synuar dhënien në mënyrë më të qartë e më të saktë të asaj që kërkohet të arrihet. Në këtë kuadër janë krijuar dy formularë tip; një për specialistët me arsim të lartë dhe një tjetër për personelin pa arsim të lartë.

Së dyti, kjo shtesë ndryshon "pronarin" që e administron. Sipas strukturës së vjetër të pagave ajo jepej nga Guvernatori, pas propozimit të bërë nga drejtuesit e departamenteve. Ndërkohë që sipas strukturës së re, e drejta e dhënies së saj delegohet tek vetë drejtuesit e departamenteve (apo njësive të cilat janë të barazuara me to). Këta të fundit kanë fuqi të plotë për të përcaktuar masën e kësaj shtese, bazuar kryesisht në realizimin e planit të punës për periudhën që kryhet matja formale e rezultateve në punë por edhe në elemente të tjera të saj, të treguara në formularin që mat këto rezultate.

Së treti, kjo shtesë ndryshon "objektin e saj të interesit". Sipas strukturës së vjetër, kjo shtesë aplikohej vetëm në segmentin e specialistëve me arsim të lartë. Ndërkohë që sipas strukturës së re, ajo aplikohet edhe tek i gjithë personeli ndihmës.

Dhe *së katërti,* kjo shtesë ndryshon "kohën e saj të fuqisë". Sipas strukturës së vjetër ajo përsëritej formalisht një herë në dymbëdhjetë muaj. Ndërkohë që, sipas strukturës së re kjo përsëritje bëhet çdo gjashtë muaj (tendenca është që të kryhet çdo muaj). Qëllimi është i thjeshtë: të përshpejtohet koha e reflektimit në rastin e verifikimit të mungesës së rezultateve.

(4) Shtesa për funksione drejtuese është një shtesë e re që aplikohet për herë të parë në strukturën e re të pagave dhe i adresohet të gjitha niveleve drejtuese të Bankës së Shqipërisë. Kjo shtesë jepet nga Guvernatori në bashkëpunim me administratorët dhe bazohet në cilësinë e kryerjes së punës nga ana e drejtuesve. Edhe masa e përfitueshme e kësaj shtese është e ndryshueshme dhe varet vetëm nga rezultatet në punë.

Aplikimi i saj ka patur dy qëllime kryesore.

I pari është zgjerimi i spektrit të anëtarëve të personelit që përfitojnë të drejtën e shpërblimit për rezultate në punë nga e cila ata janë përjashtuar. Fakt ky që duket i diskutueshëm pasi argumentet që kanë vendosur lidhur me këtë privim nuk duken përjashtuese (argumente përjashtuese janë ato argumente të cilave nuk mund t'iu përgjigjesh me kundërargumente të të njejtit nivel cilësor).

I dyti është ai i barazpeshimit të domosdoshëm të decentralizmit të propozuar, në lidhje me dhënien e shpërblimit për rezultatet e arritura në punë. Bëhet fjalë për delegimin e së drejtës për dhënien e tij tek drejtuesit e departamenteve. Ky konfigurim bëhet i domosdoshëm sidomos për të parandaluar sjelljen e një drejtuesi që mund të bëhet "i mirë" në kurriz të punës. Në verifikimin e një rasti të tillë Guvernatori mund të penalizojë drejtuesin në fjalë në po atë masë që drejtuesi mund të ketë abuzuar.

(5) Shtesa për rezultate në punë (e ndryshme nga të mësipërmet) është një shtesë e re, e cila është në përpunim. Kjo shtesë do të synojë të masë dhe të vlerësojë rezultate të nivelit makro (në këndvështrimin e objektivave dhe të detyrave që ka Banka e Shqipërisë si institucion) dhe të jetë e ndryshme nga dy të mësipërmet e të njejtit lloj, vetëm përsa i përket objektit të punës që do të mundësojë përfitimin e saj. Ndërkohë që njëlloj si ato nuk do të jetë fikse dhe e lidhur vetëm me rezultatet në punë.

(6) Shtesa për kualifikim shkencor. Lidhur me këtë shtesë dhe konceptimin e saj ka mendime të ndryshme. Për momentin mbeten në fuqi madhësitë e përcaktuara sipas Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 19.01.2000. Madhësi që janë fikse e që për t'i përfituar duhen plotësuar kushte që lidhen me rezultate në punë.

(7) Shtesë për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete. Kjo shtesë është ajo ekzistuese, por e rikonceptuar në funksion të saktësimit më të mirë të qëllimit të saj të përfitimit. Kështu,S konceptimi i ri i saj kërkon moskufizimin e spektrit të aktiviteteve që lejojnë përfitimin e saj dhe që, për arsye të ndryshme nuk mund të marrin emrin "projekt" (emërtimi i vetëm që lejonte përfitimin e saj). Si rrjedhojë, sipas konceptimit të ri kjo shtesë mund të përfitohet nga cilido anëtar i personelit që punon për një studim, për një konferencë apo aktivitet (me çfarëdolloj emri) që kërkon kohë pune shtesë (përtej tetëorëshit), më tepër se një muaj dhe paraqet interes për institucionin. Kjo mënyrë rikonceptimi e saj ruan dhe plotëson qëllimin për të cilin është krijuar, duke mos krijuar kufizime të ardhura nga interpretime të mundshme të saj. Dhe njëkohësisht shton spektrin e individëve që mund ta përfitojnë duke mos vënë kufizime që lidhen me formën, me paraqitjen apo me emrin formal të punës që lejon këtë përfitim. Kjo shtesë është fikse; dhe vihet re që është e përfitueshme vetëm kundrejt një pune të bërë e të paraqitur.

Në fazën aktuale të implementuar të strukturës së re të pagave vihet re edhe një shtesë e tetë, e quajtur shtesë për ruajtje të pagës aktuale. Kjo shtesë ka karakter të pastër teknik dhe shpresohet që të eliminohet me miratimin e modelit përfundimtar të strukturës së re të pagave. Qëllimi i futjes së saj ka qenë ekuilibrues i disa aspekteve të fazës aktuale të implementuar të strukturës së re të pagave.

5. PËRFUNDIME DHE OBJEKTIVA

Si përfundim mund të themi se modeli përfundimtar i strukturës së re të pagave mundëson në praktikë qëllimin e marrë përsipër. Ai konfiguron dhe fragmentizon pagën në funksion të rezultateve në punë dhe të vlerës që ka çdo punë apo vend pune në hierarkinë e punëve të një banke qendrore.

Në të ardhmen mbetet të rregullohen më tej raportet ndërmjet pagës bazë dhe shtesave mbi të, duke ulur sa më shumë pjesën sociale të saj në "kurriz" të pjesës që lidhet me rezultatet në punë. Ky fakt lejon një lidhje më të mirë e më të saktë të punës së kryer me pagesën. Duke ulur shumën e pagës së sigurtë e duke ngritur shumën e përfitueshme nëpërmjet shtesave mbi pagën bazë (që duhet të synohet të lidhen sa më shumë me objektiva të matshëm pune) do të mundësohet një rritje e mëtejshme cilësore e impenjimit për të kryer punë rezultative. Duke rritur kështu edhe vlerën psikologjike të parave të përfitueshme nëpërmjet punës.

Një tjetër detyrë mbetet vertikalizimi i mëtejshëm i sistemit të pagave në funksion të rëndësisë që ka secili vend pune, në hierarkinë e vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë dhe të pagesës që i bëhet secilit prej tyre në tregun aktual të punës. Ende vihet re një vertikalizim jo i plotë i pagave në Bankën e Shqipërisë, krahasuar me tregun përkatës të pagave. Konkretisht, për vende të njëjta apo të ngjashme pune vihet re ende një pagesë më e ulët në Bankën e Shqipërisë në raport me struktura të tjera të organizuara, që në ndonjë mënyrë mund të quhen si të krahasueshme me të. Dhe kjo mospërputhje rritet sa më shumë ngjitemi në hierarki.

Ky vertikalizim është përmirësuar me strukturën e re por nisur nga dinamizmi i mjedisit, që shërben si model krahasues, do të vazhdojë të jetë në vëmendjen tonë edhe në vitet e ardhshme.

Ndërkohë që modeli i ri i pagave në bankë do të mbështetet nga një sistem shpërblimesh, të cilat do të synohet të afrohen përherë e më tepër me konceptin e pagesës bazuar në rezultate në punë.

“GODINA E SELISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË, TIRANË”.*

TË PËRGJITHSHME

Me konsolidimin e Shtetit të ri Shqiptar në vitet 20-30, krahas rikonceptimit urban të qyteteve dhe në mënyrë të veçantë, të Tiranës, filloi edhe organizimi dhe zhvillimi i administratës shtetërore, sipas modeleve më të zhvilluara të Europës Perëndimore.

Në këtë këndvështrim, edhe sistemi bankar shqiptar filloi të konceptohej e të konturohej sipas modelit financiar të shteteve perëndimore, për të qenë i gatshëm e t’u paraprinte marrëdhënieve financiare që kishin lindur dhe po ndryshonin me shpejtësi në shtetin, që pak vite më parë kishte fituar pavarësinë.

Në këtë periudhë u ndërtuan në qytetet kryesore të vendit si: Durrës, Vlorë, Korçë, Elbasan etj. godinat e para të personalizuara për bankë. Këto godina, me arkitekturën e tyre të spikatur dhe me pozicionin e saktë urban në qendrat e qyteteve edhe sot mbeten veprat më të arrira në fushën e arkitekturës e të ndërtimit administrativ.

Në këtë këndvështrim edhe godina e selisë së Bankës së Shqipërisë, për nga rëndësia e saj në sistemin financiar e bankar, si Banka e Bankave, u gjykua të vendosej në godinat që do të formatonin sheshin qendror të kryeqytetit tonë, Tiranës.

Godina e Bankës së Shqipërisë ka një mision të studjuar urban në vendin ku është ndërtuar. Ndryshimi i karakterit të fasadës së bankës nga ndërtesat e tjera të rrugës së Kavajës lajmëron ndryshimin e ambientit urban në hyrje të sheshit qendror të Kryeqytetit, duke prezantuar ndërtimin administrativ, tepër të rëndësishëm. Godina e Bankës së Shqipërisë ka përfunduar së ndërtuari në vitin **1938**. Projekti i godinës është realizuar nga arkitekti i njohur i asaj periudhe, italiani **Vittorio Ballio Morpurgo.** Stili arkitektonik i saj i përket rrymës së “**Racionalizmit**”, rrymë e cila lulëzoi në gjysmën e parë të shekullit tonë në Evropë. Ky stil shquhet për vëllimet e mëdha dhe për linjat e forta në fasada. Kryesisht ai është aplikuar në ndërtimet shtetërore me funksion administrativ zyrtar dhe synonte të shprehte forcën e qeverive perëndimore të asaj kohe. Në këtë këndvështrim edhe godina e Bankës së Shqipërisë bën pjesë në ndërtimet më të spikatura të asaj kohe në llojin e vet, rrymës Racionaliste.

PAK MBI RRYMËN RACIONALISTE NË ARKITEKTURË

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Evropa duhet të përballonte probleme të mëdha në fushën e rikonstruktimit, të cilat shoqëroheshin me një *boom* demografik dhe si konseguencë

* Artikulli është përgatitur nga Ing.Niko Shtrepi, specialist pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës në Bankën e Shqipërisë. Materialin mund ta gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

me kërkesë të madhe për banim. Për këtë arsye, lindi „**Protorazionalizmi**" i cili deri në atë periudhë i ishte dedikuar zgjidhjes së problemeve abstrakte të karakterit estetik. Përfaqësuesit e kësaj rryme, në këtë periudhë, filluan të merren me zgjidhjen e problemeve praktike të prodhimit në seri, të përdorimit të materialeve të reja të ndërtimit, përdorimit të parafabrikateve në mënyrë që të ofronin produkte kompetitive dhe ekonomikisht të pranueshme. Ky ishte edhe fillimi i "**Racionalizmit**" të vërtetë që përkufizohet si shfrytëzim razional i ambientit me burimet e disponueshme.

Eksperimentimi i parë me këto forma të reja arkitektonike, që futi panelet modulare të xhamit dhe skelete prej çeliku dhe betoni filloi në ndërtimet industriale dhe pati si protagonist të parë **Walter Gropius,** i cili ishte instruktuar në shkollën Protorazionaliste të arkitektit **P. Behrens**. Gropius krijoi mbi bazën e eksperiencave racionaliste, në vitin 1919, në Waimar **"BAUHAUS"** , një shkollë arkitekture dhe të arteve të aplikuara, e cila jo vetëm që mblodhi intelektualë dhe artistë të famshëm të kësaj epoke si **Kandinsky** dhe **Klee**, por vuri dhe bazat e dizenjos moderne dhe të një qendre të debatit mbi arkitekturën.

Utopistët dhe arktitektët e arkitekturës abstrakte si për shëmbull, **Tatlin** dhe ato, neoplasticiste si për shembull, **Rietveld** si dhe piktorët e përfaqësuar nga **Malevic** dhe **Mondrian** ishin të influencuar nga studimi i perfeksionit formal, bilancimit kromatik dhe kompozimit abstrakt.

Bauhaus mori pjesë me sukses të madh në ekspozitat prestigjioze të kohës, ndër të cilat "**Werkbund**" në vitin 1927 në Stuttgart ku të gjithë racionalistët projektuan një lagje prototip të mënyrës së ardhshme të banimit. Për herë të parë u ekzekutuan projekte të futuristit **Sant Èlia,** nga të cilat lindën ambiente komplete të një komforti modern.

Idetë e racionalistëve nëpërmjet avanguardistëve gjermanë e influencuan edhe

arkitekturën ruse të atyre viteve(pas revolucionit të Tetorit).

Idetë e racionalistëve vazhduan të jetojnë dhe arritën me sukses të ekzekutohen edhe nga përfaqësuesi i famshëm i kësaj periudhe arkitektonike **Le Corbusier**, i cili ishte formuar në Bauhaus dhe në fillim ishte krejt utopist, pastaj u dallua si një zhvillues konseguent i programeve metodologjike të projektimit.

Nëse Adolf Hitleri i konsideronte eksperimentet brilante të racionalistëve si degjenerim i artit, në Itali ndodh e kundërta, me marrjen e fuqise nga Mussolini vihet nën kontroll të fashizmit edhe arkitektura dhe zhvillimi i saj. Mussolini hedh tezën se **Fashizmi është një shtëpi qelqi,** ku gjithçka është transparente dhe, mbi bazën e këtij parimi, vë në konkurrencë pothuajse të gjitha rrymat ekzistuese arkitektonike për të zgjedhur dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimi asaj rryme që përfaqëson më së miri idetë i tij.

Për Mussolinin kishte rëndësi zgjimi i koshiencës mbi Romën e viteve të arta të saj dhe mbi bazën e kësaj periudhe të ndritshme ndërtimi i një shoqërie të re glorioze.

Nën këtë përkrahje apo frymë, në këtë periudhë në Itali vlen të përmendet krijimi i **Gruppo 7,** i cili u krijua si reaksion kundër "**Akademizmit**". Ky grup duke u orientuar në dy epoka të rëndësishme të artit, në antikën dhe në rilindjen (rinashimento), realizoi aktualizimin me arkitekturën moderne botërore.

Kjo filozofi etike dhe estetike është pothuajse e njëjtë me filozofinë ideologjike të Mussolinit, prandaj lind lëvizja moderne fashiste në Itali, e cila duke thithur nevojën e një diçkaje të re, mbyll marrëdhëniet me lëvizjet e mëparshme artistike të konsideruara si kaotike, orientohet në periudhat e arta të historisë së Italisë dhe kërkon të drejtën e absolutizmit të bazuar në totalitarizmin dhe universalizmin, pranohet menjëherë nga Fashizmi.

Në **Casa del Fascio** materializohet komplet i gjithë programi i lëvizjes dhe konsiderohet si etapa më e lartë e procesit të civilizimit. **Giuseppe Terragni** përfaqëson dhe drejton modernen italiane të bazuar në **arkitekturën racionale**. Ato inkorporojnë materializimin e një individi (Mussolinit) me ideologjinë e ngurtësuar nga materia. Gjithçka nënvizohet nga monumentaliteti dhe nga injorimi, pakuptimshmëria personale si individë njerëzor të lidhur me sistemin ideologjik.

SELIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Prezenca e kësaj godine racionaliste në sheshin qendror të Tiranës, që mban emrin e luftëtarit famoz të mesjetës "Skënderbej" e ka justifikuar plotësisht respektin e qytetarëve të Tiranës dhe të gjithë shqiptarëve.

Në projekt idenë e saj, godina ishte e konceptuar me planimetri shumëkëndëshe dhe e **ndarë nga ana funksionale në dy pjese**, në korpusin kryesor të harkuar, që do të kryente funksionin prezantues të bankës dhe në pjesën operative të saj. Kjo e fundit do të ndërtohej në të dy krahët anësorë të prapëm të korpusit kryesor, por nuk arriti të ndërtohej për shkak të problemeve e ndryshimeve që shkaktoi Lufta e Dytë Botërore.

Korpusi kryesor i saj është i ndërtuar në formën e një harku, i detyruar nga pozicioni në hyrje të sheshit kryesor të qytetit. Hyrja e saj kryesore është realizuar me një portal madhështor i

mbështetur në kolona të forta, që përfshin të gjithë lartësin e fasadës dhe të zbukuruar me relieve murale në argjil të pjekur në ngjyrën karakteristike të saj, që në kompleks i jep një paraqitje shumë dinjitoze godinës.

Në organizimin dhe funksionimin e aktivitetit të bankës, krahas godinës komplekse me të dyja pjesët e saj, parashikohej edhe ndërtimi i një pallati rezidencial për banimin e punonjësve të bankës, i vendosur sa më pranë saj.

Sipas studimit urban të atyre viteve, kjo godinë me projekt të realizuar po nga Arkitekti Morpurgo ishte gjykuar të ndërtohej përbri godinës së Parlamentit Shqiptar (sot Teatri i Kukullave).

GJENDJA AKTUALE

Aktualisht, selia e Bankës së Shqipërisë përbëhet nga korpusi i saj qendror në formë harku dhe nga dy shtesa të vogla (*do të prishen*



pas rikonstruksionit) që janë ndërtuar në periudha të ndryshme të mëvonshme, për të përballuar rritjen e numrit të personelit operativ të saj.

Ndryshimet e mëdha që shoqëruan fillimin e viteve 90-të, impononin krijimin e institucioneve prestigjioze demokratike, njëri prej të cilëve do të ishte banka qendrore e vendit. Për rrjedhim, në prill të vitit 1992, krijohet Banka e Shqipërisë, së cilës, ashtu si simotrave të saj kudo në botë, iu besuan funksione jetike për zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

Krahas emetimit të monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë gëzon dhe privilegje të tjera, ku më të spikatuarat janë konceptimi dhe zbatimi i politikës monetare si dhe drejtimi dhe mbikëqyrja e sistemit bankar. Pavarësisht sa më sipër, ajo që bie në sy ka të bëjë me faktin se në rrjedhën e viteve, Banka e Shqipërisë ka ardhur duke u rritur profesionalisht, dhe nuk përbën ndonjë ekzagjerim fakti, që sot ky institucion është një nga qendrat avangarde të mendimit ekonomik dhe të punës kërkimore.

Në kushtet e kufizimeve të mëdha hapësinore me të cilat përballemi aktualisht, konstatojmë se aktiviteti i përditshëm i Bankës, po has pengesa artificiale, të cilat në një mënyrë ose në një tjetër po ndikojnë në performancën e Bankës së Shqipërisë. Në qoftë se do të bënim një përgjithësim të pasojave do të listonim:

1- Godina me sipërfaqen ndërtimore totale ekzistuese të saj nuk përballon aktivitetet që kryen si Banke Qendrore.

2- Godina ekzistuese është e amortizuar **fizikisht** pothuaj në të gjitha elementet e saj arkitektonike (*kryesisht në rifiniturat e ambienteve të brendshme*) dhe **moralisht** e **fizikisht** në ato instalative (*kondicionim-ventilim, teknologji-informacioni, sistemi funksional i furnizimit me energji elektrike etj.*).

3- Nuk përballon rritjen e numrit të punonjësve si dhe krijimin e kushteve të nevojshme në realizimin e aktivitetit sipas një tipologjie e infrastrukture të brendshme bashkëkohore.

4- Nuk realizon një nivel sigurie sipas kërkesave të kohës, për pjesë të veçanta të saj dhe të godinës në tërësi.

Për zgjidhjen e problemeve të mësipërme, Banka e Shqipërisë ka vendosur që krahas rikonstruksionit të godinës ekzistuese (*65 vjeçare*) të ndërtojë një godinë të re, sa më pranë saj.

LAJMET, PERIUDHA PRILL-QERSHOR 2004*

Sfida e vitit 2004: reduktimi i parasë cash dhe zëvendësimi me veprimet bankare

Leksion i Guvernatorit, z.Shkëlqim Cani, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Aleksandër Xhuvani të Elbasanit.

Më 1 prill 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani, zhvilloi një leksion me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" të qytetit të Elbasanit, me temë "Sfida e vitit 2004 : reduktimi i parasë *cash* dhe zëvendësimi me veprimet bankare". Në parashtresën e leksionit, z.Cani u ndal kryesisht në shkaqet e qarkullimit të parasë *cash* në ekonominë shqiptare dhe ndërvarësinë e saj me ekonominë informale dhe jozyrtare. Banka e Shqipërisë e konsideron reduktimin e përdorimit të *cash*-it në ekonomi, si një problem kompleks, jo vetëm i institucionit të Bankës Qendrore.

Programi i Bankës së Shqipërisë për reduktimin e *cash*-it dhe zëvendësimit me veprime me bankat, kërkon bashkëpunimin e të gjithë pjesëmarrësve të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit. Në mënyrat e reduktimit të përdorimit të *cash*-it në ekonomi, z.Cani përmendi: pagesat dhe arkëtimet në favor të buxhetit të shtetit duhet të kryhen maksimalisht nëpërmjet sistemit bankar, nxitjen e përdorimit të gjerë të formave të ndryshme bankare të pagesave si për shembull çekut etj.

Shtytje e madhe i duhet dhënë edhe biznesit të vogël në këtë drejtim jo për shumën, por thjesht për numrin e madh të tyre, instalimi dhe fillimi nga puna i sistemit të kleringut, rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ që ndihmon problemin për të cilin diskutohet sot; kryerja e likuidimeve të detyrimeve mujore (energji, ujë, telefon, rimbursime shëndetësore) të punonjësve të administrates publike nëpërmjet transfertës bankare.

Leksion i Guvernatorit në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Fan Noli, Korçë.

Më 2 prill 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani zhvilloi një leksion special me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Fan Noli" të qytetit të Korçës. Tema e leksionit ishte banka qendrore dhe sistemi bankar në Shqipëri. Fillimisht z.Cani bëri një trajtim teorik të sistemit bankar duke u fokusuar në funksionet bazë të një banke qendrore dhe të një banke tregtare universale. Guvernatori Cani u ndal në zhvillimet në sistemin bankar gjatë 7 viteve të fundit, duke theksuar se: "Stabiliteti makroekonomik ka njohur përmirësime gjatë kësaj periudhe, pas krizës së piramidave të viteve 1996-1997".

Reformat e sektorit financiar shënuan progres të rëndësishëm në këtë periudhë. Ato lidhen me privatizimin e bankave shtetërore dhe me hyrjet e bankave të reja private, të cilat kanë ndikuar në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve bankare.

Karakteristikë këtyre zhvillimeve ishte rritja e numrit të bankave nëpërmjet bankave të reja private, të cilat aktualisht kapin shifrën 16. Aktiviteti bankar, sipas z. Cani, ka ardhur duke u zgjeruar bashkë me zgjerimin e bankave në treg, duke u rritur si aktivet ashtu edhe depozitat e bankave.

Në fundin e vitit 2003, totali i aktiveve të sistemit rezulton 373.6 miliardë lekë ose rreth 50 për qind e PBB-së. Nga ana tjetër, niveli i depozitave ka shënuar rritje të vazhdueshme nga 178.2 miliardë lekë në vitin '98, në 323.2 miliardë në vitin 2003. Një karakteristikë tjetër e zhvillimeve pozitive në sektorin bankar është përmirësimi i tregut të kreditit. Dy janë prirjet më pozitive që vihen re në këtë treg: e para rritja e vazhdueshme e kreditimit të sektorit privat dhe e dyta, ulja e kredisë me probleme ndaj totalit

* Të gjitha këto mund t'i gjeni edhe në faqen e internetit, www.bankofalbania.org

të kredisë. Tregu bankar pësoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003. Zhvillimi më i spikatur, i cili do të ketë ndikime të mëdha në sistemin bankar, ishte privatizimi i Bankës së Kursimeve nga banka e njohur Raiffeisen.

Gjatë këtij viti në tregun bankar hynë dy banka të reja, me kapital vendas. Gjendja financiare e sistemit bankar gjatë viteve të fundit ka qenë e kënaqshme. Sistemi bankar shqiptar ka rezultuar në vazhdimësi me fitim, duke garantuar likuiditetin e tij dhe duke plotësuar gjithnjë e më shumë nevojat e ekonomisë për kredi".

Guvernatori prezanton në Kuvend "Raportin Vjetor 2003".

Më datë 6 prill 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani prezantoi në Kuvend Raportin Vjetor të vitit 2003. Respektimi i objektivave kryesorë makroekonomikë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social, ka bërë që gjatë vitit 2003 të përmirësohen më tej ekuilibrat makroekonomikë të vendit.

Në fjalën e tij, z.Cani u shpreh se "ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 duket se i është kthyer ritmeve të kënaqshme të rritjes ekonomike. Vlerësimet paraprake tregojnë se PBB-ja, në terma realë është rritur me 6 për qind gjatë vitit 2003, krahasuar me 4.7 për qind që ishte në vitin 2002. Rritja e aktivitetit ekonomik është verifikuar në të gjithë sektorët e ekonomisë, pavarësisht se më e theksuar ajo vlerësohet të jetë në sektorin e ndërtimit, shërbimeve dhe transportit.

Viti 2003, duhet theksuar se ka regjistruar një përmirësim të lehtë edhe në situatën e punësimit. Numri i të punësuarve vazhdon të rritet, ndërkohë që problemet kronike të tranzicionit shqiptar: emigrimi dhe informaliteti i tregut të punës dhe ekonomisë në përgjithësi, ndikojnë në uljen e forcave të punës gjithsej dhe vështirësojnë shpegimin e efektit në punësim të politikave dhe zhvillimeve ekonomike të vendit. Në fund të nëntëmujorit të vitit 2003, sipas burimeve zyrtare papunësia u ndal në nivelin 15 për qind krahasuar me 15.8 për qind që ishte në fund të vitit 2002.

Viti 2003 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vlera e inflacionit në muajin dhjetor ishte 3.3 për qind, duke respektuar objektivin e Bankës së Shqipërisë ndërkohë që mesatarisht gjatë vitit 2003, çmimet e konsumit janë rritur me 2.37 për qind. Pavarësisht faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar, vlerësohet se ky inflacion i ulët e ka burimin te kontrolli i kërkesës së brendshme, si pasojë e politikave të përshtatshme fiskale e monetare.

Ndryshe nga vitet e mëparshëm, viti 2003 u karakterizua nga një shpërndarje më racionale e shpenzimeve fiskale. Kërkesa e qeverisë për hua ka qenë më e njëtrajtshme gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e financimit të deficitit në muajin dhjetor. Deficiti vjetor në total ishte 19 për qind më i ulët në krahasim me një vit më parë, duke arritur në nivelin 4.4 për qind të PBB-së. Megjithatë, duhet të theksohen dhe disa probleme si realizimi i të ardhurave në masën 93 për qind dhe veçanërisht realizimi i shpenzimeve kapitale vetëm në masën 62 për qind të planit. Për herë të parë gjatë periudhës së tranzicionit, kursimet publike arritën një vlerë pozitive si rezultat i konsolidimit të financave publike, kryesisht në kryerjen e shpenzimeve.

Kursimet publike kanë ndikuar në rritjen prej 0.8 pikë përqindje të kursimeve të brendshme krahasuar me vitin 2002, duke bërë që në fund të vitit 2003 kursimet e brendshme të vlerësohen sa 13.8 për qind e PBB-së. Në total investimet vlerësohen në 22.3 për qind të PBB-së, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2002. Rritja e investimeve gjatë këtij viti i atribuohet më së shumti rritjes së investimeve private, për vetë faktin se investimet publike të realizuara gjatë vitit 2003 ishin rreth 11.7 për qind më të ulëta se viti i mëparshëm.

Viti 2003 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të jetë ulur me 2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë duke arritur në 6.7 për qind të PBB-së. Pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave është pozitiv duke bërë që rezervat valutore të vendit të rriten vazhdimisht. Për herë të parë, në muajin dhjetor, niveli i përgjithshëm i tyre kaloi shifrën 1 miliard dollarë amerikanë".

Leksion i Guvernatorit Cani në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Më datë 9 prill, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, zhvilloi një leksion me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, me temë "Ekonomia në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë - shpjegimi i strukturës dhe i të dhënave konkrete".

Guvernatori Cani e nisi leksionin e vet me një trajtim të përgjithshëm të përmbatjes së Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë, si një nga publikimet më të rëndësishme të saj, i cili nëpërmjet analizës dhe shifrave jep një vështrim të përgjithshëm mbi zhvillimin ekonomik të vendit, politikën monetare, tregun valutor, mbikëqyrjen bankare, operacionet monetare të Bankës së Shqipërisë, zhvillimin e sistemit të pagesave si dhe mbi të gjitha aktivetetet e tjera të Bankës së Shqipërisë në harkun kohor prej një viti. Më tej, Guvernatori Cani vazhdoi me prezantimin e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003, i cili u paraqit para disa ditësh në Parlament.

Ai nënvizoi ndër të tjera ngjarjet më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare gjatë vitit të kaluar, duke u ndalur në zhvillimet në sektorin real e ato monetare e fiskale, për të vazhduar me ecurinë e inflacionit dhe politikën monetare e atë të mbikëqyrjes, të ndjekur nga Banka e Shqipërisë gjatë 2003. Një vend i veçantë iu kushtua edhe të rejave që viti i fundit solli në drejtim të zhvillimit të sistemit të pagesave, si dhe vështrimit perspektiv të Bankës së Shqipërisë për vitin 2004.

Mbi takimin me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Më datë 14 prill, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani u takua me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar të drejtuar nga z. Julio Escolano, shefi i ri i Misionit dhe i shoqëruar nga z.Jan Peter Olters, përfaqësues i përhershëm i FMN-së në Tiranë.

Tema kryesore e takimit i referohej zhvillimeve kryesore makroekonomike, politikës monetare, zhvillimeve në sistemin bankar dhe në kursin e këmbimit, sistemin e pagesave ndërbankare etj..

Në fjalën e tij, Guvernatori Cani u shpreh se viti 2003 shënoi një normë inflacioni 3.3 për qind, brenda intervalit objektiv të deklaruar prej Bankës së Shqipërisë 2-4 për qind, ndërsa rritja ekonomike e vlerësuar ishte rreth 6 për qind. Edhe parashikimet për vitin në vijim mbështeten në një normë inflacioni në intervalin e dëshiruar prej Bankës së Shqipërisë, 2-4 për qind dhe një rritje ekonomike rreth 6 për qind. Një çështje tjetër e rëndësishme ishte edhe ecuria e sistemit bankar, sidomos pas privatizimit të Bankës së Kursimeve. Guvernatori u shpreh se "aktualisht sistemi bankar shqiptar paraqitet i konsoliduar dhe nuk ka kërcënime serioze. Në fjalën e tij, z. Cani e njohu Misionin edhe me ecurinë pozitive të projektit të pagesave ndërbankare në vlerë të madhe dhe angazhimin e Bankës së Shqipërisë, bankave të nivelit të dytë, të Ministrisë së Financave dhe të Bankës Botërore për realizimin gjatë vitit 2004 të projektit të pagesave ndërbankare në vlerë të vogël.

Fushata e zëvendësimit të *cash*-it (parasë në dorë) në ekonomi me transaksione bankare, ishte një tjetër argument i diskutuar gjatë në takimin me Misionin e FMN-së. Guvernatori u shpreh se Banka e Shqipërisë ka shprehur gatishmërinë e saj për ndërveprimin institucional kryesisht me Ministrinë e Financave dhe me atë të Ekonomisë, mbështetur nga një infrastrukturë më e zhvilluar bankare nga bankat e nivelit të dytë, për realizimin me sukses të programit "Përtej parasë". Një nga hapat e parë të programit pritet të jetë edhe kalimi i pagesave të pagave të nëpunësve të sistemit publik dhe pagesat e faturave të kompanive publike nëpërmjet bankave

Miratohet aksioneri i ri i Bankës së Kursimeve, Raiffeissen Bank.

Me 15 prill 2004, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani njoftoi finalizimin me sukses të procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve me miratimin e aksionerit të saj të ri, bankës së mirënjohur Raiffeisen Zentralbank. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e djeshme, mori vendimin e rëndësishëm për miratimin e aksionerit të ri të Bankës së Kursimeve, Raiffeisen Bank. Po me 15 prill, Këshilli Mbikëqyrës mori edhe një tjetër vendim të rëndësishëm lidhur me Bankën e Kursimeve, lejen për rifillimin e aktivitetit të

kredidhënies, i cili i ishte ndaluar Bankës së Kursimeve që nga viti 1998.

Për vetë peshën që ka Banka e Kursimeve në sistemin tonë bankar, si dhe rolin tradicional që ka luajtur për kursimet e publikut në Shqipëri, kalimi i saj tek një investitor i besueshëm, i shëndoshë financiarisht dhe me përvojën e duhur në veprimtarinë bankare, ishte i një rëndësie maksimale.

Përpjekjet e bëra në këtë drejtim nga ana e Qeverisë Shqiptare, vetë Bankës së Kursimeve, Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve financiare ndërkombëtare që asistuan në këtë proces, rezultuan të suksesshme pasi Raiifeisen Bank përfaqëson një zgjedhje shumë të mirë për ecurinë e ardhme të Bankës.

Aksioneri i ri, pritet të sjellë risi në konkurrencën në sistemin bankar, ndërsa për vetë Bankën e Kursimeve priten zhvillime pozitive në drejtim të administrimit, të organizimit, të drejtimit dhe të përmirësimit të teknologjisë së informacionit. Marrëdhëniet me klientët, me bankat e nivelit të dytë dhe me Bankën e Shqipërisë gjykojmë se do të përmirësohen ndjeshëm sipas standardeve më të mira të bankingut perëndimor. Miratimi i aksionerit të ri, shoqëruar me heqjen e kufizimit të angazhimit të bankës në aktivitetin e kredidhënies, do të sjellë aktivizimin e saj në kreditimin e ekonomisë dhe në mënyrë të veçantë kreditë për biznesin privat.

Takimet e Guvernatorit gjatë zhvillimit të Takimit të Pranverës së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.

Gjatë vizitës në SHBA, 22-26 prill 2004, z.Shkëlqim Cani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Guvernator i Shqipërisë pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar, zhvilloi një sërë takimesh me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe FSVC-së.

Tema kryesore e bisedimeve me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar ishte rreth zhvillimeve në ekonominë shqiptare dhe në mënyrë të veçantë të atyre monetare.

Guvernatori i njohu përfaqësuesit e FMN-së me zhvillimet më të fundit në ekonomi dhe realizimin për të pestin vit rradhazi të objektivit të inflacionit, dhe përgatitjet e Bankës së Shqipërisë për kalimin në një periudhë afatmesme në regjimin e shënjestrimit të inflacionit (inflation targeting).

Në këtë proces, z.Cani në emër të Bankës së Shqipërisë kërkoi dhe mori mbështetjen e përfaqësuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Një temë e rëndësishme e diskutimeve ishte edhe programi i Bankës së Shqipërisë "Përtej parasë" dhe angazhimi me seriozitet i të gjitha autoriteteve dhe sistemit bankar në këtë proces.

Gjatë takimeve me përfaqësues të Bankës Botërore, biseda u përqëndrua kryesisht në nismat e Bankës së Shqipërisë për reduktimin e parasë *cash* në ekonomi dhe zhvillimin e një sistemi bankar modern pagesash. Pas përfundimit me sukses dhe fillimit të punës për projektin e sistemit të pagesave të mëdha në kohë reale, financuar nga Banka Botërore, Banka e Shqipërisë ka finalizuar kërkesat teknike funksionale për projektin e ri të pagesave të quajtur Automated Electronic Clearig House. Nisur edhe nga eksperienca pozitive e realizimit të projektit paraardhës, përfaqësuesit e Bankës Botërore dhanë i Guvernatorit garancitë për financimin e projektit.

Takimi me z. Andreë SPINDLER (FSVC).

Takimi i parë i z.Cani u zhvillua në Neë York me z. Andreë Spindler, Drejtor i Korporatës së Vullnetarëve të Shërbimeve Financiare. Në fjalën e tij, Guvernatori e njohu z.Spindler me zhvillimet më kryesore të ekonomisë shqiptare gjatë vitit të kaluar dhe sfidat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe reformën drejt integrimit evropian.

Sa i përket bashkëpunimit me FSVC, Guvernatori evidentoi zhvillimet pozitive në drejtim të mbikëqyrjes bankare, të auditit, të statistikave dhe të administrimit të burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë. "Në këtë proces,-u shpreh z.Cani,-një rol të rëndësishëm ka patur edhe asistenca teknike e FSVC-së. për të cilën ju falenderoj".

Nga ana e tij, z.Spindler shprehu vlerësimet mbi hapat që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë në procesin reformues drejt standardeve të bankave qendrore moderne, duke krijuar fizionominë e saj në të gjithë procesin integrues të Shqipërisë.

Asistenca teknike e FSVC në të ardhmen do të përqëndrohet kryesisht në procesin e mbikëqyrjes bankare, të ristrukturimit të sistemit bankar etj.., nëpërmjet këshilltarëve dhe misioneve të asistencës teknike. Gjithashtu, FSVC do të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë në drejtim të vlerësimeve të kërkimeve dhe studimeve të bëra prej saj. Guvernatori e ftoi z.Spindler për të marrë pjesë në Konferencën V Ndërkombëtare të Bankës së Shqipërisë që do të zhvillohet gjatë muajit tetor 2004.

Takimi me z.Biaggio Bossone dhe z. Aghdaey Hormoz (Banka Botërore).

Në takimin me Drejtorin Ekzekutiv të Bankës Botërore, për Shqipërinë, Italinë, Greqinë, Maltën, Portugalinë, San Marinon dhe Timorin Lindor, z. Biaggio Bossone, dhe në takimin me z. Hormoz, kryespecialist financiar Guvernatori bëri fillimisht një paraqitje të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri.

Sipas z.Cani, "ekonomia shqiptare ka shënuar një ritëm rritjeje të produktit të brendshëm bruto për vitin 2003, të vlerësuar në rreth 6 për qind, me një normë inflacioni 3.3 për qind, rritje të rezervës valutore në mbi 1 miliard dollarë ose 4.7 muaj importe etj..

Nga ana e tij z.Bossone u shpreh se "Shqipëria ka shënuar arritje pozitive në një periudhë të shkurtër kohore, por mbetet ende për të bërë në drejtim të koordinimit të punës midis institucioneve dhe realizimit të angazhimeve të marra. Do të ishte shumë e rëndësishme, që vendi juaj të ketë strategjinë e zhvillimit ku puna e institucioneve konvergon në të njëjtën shënjestër. Vështirësitë e ngritjes së institucioneve, në mënyrë të veçantë të institucioneve të pavarura, nevoja e komunikimit dhe e debatimit të ideve, transparenca dhe domosdoshmëria e publikimit të informacioneve nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ishin tema të tjera diskutimi gjatë takimit midis Guvernatorit dhe z.Bossone.

Takimi me z.Luigi Passamonti (Banka Botërore).
Në takimin me z.Luigi Passamont, asistent special i Presidentit të Bankës Botërore, tema kryesore ishte projekti i Konvergjencës. Projekti synon në dhënien e mundësive të të gjithë pjesëmarrësve të tregut për të shprehur idetë e tyre si dhe në koordinimin e këtyre ideve në shërbim të një strategjie të përgjithshme të zhvillimit të vendit. Projekti, i cili do të realizohet me asistencën e Bankës Botërore do të konkludojë me një vlerësim të ideve të dhëna dhe me përgatitjen e një plani të përgjithshëm të zbatimit të tyre.

Takimi i Guvernatorit me Michael Deppler, Drejtor i Departamentit të EU1.

Në fjalën e tij Guvernatori Cani bëri një paraqitje mbi zhvillimet kryesore në ekonominë vendase dhe pritshmëritë pas privatizmit të Bankës së Kursimeve nga Raiffeisen Bank. Situata e re e krijuar në sistemin bankar do të krijojë kushte për agresivitet më të madh të bankave në ofrimin e produkteve bankare. Gjithashtu, sistemi bankar në bashkëpunim me Ministritë e Financave dhe atë të Ekonomisë kanë rinisur Programin për reduktimin e parasë jashtë qarkullimit bankar.

Nga ana e tij z.Deppler u shpreh se FMN konfirmon vlerësimet mbi ecurine pozitive të situatës makroekonomike në Shqipëri dhe gatishmërinë për shtimin e asistencës teknike të FMN-së edhe për FSAP-in. Kjo asistencë do të sigurojë një vlerësim të sistemit bankar nga ana e FMN-së dhe e Bankës Botërore.

Një vend të rëndësishëm në takim zuri edhe diskutimi mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të siguruara nga privatizimi i Bankës së Kursimeve. Nga palët pjesëmarrëse u konfirmua se të ardhurat do të përdoren siç është rënë dakord në marrëveshjet dhe angazhimet paraardhëse mes palës shqiptare dhe FMN-së.

Takimi me z.Carlo Padoan, Drejtor Ekzekutiv për Shqipërinë dhe disa vende të tjera ne FMN.

Zhvillimet në treguesin e inflacionit gjatë vitit 2003, i cili rezultoi 3.3 për qind brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë ishin tema hyrëse e bisedës së Guvernatorit Cani me z.Padoan. Në fjalën e tij z.Cani u shpreh se pritshmëritë për inflacionin e vitit 2004 janë për mbajtjen nën kontroll sipas objektivave të Bankës së Shqipërisë 2-4 për qind.

Pas privatizimit të Babkës së Kursimeve, vijoi Guvernatori, sistemi bankar ka bërë një hap shumë pozitiv në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm dhe pritet që të rritet agresiviteti i bankave në sistem drejt ofrimit të shërbimeve më të shumta.

Nga ana e tij, z.Padoan u shpreh se Fondi Monetar Ndërkombëtar i vlerëson si pozitive zhvillimet makroekonomike në Shqipëri dhe theksoi se ekonomia juaj po ecën në rrugën e duhur.

Në fund të takimit z.Cani dhe z.Padoan diskutuan edhe mbi procesin e zgjedhjes së drejtorit të ri të përgjithshëm të FMN-së.

Takimi me Stephan Ingves, Drejtor i Departamentit Monetar dhe Financiar në FMN.

Guvernatori Cani falënderoi FMN-në për Misionet e Asistencës Teknike në Shqipëri dhe më pas u ndal në diskutimin për asistencën teknike në kuadër të FSAP. Si prioritet të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, z.Cani diskutoi mbi zbatimin në periudhën afatmesme të Regjimit të Shënjestrimit të Inflacionit (Inflation targeting) dhe në këtë aspekt, vlerësoi se asistenca teknike afatgjatë e FMN-së do të ndihmonte në realizimin me sukses të këtij projekti. Çështje të bisedimeve ishin edhe privatizimi i Bankës së Kursimeve, kapitali për hapjen e një banke në Shqipëri, aspektet ligjore dhe administrative të likuidimit të bankave etj.. Një pikë tjetër e bisedimeve ishte edhe asistenca e FMN-së për vlerësimin e analizave dhe studimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimin dhe konsolidimin e Departamentit të Kërkimeve etj..

Takimi me znj.Carol Carson, Drejtore e Departamentit të Statistikave.

Në fillim z.Cani bëri një përshkrim të përgjithshëm të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri dhe të sistemit të të dhënave në Shqipëri. Ekonomia shqiptare ka shënuar rritje ekonomike gjatë viteve të fundit, inflacioni është mbajtur nën kontroll, kursi i këmbimit të lekut me valutat e huaja ka qenë relativisht i stabilizuar dhe norma e inflacionit ka shënuar ulje modeste. Sa i përket vitit 2003, vijoi z.Cani, rritja ekonomike vlerësohet se ishte rreth 6 për qind, inflacioni 3.3 për qind, deficiti buxhetor u ul në 5.6 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto, shumë afër të dhënave të vendeve që do t'i bashkohen Bashkimit Evropian më 1 maj etj.. Më pas z.Cani falënderoi znj.Carson për gjithë asistencën teknike që i ka akorduar FMN Bankës së Shqipërisë në fushën e statistikave.

Të dyja palët vlerësuan si shumë të rëndësishme hapat që duhet të bëjë Shqipëria në drejtim të përmirësimit të metodologjise dhe koherences per te dhenat kombetare, studimin e nivelit te ekonomisë informale, të dhënave të bilancit të pagesave, përfshirjen e Shqipërisë në sistemin e të dhënave SDDS etj..

Takimi konkludues me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani zhvilloi, më 28 prill takimin, konkludues me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar të drejtuar nga z. Julio Escolano, shefi i Misionit dhe i shoqëruar nga z.Jan Peter Olters, përfaqësues i përhershëm i FMN-së në Tiranë. Në fjalën e tij, shefi i Misionit z.Escolano vlerësoi arritjet e Bankës së Shqipërisë në kuadër të Memorandumit të Politikave Ekonomike dhe Financiare, të nënshkruar mes autoriteteve shqiptare dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Ndër zhvillimet kryesore veçohet mbajtja e inflacionit sipas objektivave të Bankës së Shqipërisë, 2-4 për qind, një kurs këmbimi relativisht i qëndrueshëm, modernizimi i sistemit financiar dhe bankar etj.. Sipas, Memorandumit, edhe për vitin 2004 politika monetare synon mbajtjen e inflacionit sipas objektivave të Bankës së Shqipërisë ndërsa zhvillimet më domethënëse pritet të jenë në rritjen e kreditimit dhe zgjerimin e shërbimeve të ofruara nga sistemi bankar, presione relativisht të ulëta për inflacionin, rezerva valutore për të mbuluar më shumë se 4 muaj importe, përmirësimin e mundshëm të deficitit të llogarisë korente etj..

Guvernatori Cani shprehu vlerësimet mbi nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar në kuadër të Memorandumit dhe seriozitetin e Bankës së Shqipërisë në përmbushjen e angazhimeve të saj në këtë Memorandum. "Nisur nga zhvillimet e fundit të inflacionit dhe treguesve të tjerë makroekonomikë si dhe ecurinë e normave të interesit të euros dhe dollarit amerikan, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë po shikon mundësitë e uljes së lehtë të normës bazë të intreresit", u shpreh z.Cani.

Programi i Bankës së Shqipërisë për reduktimin e parasë *cash* në ekonomi ishte një tjetër çështje e rëndësishme e takimit të sotëm. Guvernatori u shpreh se autoritetet shqiptare janë të përfshira intensivisht dhe me seriozitet

në një program afatmesëm për reduktimin e parasë *cash* dhe sistemi bankar është i gatshëm të presë një fluks më të madh klientësh.

Ulet norma bazë e interesit me 0,25 pikë përqindjeje.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e tij të radhës, në datë 28 prill 2004, ndërmjet të tjerash analizoi përshtatshmërinë e politikës monetare aktuale të lidhur me ecurinë, parashikimet dhe pritshmëritë më të fundit të inflacionit.

Duke vlerësuar me kujdes: zhvillimet në treguesin e inflacionit në periudhën e fundit, veçanërisht shifrën e muajit mars; ecurinë e treguesve kryesorë makroekonomikë, veçanërisht zhvillimet e fundit në kursin e këmbimit, si rezultat i të cilave leku ka njohur një mbiçmim të dukshëm si ndaj euros ashtu edhe ndaj dollarit amerikan; ekzistencën e një diference ende të lartë midis normave të interesit për investimet në lekë me ato në euro dhe në dollarë; qëndrimin e moderuar të të dyja politikave bazë në ekonomi si të asaj monetare ashtu dhe të asaj fiskale, treguesit kryesore të të cilave vlerësohet se kanë ndjekur zhvillime jo ekspansioniste; parashikimet dhe pritshmëritë për një rikthim të inflacionit brenda intervalit objektiv, përfshirë dhe të dhënat e para në lidhje me çmimet e produkteve ushqimore për muajin prill 2004.

Me qëllim për të ulur akoma më tej koston e huamarrjes në ekonomi, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit (normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes).

Në këtë mënyrë, norma bazë e interesit në ekonomi bëhet 6.25 për qind.

Ulja e normës së interesit do të mundësojë një bashkëjetesë më të mirë të kushteve monetare në ekonomi me respektimin e objektivit të inflacionit dhe me nevojat e zhvillimit të vendit. Vendimi për uljen e normës bazë të interesit, pritet të ndikojë në një ulje të përgjithshme të normave të interesit në ekonomi, duke mbështetur kreditimin e sektorit privat. Gjithashtu, reduktimi i diferencës së normave të interesit të monedhës vendase me valutat e huaja, kryesisht me euron dhe me dollarin amerikan, gjykohet se do të ndikojë në zbutjen e presioneve mbi lekun duke mbështetur më tej zhvillimet në sektorin real të ekonomisë. Ndërkohë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjykon se momenti i marrjes së këtij vendimi është ai i duhuri dhe se në vazhdimësi do të tregohet kujdes i madh në monitorimin dhe analizimin e zhvillimeve ekonomiko – financiare si brenda dhe jashtë vendit, me qëllimin e vetëm për të ndërmarrë veprimet e duhura në kohën dhe në drejtimin e duhur.

Ulet sërish norma bazë e interesit .

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 12 maj, analizoi edhe përshtatshmërinë e politikës monetare aktuale të lidhur me ecurinë, me parashikimet dhe me pritshmëritë më të fundit të treguesit të inflacionit.

Mbështetur kryesisht në:

I. ZHVILLIMET NË SEKTORIN REAL

Të dhënat e deritanishme mbi zhvillimin e sektorit real tregojnë se ekonomia vendase përgjithësisht vazhdon trendin pozitiv të zhvillimit. Nga të dhënat e sektorëve të ndërtimit, transportit, shërbimeve dhe në mënyrë të veçantë të bujqësisë, rritja ekonomike për vitin 2004 parashikohet të jetë rreth 6 për qind.

Zhvillimi i biznesit privat pritet të mbështetet më shumë prej sektorit bankar me kredi, teprica e së cilës për vitin 2004 sipas Programit Monetar të Bankës së Shqipërisë pritet të jetë rreth 28 për qind më e lartë se e një viti më parë.

Argumentet kryesore të kësaj mbështetjeje të sistemit bankar për biznesin lidhen me politikën monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, duke ulur me 2.5 për qind normën bazë të interesit brenda një periudhe kohore 13-mujore dhe rritjen e konkurrencës në sistemin bankar, si pasojë e privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe agresivitetit të bankave për të rritur numrin e degëve dhe llojshmërinë e shërbimeve.

II. ZHVILLIMET MONETARE DHE NË TREGUESIN E INFLACIONIT.

Inflacioni vjetor i muajit prill, pas uljes së tarifave të telefonisë fikse dhe të çmimeve të artikujve sezonalë ushqimorë rezultoi 3.2 për qind, brenda parashikimeve të Bankës së Shqipërisë. Pritshmëritë për inflacionin në muajt në vijim dhe

në fundvitin 2004, janë kryesisht për nivele brenda bandës së publikuar nga Banka e Shqipërisë, 2-4 për qind, ndoshta më pranë kufirit të sipërm.

Zhvillimet e fundit në kursin e këmbimit, si rezultat i të cilave leku ka njohur një mbiçmim si ndaj euros ashtu edhe ndaj dollarit amerikan. Ekzistenca e një diference relativisht të madhe midis normave të interesit për investimet në lekë me ato në euro dhe në dollar.

Rritja e përkohshme e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar pritet të ketë ndikim të moderuar dhe në tregun e brendshëm në rritjen e çmimeve, si në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ndikuar në grupin e transportit, ashtu dhe nëpërmjet hallkave zinxhir të prodhimit si dhe në sektorin e shërbimit. Megjithatë, rritja e prodhimit bujqësor në nivele më të larta se vitet e tjera në periudhën e verës, duket se do të kompensojë efektin inflacionist të çmimit të karburanteve.

Gjithashtu, për periudhën afatshkurtër përgjithësisht është mëse e justifikuar që këto goditje oferte të akomodohen për të zbutur ndikimet negative që ato kanë mbi prodhimin vendas. Neutralizimi/normalizimi i efekteve mbi çmimet në këto raste është mirë të bëhet më gradualisht në një periudhë afatmesme.

Me qëllim për të ulur akoma më tej koston e huamarrjes në ekonomi gjë që do të çojë në nxitjen e investimeve dhe për të lehtësuar goditjen që mund të marri ekonomia nga rritja e çmimit të naftës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, vendosi të ulë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit (normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes). Në këtë mënyrë, norma bazë e interesit në ekonomi bëhet 6.00 për qind.

Në dy vendimet e saj për uljen dy herë me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazës të interesit brenda një harku kohor dyjavor, Banka e Shqipërisë u ndikua kryesisht nga rezultati i nivelit të inflacionit të muajit prill dhe pritshmëritë për muajt në vazhdim.

Vendimi për uljen e normës bazë të interesit, pritet të ndikojë në një ulje të përgjithshme të normave të interesit në ekonomi si ato të depozitave, bonove të thesarit dhe të kredive, duke mbështetur kreditimin e sektorit privat.

Ndërkohë, reduktimi i mëtejshëm tashmë i diferencës së normave të interesit të monedhës vendase me valutat e huaja, kryesisht euron dhe dollarin amerikan, gjykohet se do të ndikojë në zbutjen e presioneve mbi lekun, duke mbështetur më tej zhvillimet në sektorin real të ekonomisë për të arritur objektivat e rritjes ekonomike dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

Leksion me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Vlorës.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani, zhvilloi më 13 maj, një leksion me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Vlorës. Tema e leksionit i referohej kryesisht rolit të Bankës së Shqipërisë në procesin e mbikëqyrjes bankare dhe pritshmërive për zhvillimet në sistemin bankar pas privatizimit të Bankës së Kursimeve nga Raiffeisen Bank.

Sipas z.Cani, ngritja dhe funksionimi i institucioneve mbikëqyrëse ka si qëllim monitorimin e tregjeve dhe produkteve në mënyrë që: të sigurohen kushte të njëjta konkurrencë për të gjithë pjesëmarrësit, të vendosen standarde të caktuara të shërbimeve dhe produkteve, të shmangen abuzimet dhe konfliktet e interesit, të sigurohen shpërndarje e njëjtë e informacionit dhe niveli i duhur i transparencës etj..

Duke folur më konkretisht për tregjet financiare, Guvernatori u shpreh se mund të konkludojmë që mbikëqyrja dhe rregullimi është i nevojshëm për dy arsye kryesore: për të mbrojtur konsumatorin (publikun) dhe për të realizuar një qëllim shtesë, atë të ruajtjes së stabilitetit financiar. Ky është primar në sigurimin e shmangies së krizave ekonomike, sociale dhe politike, me pasoja në ekonominë dhe sigurinë e vendit. Më pas, Guvernatori u ndal në argumentet se pse mbikëqyrja e bankave kryhet nga Banka e Shqipërisë duke sqaruar: një nivel të kënaqshëm të kapaciteteve profesionale dhe burimeve financiare, për të kryer misionin; një shkallë të lartë pavarësie nga organet ekzekutive dhe politike; një nivel jo shumë i zhvilluar i tregut financiar në përgjithësi, ku rolin më të madh e luan tregu bankar; interesin e bankës qendrore, që në kuadër të zbatimit të politikës monetare, të ketë të disponueshme menjëherë të dhëna reale mbi gjendjen e sistemit bankar etj..

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë takohet me komunitetin e biznesit, bankat e nivelit të dytë, shoqërinë civile dhe mediat në qytetin e Vlorës.

Më 12 maj pasdite, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, u takua me përfaqësues të komunitetit të biznesit, të bankave të nivelit të dytë, të shoqërisë civile si dhe me përfaqësues të mediave të Prefekturës së Vlorës. Tematika e takimit kishte të bënte me programin «Përtej parasë», që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë, program i cili synon në inkurajimin e veprimeve dhe të iniciativave për reduktimin e *cash*-it në ekonomi dhe për kanalizimin e transaksioneve në sistemin bankar.

Në fjalën e tij, z.Cani prezantoi shkurtimisht programin e Bankës së Shqipërisë, platformën e veprimit, duke vënë theksin në efektet pozitive, që pritet të ketë mbi ekonominë e individët në përgjithësi një iniciative e tillë, si dhe në bashkëpunimin e domosdoshëm dhe të nevojshëm të të gjitha palëve : autoritete vendimmarrëse, banka, biznese, organe tatimore, fiskale e konsumatorë. Në këtë pikë, ai nënvizoi se roli i sistemit bankar në fushatën e reduktimit të *cash*-it është nga më impenjuesit dhe prej tij kërkohet ndër të tjera edhe rritja e pranisë në terren, nëpërmjet shtrirjes së infrastrukturës bankare dhe përmirësimit e ofrimit të shumëllojshëmrisë së produkteve e shërbimeve, si dhe një bashkëpunim më i frytshëm me bizneset.

Zbatimi i projektit për pagesat në vlerë të vogël (AECH – Automatic Electronic Clearing House), i cili mendohet të përfundojë gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, do t'i japë një shtysë cilësore dhe sasiore këtyre shërbimeve.

Nga ana tjetër, biznesi konsiderohet si palë e rëndësishme në këtë përpjekje, pasi një biznes i sensibilizuar dhe i ndërgjegjësuar do të synojë në bërjen evidente të përparësive të sistemit bankar, të dobishmërisë së mbështetjes nga ky sistem të një biznesi të shëndoshë, të rritjes së reputacionit të një biznesi të caktuar kur është klient i besuar i një banke, të sigurisë që i shtohet çdo biznesi kur ka një marrëdhënie korrekte afatgjatë me bankën tregtare.

Biznesi duhet të kuptojë që mënyra e vetme për të përfituar nga shërbimet bankare, në mënyrë të veçantë nga shërbimi i kredisë, është hapja dhe përdorimi i llogarive bankare. Ndërkohë, mbështetja e shoqërisë civile dhe e medias pritet t'i sigurojë shkallë të lartë besueshmërie zhvillimit të të gjithë programit dhe do të rrisë masën e suksesit të tij. Kjo, jo sepse besimi i publikut tek banka kalon nëpërmjet medias dhe shoqërisë civile, por sepse shkalla e mirëkuptimit dhe dëshira e publikut për të përqendruar vëmendjen e tij në çdo zhvillim të ri, që fillon të ravijëzohet në ambientin e përgjithshëm të shoqërisë sonë, janë mjaft të përcaktuara nga vëmendja dhe pozicionimi i shoqërisë civile ndaj tij.

Guvernatori Cani nënvizoi rolin e veçantë që duhet të luajë në këtë drejtim edhe komuniteti lokal i prefekturës së Vlorës, e cila dallohet për një potencial biznesi jo i neglizhueshëm dhe mbështetet nga një infrastrukturë bankare, që pretendon të shtrihet në planin ekstensiv dhe intensiv.

Aktualisht, në këtë prefekturë zhvillojnë veprimtarinë e tyre rreth 8 degë të bankave të nivelit të dytë dhe ka një komunitet biznesi të hapur, që e mbështet projektin për kalimin e transaksioneve financiare nëpërmjet sistemit bankar.

Takimet e Guvernatorit në Sarandë dhe në Gjirokastër.

Pas takimeve në qytetin e Vlorës, lidhur me prezantimin e programit të Bankës së Shqipërisë "Përtej parasë"", Guvernatori Cani zhvilloi takime me përfaqësues të biznesit, të bankave të nivelit të dytë, të shoqërisë civile dhe të mediave përkatësisht të qytetit të Sarandës dhe të prefekturës së Gjirokastrës.

Ai parashtroi shqetësimin e Bankës së Shqipërisë për përmasat e *cash*-it në ekonomi, reduktimi i të cilit konsiderohet si një sfidë, që mund të përballet vetëm me veprime e aksione të konverguara.

Në gjithë programin e saj të titulluar "Përtej parasë", Banka e Shqipërisë synon bashkërendimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e pagesave periodike, potencialisht të mundshme për të kaluar nëpërmjet sistemit bankar, me synimin kryesor reduktimin në maksimum të pagesave me para në dorë. Në këtë pikë, ai vuri theksin në interesin e

përbashkët të të gjithë aktorëve ekonomikë për ndërmarrjen e iniciativave efektive për reduktimin e *cash*-it:

- si të bankave të nivelit të dytë, që do të përfitojnë më shumë klientë e transaksione, të cilat përkthehen në më shumë të ardhura dhe fitime të realizuara, ashtu edhe të biznesit, që do të gëzonte mbështetjen financiare e logjistike të bankave, duke u prezantuar si një partner serioz për biznes, jo vetëm në Shqipëri por edhe me partnerët e huaj;
- si të organeve tatimore e doganore, që do të rrisnin performancën e të ardhurave të siguruara dhe të shërbimeve ndaj biznesit, nëse tatimpaguesit do t'i drejtoheshin bankave, ashtu edhe
- të autoriteteve vendimmarrëse, që do të ishin më efikase në ndërmarrjen e politikave buxhetore afatmesme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike, apo edhe të konsumatorëve, që do të përfitonin shërbime më cilësore të pagesave për entet publike, Albtelekom, KESH, Ujësjellës, dhe pagash e pensionesh, në mënyrë më të qytetëruar e bashkëkohore, pa pritur radhë të gjata e pa humbje kohe.

Guvernatori Cani mori mbështetjen e komunitetit bankar dhe të biznesit, të pranishëm në këto takime, për programin "Përtej parasë" dhe synimet e tij, të cilët nga ana tjetër nuk ngurruan të parashtrojnë e të diskutojnë edhe për probleme të ndryshme që duhen zgjidhur.

Kështu, përfaqësuesit e bankave, edhe në këto rrethe, ngritën problemin e vakuumit në legjislacionin për bankingun elektronik dhe shtruan nevojën e përshpejtimit të hapave konkretë; ndërkohë, ata theksuan se si rezultate të pritshme në periudhën afatshkurtër, pra në harkun e një viti, do të dëshironin liberalizimin e plotë të llogarive të buxhetit, kreditimin e pagave në llogari për buxhetorët edhe për biznesin e madh.

Nga ana e tij, komuniteti i biznesit renditi si çështje të rëndësishme që duhen shtruar për zgjidhje sa më të shpejtë, funksionimin më të mirë të zyrës së regjistrimit të pasurive të patundshme, gjë e cila jo rrallëherë shkakton pengesa e madje vonesa në përfundimin e praktikave të kreditimit të biznesit.

Përfaqësuesit e biznesit kërkuan nga sistemi bankar më shumë perspektivë e më shumë bashkëpunim, që nënkupton orientim e këshillim të specializuar të bizneseve lokale në ngritjen e bizneseve e ndërmarrjen e investimeve. Një shqetësim tjetër, që u bë prezent prej tyre, ishte edhe ndërhyrja e tatimorëve. Kundrejt këtij shqetësimi, përfaqësuesit e tatimorëve kërkuan më tepër sinqeritet e transparencë nga bizneset, pasi ligji është ligj dhe detyrimet fiskale duhen paguar rregullisht.

Mbi leksionin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, në Universitetin e Gjirokastrës.

Guvernatori i Bankes së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, zhvilloi një leksion special me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Gjirokastrës. Tema e leksionit, të cilin Guvernatori e mbajti së bashku me Zëvendësdrejtoren e Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, znj. Evelina Çeliku ishte "Dobishmeria e indekseve të besimit për bankën qendrore". Qëllimi i ndërtimit të indekseve te besimit te biznesit dhe konsumatorit, u shpreh z.Cani, konsiston, kryesisht, në njohjen e tendencave në sektorin real të ekonomisë, në mbledhjen e informacionit sa më të plotë për analizat që ndihmojnë vendimmarrjen në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet rezultateve që gjenerohen nga një proces i tërë vrojtues.

Sipas vlerësimeve të indeksit të besimit të biznesit, për periudhën 2002-2004, bizneset janë më optimistë për të ardhmen afatshkurtër dhe kjo del në pritjet më të larta se sa vlerat aktuale në tremujorin përkatës. Pra, ka një lloj vlerësimi të situatës ekonomike për periudhat e ardhme me ngjyra më pozitive, se sa ata pohojnë më pas apo se sa atyre u faktohet. Kjo veçori dhe probleme të tjera për të cilat reflektohet gjatë punës dhe analizave të rezultateve, bëjnë që këta tregues të vijojnë të jenë në proces testimi. Ndonëse Banka e Shqipërisë nuk i ka bërë publike shifrat, ajo e përdor informacionin e marrë prej treguesve të besimit për nevojat e saj analizuese. Ne gjykojmë se ende nuk ka ardhur koha që përdorimi i tyre të shtrihet edhe më gjerë, për të interesuar të tjerë. Procesi i punës vazhdon të kryhet me seriozitet, me synim arritjen, në një të ardhme sa më të afërt, të publikimit të tyre.

